

KUR

DOLA

NOE

JENE

BIBLIOTEKA
SHËTETI

814-31

A 58

TASIM T ALIAJ

ROMAN

891.983-31


8JH-31
17
58

S

Tasim T. Aliaj

KUR DOLA NË JETË

Roman



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

1. The first part of the document is a list of names and addresses of the members of the committee.

2. The second part is a list of the names of the members of the committee.

3. The third part is a list of the names of the members of the committee.

4. The fourth part is a list of the names of the members of the committee.

5. The fifth part is a list of the names of the members of the committee.

6. The sixth part is a list of the names of the members of the committee.

NJË ARRATISJE

Është fjala për një arratisje nga katundi. Kjo u bë edhe me dijeninë time. Por kjo s'do të thotë se unë pata gisht në këtë mes.

Dielli ishte në të rënë. Unë në atë moshë nuk e kuptoja, përse dilte dhe përse shuhej dielli. Megjithëse një gjë e tillë nuk më gëzonte, prapëseprapë, ajo kishte të mirat e saj. Do të mblidhja lopët, do të haja darkën, do të bëja mësimet dhe pastaj do të shtrohesha në gjumin çlodhës të natës. Pra, këto nuk ishin gjëra aq padëshiruara, ndaj ja vlente që dielli për disa orë t'u hapte rrugën këtyre punëve me kaq rëndësi.

Mua më thoshte mendja se edhe dielli duhej të lodhej megjithëse nuk ruante lopët tërë ditën si unë dhe as në shkollë nuk e shikoja të vinte. Ishte pra afër mendsh, se edhe ai do të hante darkë me se t'i shtrohej dhe do ja merrte me gjumë për disa orë.

Unë, pasi pregatita një krah me shkarpa dhe e hodha supeve, vura lopët përpara në drejtim të haurit.

Po, e pranoj se me lopët kam qenë i rreptë. Kur i vija përpara, nuk lejoja asnjë lëvizje majtas apo

djathtas. Në disiplinë nuk duhen bërë lëshime dhe këtë gjë duhet ta mësojnë edhe lopët e jo më njerëzit. Përndryshe, hajde t'ja dalësh!

Duke ju afruar shtëpisë, papritur më doli përpara një hije. Mua desh më ngriu gjaku. Ndoshta nuk është e hijshme t'i ngrijë gjaku një trimi si unë nga një hije, por dua të them se befasia nuk të bën mirë, sado trim që të jesh. Dhe qysh atëhere nuk para i kam fort qejf hijet. Nuk dua të kem të bëj me to!

Unë ngriva në vend, ndërsa hija bënte përpara. Pa tjetër kështu duhej të ngjiste. Këtë gjë unë e mora me mend' aty për aty.

— Ç'pate mor Zenel? Nuk po më shquan, a! — buçiti zëri i Pajos, që më shkriu gjakun. Ai u afrua, më përkëdheli flokët dhe më tha:

— Dëgjo Zenel! Ti je një djalë i mirë, sido që të shajnë dendur. Unë e di se ti je një djalë i mirë. Për këtë, unë do të të tregoj një sekret. Sonte në darkë, nuk do të mblidhem në shtëpi. Po jo vetëm unë. Ti mos u merakos fare se do të shkoj vullnetar në hekurudhë.

Për këtë i kërkova mendje edhe babës, po ai si përhera ma preu shkurt, duke ma lënë plumbin në lëkurë:

— Bëj si të duash. Je në një moshë që duhet të vendosësh vetë përsa do bësh. Të matësh dhe të presësh vetë. Unë nuk do të të mësoj gjersa të plakesh.

Kështu ma preu ai, Zenel. Kurse nëna më tha se duhej ta dija vetë se të ç'bëja.

Nanin s'e takova dot. Unë nuk e marr vesh se ku humbet tërë ditën ai. Kam frikë se do të bëhet vulë-humbur.

Ne jemi gjashtë. Katër shokë dhe dy shoqe. Ato të dyja ti i njeh. Janë Kristina dhe Margarita. Për

këtë je i ngarkuar me një detyrë. Nesër që në mëngjes do vesh në familjet e tyre, te prindët, dhe do t'u dorëzosh këtë letër. Ata nuk duhet të bëhen merak. Kristina dhe Margarita nuk u kërkuan leje prindërve, nga frika se mos i pengonin.

Ne duhet të vemi të gjashtë në hekurudhë. Ky është vendimi i rinisë së katundit.

Sa për babën, ai në fillim mbase do bëjë sikur do të zemërohet, do këputë ca të shara dhe pastaj do të bjerë vetë. Xhanëm, ka ca të drejtë se tani kemi gjithë këto punë. Por, rinia nuk do t'i lerë në baltë familjet e atyre që do të shkojnë në hekurudhë. Ky është një tjetër vendim i rinisë së katundit. Prandaj, ti sapo të arrish në shtëpi thuaju se jam shëndoshë e mirë vetë i gjashtë e në rrugë drejt Durrësit. Kështu, vëllaçko.

Ne do të rrimë andej tre muaj. Hajde, mirupafshim dhe mos m'u përlot kështu, se nuk do të vete kushedi ku. Ti tani je burrë dhe lipset ta mbash veten.

— Po meqë unë jam burrë, përse nuk më merr me vete? — thashë unë.

— Përse nuk të marr me vete? Se burrat nuk merren me vete në shpërgënj. Ata e gjejnë vetë udhën. Edhe ti kur të bëhesh si unë, do ta gjesh vetë udhën. Hajde, edhe njëherë natën e mirë dhe mos u mërzit se ndryshe do të më marrë malli.

— Jo, nuk do të mërzitem. Po ama, as ti mos u mërzit, se pastaj do të më marrë malli edhe mua.

Ai më përqafoi, më puthi dhe u nis përmes errësirës për në hekurudhë. Unë mbeta për një copë herë ashtu si i ngrirë. Vrisja mendjen, po prapë nuk arrija të shkoqis dot ç'që kjo hekurudha. Përse shkojnë këta njerëz atje nga tre muaj? Dhe, përse ato çupat e mira venë fshehura familjes? Mos vallë është

ndonjë punë e ndaluar? Punë e bukur duhej të qe kjo hekurudha: e ndaluar, fshehura familjes, të rinj, të reja, nga tre muaj... Çudi, çudi...

Ndërkohë, lopët, pa ditur gjë për hekurudhën dhe për habinë time, kishin zënë me kohë grazhdin e haurit.

U nisa dalëngadalë, duke e patur mëndjen prapa. Ktheja kokën, por më kot. Në errësirë nuk e përfytyroja dot as hekurudhën, as Pajon dhe as Durrësin. Vetëm errësira dhe unë...

Te shkallët babai më tha:

— E ç'u bëre, a lanet! Lopët kanë një sahat që kanë ardhur. Po ti pse ecën sikur numëron çapet? More, po ti do të bëhesh fare vulëhumbur!

— Nuk e di, po Pajua më tha, se ai kish frikë për Nanin që mund të bëhet i tillë! — ja ktheva pa të keq.

— Si ti, si Nani, si Pajua, një brumë ini. Një më lart një më poshtë, po ajo plaçkë mbeteni.

Po t'i dëgjonte ndonjë tjetër këto fjalë nga babai im ku ta dish se çfarë do të mendonte... Sikur ne të dy, në jetë të jetëve shkonim keq fort me njëri-tjetrin. Sikur kurrë nuk do të mirreshim vesh. Ndërsa me mua puna qëndronte ndryshe. Unë e kuptoja plotësisht tim atë. Me këtë gjuhë ai shprehte dashurinë e tij karshi meje. Kuptohet, sipas mënyrës së vet. Ndryshe ai nuk mund të fliste. Po edhe sikur të fliste me një tjetër gjuhë, nuk besoj se do t'i kishte hije. Se qe tepër i rëndë në të folur dhe në të përkëdhelur. Kështu përkëdhelte ai. Me vrazhdësi... Dhe mua më bëhej zemra mal kur dëgjoja që im atë fliste kështu.

Si u shtrua darka, ne me kënaqësi qarkuam so-

frën, kur papritur, babai me vetullat e ngrysur
pyeti:

— More, po me Pajon u poqët gjë?

— Unë nuk e di! Pse të piqeshim? — mblodhi
supet Nani disi i paqartë duke zënë vend pranë meje.

Ai me të vërtetë nuk dinte gjë.

— Po ç'dreqin dini ju xhanëm? — shfryu babai.

— Mbetët tërë ditën mbi libra dhe nuk shikoni dot as
vëllai vëllanë. Librat nuk janë shkruar që t'u marrin
edhe ato mend që kini o vulëhumbur, po mblidheni
karroqen. Të mos marrë vesh as vëllai vëllanë. Eh, si
erdhën kohërat!

— Baba, unë e takova Pajon! — kuturisa e fola
me një zë, të cilin s'jam në gjendje të tregoj nga më
doli.

— Mirë bëre! Përse të mos e takoje. . . U nis ë? Po
ti, pse nuk e mbajte? — pyeti ai më dyshasi edhe me
tallje edhe me gjithë mend.

— Unë? . . . Po qysh ta mbaja unë, kur ai më një
dorë më palos e më bën pestil? — ja ktheva, duke qe-
në i sigurtë se nuk do të gjeja dot përgjegje më të
saktë se kjo.

Këtu unë thosha një të vërtetë që im atë e dinte
farë mirë. Por, isha i detyruar ta përsëritja këtë gjë,
se nga njëherë të vërtetat duhen përsëritur edhe kur
dihen mirë nga të pranishmit.

— Po, po, kam thënë unë, që ti vulëhumbur je
edhe i tillë do të mbetesh për tërë jetën.

Nani, me sa duket e kishte marrë më shtruar këtë
punë, se nuk jepte asnjë shenjë. Nuk dukej as i
hutuar dhe as i gëzuar. Kështu, si mbajti një copë
herë lugën e mbushur përpara gojës, i dha karar ta
zbraste më në fund. Ashtu bëri. Pastaj vazhdoi të
përzjejë çorbën me ritmin e tij të zakonshëm e të

shtruar. Kurse nëna më shikonte mua me dhëmshuri.

— Në hekurudhë, ë? Tre muaj! Aferim, aferim. Dhe atje do të bëjë prokopi të madhe me sa duket ai qerrata. Çfarë djalë hairi dhe me terbijet. Larg nga syri i lik. Xhanëm, keq nuk më vjen. Kush të dojë le të vejë, jo në hekurudhë po edhe prapa diellit.

Babai nuk vazhdoi gjatë me karakteristikat e Pajos. Kjo më gëzoi, pasi vetëm atëhere e pashë të arësyeshëm fillimin e darkës. Nuk është mirë, kur më i madhi i shtëpisë qorton tët vëlla, kurse ti ha si pagjë të keq. Sikur nuk ke parë kurrë bukë me sy. Kurse Nani i kish dhënë fund hesapit të vet.

Ai vërtet ishte i ngathët, por hesapet, çfarëdo që të ishin ato, i lante shpejt e shpejt. Unë, që nuk guxoja t'i flisja, arrita me marifet t'i shkel syrin, duke dashur t'i them «vafsh shëndoshë ti». Por ai me sa duket nuk e kuptoi shenjën. Babai pandehi se Nani nuk kishte filluar akoma të hante dhe mendoj se u gëzua që gjeti sebeb të qortojë dikë tjetër. Se atij që ja kish mbathur për në hekurudhë, nuk mund t'i shfrynte më. Dhe ja nisi me Nanin.

— Po ti a merhum, përse nuk ha? — ju drejtua atij. Mor, po kjo binaja ime ç'pati që u gatua kështu, xhanëm? Ca të përçartë e ca harramë. E moj plakë, si thua ti?

— Aq adha, se i rëndet kujt do që të dëgjon. Mbetë tërë ditën duke dogëndisur djemtë. Nuk thua shqyr që t'u bënë sa një mal.

— Po ju gratë, si vulëhumbura që jini, vetëm kashtën shikoni. Po se sa grurë kanë në karroqe, aq u bën. Të zgjuara besa. Dhe unë me kë merrem.

Nga hutimi, apo për ndonjë arësye tjetër më serioze, Nani nuk e pa me vend ta sqaronte të jatin.

T'i thoshte se ai e kishte ngrënë darkën dhe se këtu kishin të bënë me një keqkuptim.

Pas kësaj babai filloi të flasë më tepër me vete se sa me ne. . .

— Fundi, mirë bëri! Djali po nuk bëri tutje në jetë nuk bëhet për të qenë. Tërë jetën mbetet si ai qulli pa kripë. Xhanëm, nuk do të qe keq sikur të kish pritur dhe ca, po më që aq ja preu, udha e mbarë i qoftë. Se. . . ai leje kërkoi. . . unë nuk ja preva. . . Ai bëri si i tha koka. Edhe unë po të isha në këmbë të tij ashtu do të bëja. . .

Pas kësaj të gjithë u tërhoqën dhe u morën me të tjera punë që nuk duheshin lënë për të nesërmen. Babai mbushi llullën, nëna ngriti sofrën, kurse unë dhe Nani hapëm librat. Por mua nuk më bëhej të mësoja. Mëndja më rrinte te Pajua. Sa u ngrit babai, Nani më pyeti.

— Nga bie kjo hekurudha, mor Zenel?

— Në Durrës!

— Po Durrësi nga bie?

— Durrësi është në Durrës, mor Nani.

— Ç'farë tarallaku! — tha ai dhe, pasi arriti në këtë përfundim e pa me vend të çohet. Po e pllakoste gjumi. Kurse mua as që më shkonte ndërmend për gjumë atë natë. Por jo pse Nani më tha torollak. As pse babai më tha vulëhumbur. Ata gëzonin plotësisht të drejtat e tyre për të më gjykuar me aq sa të mundnin. Se ata ishin më të mëdhenj nga unë.

Unë mendoja se ku do të qe tani Pajua me shokët. Nga binte kjo hekurudha dhe përse shkonin atje kaq të gëzuar. Mos vallë atje duhej të kish shir të madh? Përderisa bënë çmos për të vajtur, pa tjetër që diçka e tillë duhej të qe. Po Durrësi nga binte dhe ç'kishte të bënte ai me hekurudhën? Dhe përse ata

do të rrinin atje vetëm tre muaj... As më shumë, as më pak...

Ndoshta, sot këto pyetje duken qesharake dhe tepër të lehta. Këtë e kuptoj edhe unë. Po e kuptoj sot ama, kurse atë kohë jo.

SQARIM DHE VENDIM

*Edhe unë pasi sqaroj diçka, marr një vendim,
por e shikoj të vështirë për ta vënë në jetë.*

Të nesërmen para se të shkoja në shkollë, unë duhej të dorëzoja në shtëpinë e Margaritës letrën që më dha Pajua. Ishte një detyrë, që më dukej disi delikate dhe e rrezikshme. . . Po sikur babai i Margaritës të më rrihte nga inati. Kuptohet, ai nuk do të kishte farë të drejtë ta bënte këtë, po si ta mbroja unë të drejtën time? Unë isha i vogël.

Me hapa të drojtura, bëra tutje për nga shtëpia e Margaritës. Mendoja se do të qe më mirë sikur xha Janua, i jati i Margaritës, të mos qe në shtëpi. Dhe ashtu më doli.

Letrën ja lashë në dorë Fanikës, çupës më të vogël të xha Janos, me që askush tjetër nuk u ndodh në shtëpi.

Prej aty, i gëzuar që puna u mbyll me kaq, vrapova drejt shkollës.

Pasi dëgjuam shpjegimin e mësimit të ri të natyrës, mësuesi u ul në karrike dhe na tha:

— A ka ndonjë pyetje përsa folëm?

Unë ngrita dorën. Mësuesi nuk më pa menjëherë.

— Hë mo Zenel, si e ke hallin? — më pyeti.

— Unë, desha të di se ç'është hekurudha dhe ç'ka të bëjë me Durrësin, sepse... me që...

Shokët po më shikonin me habi dhe, me sa dukej, ata qenë gati t'ja shkrepnin të qeshurit. Dhe, kishte mjaft mundësi ta bënin këtë, sikur aty të mos ishte mësuesi.

Mësuesi, duke vënë buzën në gaz më pyeti prapë.

— A e ke pasur mëndjen në mësim ti Zenel?

— Si urdhëron. E kam pasur.

— Atëhere ç'hyn këtu hekurudha dhe Durrësi?

Mësuesi kishte të drejtë. Ç'hyn te në mësimin e natyrës hekurudha dhe Durrësi? Mos vallë unë me të vërtetë nuk e kisha pasur mëndjen në mësim? Jo, mësimi qe tjetër gjë dhe pyetja ime tjetër gjë.

Jo, unë e kisha pasur mendjen në mësim, por doja të mësoja edhe diçka tjetër. Mësuesi, i cili nuk po m'i ndante sytë, me sa duket, më kuptoi. Nuk e di mirë pse, por ama e kisha këtë parandjenjë. Ai ishte burrë i urtë dhe kurrë nuk të linte në baltë.

Atij nuk i rëndohej për çfarëdo që ta pyesje. Vetëm se të përgjigjej ndryshe dhe jo drejtpërdrejtë, siç bënin të tjerët.

— Kush dëshiron ta sqarojë Zenelin,? — ju drejtua klasës mësuesi. Unë ktheva kokën pas nga kurreshtja, për të parë se kush i dinte këtu këto gjëra kaq të çuditshme. Por klasa heshti.

Ka pasur mundësi (nuk e mbaj mend mirë), që ajo e heshtur të ma bënte qejfin, sepse këtu nuk po dilte asnjë më i ditur nga unë, siç mund të dëshëronte mësuesi ynë.

Kur papritur, aty në bankën e fundit, u ngrit në këmbë Maria, nxënësja më e gjatë e klasës. Ajo tha:

— Hekurudha është një rrugë me hekura si në

Evropë. Ajo do të ndërtohet me forcat vullnetare të rinisë sonë. . . Dhe Maria vazhdoi të na sqaronte me një ton të tillë, tamam sikur po përgjigjej në mësimin e natyrës.

«Unë e marr me mënd, — thashë me vete, — përse Maria di më shumë nga unë. Se ajo është më e gjatë. Ja pse! Dhe për kaq gjë na shet mënd. . .»

Por Maria nuk i dinte të gjitha gjërat aq mirë sa pandeha në fillim. Se, sapo mbaroi ajo, fjalën e mori mësuesi. Dhe kur fliste ai, nuk kishe si të mos e dëgjoje me vëmendje. Ai nuk fliste kurrë për gjëra që ne i dinim.

Sapo dolëm jashtë për pushim, unë ndjeva një dorë që më kishte mbërthyer për supi nga prapa. Ishte Minella.

— More Zenel, po ti nga e mësove atë punën e hekurudhës që pyete mësuesin?

Unë i tregova atij fill e për pe, atë që kish ngjarë të djeshmen në shtëpinë tonë. Ai uli kokën dhe të dy po ecnim pa ditur ku shkonim.

— Dëgjo Zenel. Kjo hekurudha do të jetë një gjë e bukur. A e dëgjove ç'tha mësuesi? «Atje do të mblidhet ajka e rinisë sonë trime. Ashtu siç u mblo dhën partizanët maleve. Ata do të punojnë që të lëlëzojnë atdheu ynë. Do të miqësohen me njëri-tjetrin. Do të luftojnë analfabetizmin. . .»

— Po Minella! Këto do të jenë gjëra shumë të bukura. Mua nuk më del nga mendja dhe nuk di si të bëj. Po sikur. . . sikur. . . dhe nuk e mbarova fjalën, pasi përballë nesh po vinte Nani vetë i tretë.

— Ç'kurdisni ju? — na u drejtua ai, duke qëndruar përballë nesh plot autoritet dhe kërcënim. Unë ngrita sytë, e pashë njëherë nga poshtë-lart dhe i lirova rrugën. Ashtu veproi edhe Minella.

Por, Nani kish vendosur të mos na ndahej. Dhe nuk na u nda. Kështu nuk e sqaruar dot atë çështjen e hekurudhës.

Ra zilja dhe ne nxituam të zinim vendet në klasë. Në bangë rrimim nga dy, kështu që Nani, aty nuk na e priste dot rrugën dhe nuk mund të na ndalonte të flisnim për hekurudhën.

— Zenel, Zenel ore! — më shtyu me brryl Minella. — Çfarë deshe të thoshe qëparë me atë fjalën sikur, sikur. . .

Unë kisha frikë t'i përgjigjesha, pasi mësuesi ynë, po të flisje gjatë shpjegimit, të nxirrte fishek përjash-ta. Po ku dëgjonte Minella.

— Hë ore Zenel, hë! Si qe ajo sikur. . .

— Po ja, unë them që. . .

— Kujdes banga e parë! — na paralajmëroi mësuesi. Po sa ktheu sytë në anën tjetër, Minella ja nisi prapë.

— Hë ore, hë, thuama tani.

Unë, duke mos dashur që mësuesi të na hiqte prapë vërejtjen, e pashë më të arësyeshme të marr një copë letër dhe t'i shkruaj shokut tim.

«Pusho Minella, se mësuesi do na nxjerrë përjashta!» Isha i sigurtë (bile as sot nuk e vë në dyshim këtë), se mësuesi nuk mund ta mirrte me mend se çfarë i shkruajta Minellës. Sidoqoftë, ai diçka nuhati, ndryshe nuk mund të shpjegohet ajo që ndodhi më pas.

— Banga e parë, ma dorëzoni këtu atë pusullë!

Me sa pashë unë, ky qe një urdhër i prerë. Nuk mund t'i bëje bisht. Se mësuesi ynë, nuk i kishte fort qejf bishtat. U çova në këmbë me kokën ulur, dhe i thashë:

— A ka mundësi të na falni! Ne nuk do ta përsërisim më.

— Hajt, hajt, ma sillni këtu atë copë letër, pastaj shohim e bëjmë.

Ne, si djem të mirë dhe të bindur, i dorëzuam letrën. Ai duhej të na falte. Ne kishim bërë gabim. Zakonisht, pasi e kuptonim gabimin, ose pasi kapeshim me presh në dorë, pendoheshim dhe bëheshim djem të bindur. Po ç'e do! E kishte marrë ferra uratën. Me këtë mendje pak a shumë ishte edhe mësuesi pasi na tha:

— Dilni të dy përjashta dhe më prisni në korridor, kur të bjerë zilja.

Dhe ne dolëm njëri pas tjetrit. Minella përpara, unë pas. Kur mbylla derën, Nani, kërciti dhëmbët dhe më kërcënoi me grusht. Po, ashtu është! Grushti ka lidhje direkte me dhëmbët dhe njerëzit nuk duhet ta harrojnë këtë.

Sapo dolëm në korridor, nuk m'u durua.

— Hë more Minella, nuk t'u durua sa të binte zilja? Ja ç'na bëre tani!

— Aq më mirë! — ma ktheu pa të keq ai. — Tani më thuaj, ç'qe ajo sikur. . .


— Eh, ç'ma hëngre shpirtin. Po ja. Unë desha të të them, se sikur ne të donim, mund të shkonim në atë hekurudhën e madhe. Se ne nuk jemi të vegjël tani, apo jo?

— Po xhanëm, edhe mua më vajti në mendje, po nuk e di a do të na lenë, se. . .

— S'do mend që nuk do të na lenë. Po unë them të ikim fshehurazi, siç ikën edhe ato dy vajzat, Margarita me Kristinën.

— E përse, ne nuk jemi vajza! — tha Minella.

— Vajza nuk jemi, por jemi të vegjël. Për këtë



trembem se nuk do të na lenë. Kur je i vogël edhe po të duash të bësh ndonjë punë të mirë, zor se të lenë. Jo se s'duan, por kanë frikë se do e bësh keq. Pastaj ne jemi vetëm dy veta.

— Pse sa veta duhet të jemi?

— Gjashtë! Nuk e di mirë, po besoj se kështu duhet të jetë!

— Gjashtë! Epo, ne jemi dy! Ku t'i gjejmë edhe katër të tjerë?

— Po pse fundi, ç'na duhen të tjerët?

— Si, ç'na duhen! Përse atëhere ata më të mëdhenjtë u bënë gjashtë? Ku ta dish? Mbase atje në hekurudhë pranohen gjashtë e nga gjashtë. . .

Kjo hamendje e Minellës, më turbulloi edhe mua. Kështu që, aty për aty, vendimi im u lëkund nga themelet.

— Na duhen edhe katër vetë, Zenel. Cilin të marrim? Kujt t'i themi. . . Llaqi s'vjen, Fani jo, Nani jo!

— Me ata mos na ngatërro. Kjo punë duhet mbajtur fshehtë. Përndryshe, në shtëpi do të kërcasë druri.

— E përse do të kërcasë druri?

— Po ja, se jemi të vegjël, jo për gjë tjetër.

— As unë s'e marr vesh. Mësuesi na foli aq mirë për hekurudhën. Në shtëpi kërcet druri po të shkosh atje. Hajde dilja përtej kësaj pune.

— Pastaj, kjo puna e shkollës si do bëhet? Ne do të mbetemi në klasë po që se ikim kështu.

— Hëm. . . Kjo nuk më shkoi fare në mendje, Zenel. Shkolla, po. . . po sikur t'i themi mësuesit?

— Jo more! Unë nuk di ç'do t'i them atij që më nxori jashtë, e ti thua ti flasim për hekurudhën.

— Ke të drejtë. Fundi ne presim edhe një muaj, deri sa të mbarojë shkolla. Se, me siguri, edhe në he-

kurudhë nuk do të na pranojnë po të marrin vesh se kemi lënë shkollën.

— Jo vetëm aq. Bile, atje ka të ngjarë që të na heqin edhe veshët për këtë punë.

— Dhe ajo na duhet!

Kështu unë dhe Minella vendosëm përfundimisht, që planet tona për hekurudhën t'i shtyjmë një muaj më vonë. Natyrisht, shtyrja e planeve nuk është gjë e mirë, po kur këtë ta diktojnë rrethana të tilla, nuk ke nga ja mban. Do të presësh një muaj. . .

Dhe ne pritëm. . .

TJETËR ARRATISJE

Arratisemi nga katundi. Shkurtimisht peripecitë e një rruge të shkurtër.

Ne nuk mundëm të bëjmë për vete të tjerë shokë. Kjo për dy arsye kryesore.

E para: nuk donim që vendimi ynë të merrej vesh nga i gjithë katundi, sepse kështu, jo vetëm që do të na hiqnin veshët (siç thoshte Minella), por edhe nuk do t'ja arrinim dot qëllimit. E dyta: edhe ato pak përçapje që bëmë, dështuan. Kështu, nuk dëgjoi të vinte me ne as Hali i Nasit, as Nasi i Koçit (që na hiqej si shok me kokë). Po ashtu Gjena e Lonit dhe Liu i Vasit. Më keq më erdhi për Vangjën.

Ah Vangja, Vangja! Ç'ma prishe qejfin. Jo vetëm qejfin, po për pak desh më prishi edhe planet.

Po pse moj Vangja? Pse kështu?

Më erdhi shumë keq që ajo nuk donte të vinte në hekurudhë. Ndoshta këtu u ndanë përgjithnjë rrugët tona të jetës.

Ne pra, mbetëm dy! Çdo ditë planet tona të arratisjes thelloheshin dhe zgjeroheshin me seriozitet të madh. Rugën deri në Fier e dinim symbyllur.

Po më tej? Këtu qëndronte e gjithë puna. Dhe ne arrinim në përfundim se e gjithë kjo punë mund të

rregullohej me të pyetur. Shpesh kisha dëgjuar nga im atë se një njeri me të pyetur, kish vajtur gjer në Stamboll! Dhe ne që s'kishte pse të qemë më të humbur nga ai, do të arrinin jo deri në Stamboll, po deri në Durrës, ku ndërtohej hekurudha. . .

Shumë herë u matëm që planet tona t'ja bënim të njohura edhe mësuesit. Mirëpo dyshonim se ai do të na i përmbyste të gjitha, sikur të mos qe në një mendje me ne. I madhi ja prish të voglit kur të dojë, po kjo nuk e nderon atë.

Mjafton që ai t'u thoshte diçka familjeve tona dhe atëhere, lamtumirë hekurudhë!

Megjithatë, ndihma që mund të na jepte mësuesi, (po të donte, natyrisht), bënte që ne shpesh e më shpesh të mateshim për t'i treguar planet tona. Mua nuk ma merrte mendja që të mos na ndihmonte, meqë ai dukej shpirt njeriu. Po Minella dyshonte.

Më në fund, një ditë aty nga mbarimi i mësimit, unë me Minellën i vajtëm pas në dhomë mësuesit ashtu kokëulur e të heshtur, taman si komplotistë gojëkyçur.

— Ooo, urdhëroni djem, urdhëroni! Pa hë, si është puna? Kini bërë ndonjë faj, apo vini për të sqaruar mësimit?

— Jo mësues, ne nuk bëjmë faje.

— Oh, po e di, e di. Vetëm nganjëherë më të rrallë.

— Edhe mësimit i kemi nxënë përmendësh.

— Edhe këtë e di. Po nuk më thoni atëhere, si është kjo puna juaj?

— Ne kemi një sekret, pasi... por, m'u muar goja dhe e preva fjalën me kaq. Kisha nevojë të mbushesha me frymë.

— Sekret? Pa shih, pa shih! Ju paskeni një sek-

ret? Dhe nguroni kështu përpara mësuesit tuaj, që ju do si bijtë e tij! Si kështu more? Po ju duhet të kini turp që nuk kini ardhur më përpara. Unë nuk jam këtu që t'u mësoj vetëm disa gjëra nga dituria, more djem. Është mirë që ju të më pyesni dhe të më besoni për çdo gjë.

— Po! Ne kemi turp që nuk kemi ardhur më përpara. Kjo punë ka kohë që zien. Vetëm se është sekrete! — tha me nxitim Minella. Paskësaj heshti, duke shikuar me bisht të syrit nga unë. Unë, po ashtu!

— E mora vesh pra, që është sekret. Po më thoni, si qëndron puna?

Nga frika se mos Minella bënte ndonjë hap të ngutur, si djalë i hedhur që ishte, nxitova t'i dal përpara:

— Ne jua themi, vetëm me një kusht.

— Ashtu? Mirë pra, ç'kusht qenka ky?

— Po a do të na e plotësoni?

— Cilin kusht pra, duhet t'u plotësoj? Ju nuk po ma tregoni kushtin, — na tha ai buzëgaz.

— Kushti ynë është ky: ju do të betoheni se nuk do t'i tregoni njeriu, përsa do t'u themi.

— Po çfarë do të më thoni ju?

— Atë sekretin, de!

Ai prapë vuri buzën në gaz me dashamirësi, por unë munda të kuptoj, se mësuesi, mezi po e përmbante të geshurit.

— Jam gati të betohem se do t'ju qëndroj besnik deri në fund. Po çfarë betimi kërkon ju?

— Për ideal!

— Mirë pra! Për ideal që askush nuk do ta marrë vesh nga unë të fshehtën tuaj. Dhe tani më thoni, si qëndron puna?

— Ne... ne kemi vendosur... dhe vendosëm me

gjithë mend, që sapo të mbarojmë mësimet, të shkojmë vullnetarë në hekurudhë!

Mësuesi, i habitur, ndezi një cigare, pastaj na tha plot seriozitet:

— Dëgjoni o trima! Këtu nuk ka asnjë lloj sekreti. Në hekurudhë shkohet me këngë e me valle dhe jo hajdutçe, siç kini menduar ju. Se të shkosh atje është një nder i madh. Është detyrë patriotike. Përse u dashka mbajtur sekret? Vajtja atje është nder aq i madh, sa ju nuk e merrni dot me mend. Unë për këtë u përgëzoj, po në hekurudhë nuk do të shkoni.

— E, të thashë unë? — m'u kthye në çast Minella, duke i mbushur sytë me lot. Aty për aty u kujtova, se trimat nuk duhej të qanin, prandaj ju ktheva i vetëm mësuesit tonë:

— Ne erdhëm këtu që ju të na ndihmoni, shoku mësues dhe jo të na ndaloni. Ju nuk do na bëni këtë. Përndryshe ne do ta lëmë shkollën!

Kjo, natyrisht, që një protestë me vend. Ndoshta disi e ashpër, por me vend. Ne ju hapëm mësuesit tonë se kishim besim të plotë te ai. Po a i kishte hije atij, që të na përgjigjej kështu? Për më tepër, kur ai u betua? Mirë, unë e kuptoj, se si nxënësi i tij, unë mund të jem nxituar ca në këto fjalë. Por, si besnik i tij, a nuk kisha të drejtë?... Mundet që ta kem tëpruar.

E kuptova që e teprova, por që tepër vonë për të kafshuar buzën, apo gjuhën. Ndërsa mësuesi, duke kafshuar me inat cigaren, turfullloi:

— Si? Do të lini shkollën? Hajdeni trima, hajdeni! E ku do të vini si të kini lënë shkollën?

— Në hekurudhë!

— Dëgjoni këtu. Ju jini djem të mirë, shumë të mirë. Edhe shokët i kini të rrallë.

— Përse, atëhere të mos vemi në hekurudhë?

— Se ju jeni ende të vegjël!

— Ne të vegjël? — pyetëm njëzëri me aq habi, sikur këto fjalë t'i dëgjonim për herë të parë.

— Po, të vegjël! Mos u nxitoni. Do të ketë vende sa të duash për të punuar edhe ju në Shqipërinë e re, demokratike dhe popullore. Mos u nxitoni! Hekurudhën e parë do ta ndërtojnë më të rriturit. Atje bëhet punë e madhe, e rëndë. Punohet me hekura, me barre, me dinamit, me barut... Edhe juve do t'ju vijë radha të punoni. Shqipëria jonë do të ketë vazhdimisht nevojë për njerëz që duan të punojnë. Prandaj, ju them të mos nxitoni. Mjafton që të kini dëshirë dhe vullnet. Te ne puna do të jetë mbi të gjitha. Njerëzit e punës do të jenë mbi të gjithë. Ata do të jenë lavdia e Shqipërisë! Kështu që, radha juaj ka për të ardhur shpejt dhe njerëz si ju do të dalin në ballë të punës.

Ne e kuptonim mësuesin. Nxënësi, fundi e ka për detyrë ta kuptojë mësuesin e tij. Por ai nuk na fliste si mësues...

Këto na e shtuan më tepër kurajon dhe dëshirën për të shkuar në hekurudhë!

— Ne do të shkojmë atje, sido që të bëhet. Sado e madhe që të jetë puna, ne prapë diçka do të na zërë dora. Fjala vjen, ne mund të ruajmë lopët e hekurudhës! — thashë unë i vendosur.

Këtu mësuesi, ja shkrepiti të qeshurit dhe duke mbajtur ijet me dorë tha:

— Shiko shiko, lo...lopët, thotë! Ha, ha, lopët e hekurudhës! Atje nuk ka as lopë dhe as derra, more trima! Atje ka hekura, barut e dinamit. Mirë, mirë, meqë kini vendosur, shohim e bëjmë. Ka kohë

deri në mbarim të mësimëve. Pra, shkoni dhe flini të qetë përsa më thatë! Hajde, mirupafshim.

Ne dolëm të hutuar!

— Nuk të thashë unë? — mu sul Minella. Por, ai nuk duhej të më sulmonte. Nuk është ndonjë trimëri e madhe të sulmosh shokun tënd të besës. Sidomos në këto rrethana. . .

— T'i lemë këto tani, Nella. U prish puna. Më mirë t'ja mbathim që sonte. Për dy ditë mësim që na kanë mbetur akoma, nuk do të bëhet qameti. Nuk di pse mësuesit i duken kaq shumë këto dy ditë, po në të vërtetë nuk është ndonjë gjë e madhe! Mendo sikur mësuesi t'i thotë gjë tim ati.

— Po ai u betua!

— U betua xhanëm, po sikur të mos e mbajë?

— Aaa, kjo është punë me zarar! Unë kam dëgjuar nga xhaxhai, se po të mos e mbash betimin, të ther! Të ther në vend, pa një pa dy.

— E me se të ther betimi?

— Ku ta di unë? Se mos e kam provuar ndonjëherë!

Edhe unë kam dëgjuar për diçka të tillë! Po nuk e di a e ka dëgjuar edhe mësuesi. Se nuk bën që për kaq gjë ta theri betimi. Është burrë i mirë.

— Po si të bëjmë, atëhere?

T'ja mbathim, them unë.

— Që sonte?

— Që tani, bile!

— Ashtu thua ti? Mirë, po sikur të na hanë ujqit?

— Pusho frikacak! Unë kam vajtur kaq herë në Fier dhe ujqër nuk kam parë gjëkund.

— As unë nuk kam parë, xhanëm, vetëm se kam dëgjuar për ta.

— Mirë, mirë! T'i lemë këto tani. Duhet të nise-mi. Po si të lajmërojmë në shtëpi?

— Këtë punë ma lerë mua, — tha ai dhe në çast nxori nga xhepi kalem e letër. U ul në gjunjë dhe shkroi:

«V.F. L.P.

Baba! Unë po shkoj në hekurudhë me Zenelin. Në darkë mundësisht lajmëro edhe shtëpinë e Zenelit, që të mos bëhen merak. Po deshe, folë gojarisht me babanë e tij, pasi ai është nevrík dhe ka të ngjarë ta qortojë kur të kthehemi nga hekurudha.

Mos u bëni hiç merak, pasi ne do të punojmë mirë dhe do t'u nderojmë, si pionierë të urtë që jemi!

Minella!

Të fala dhe nga Zeneli».

E palosi letrën më katërsh, e futi në xhep dhe u nisëm. Rrugës, u kujtuam të nxjerrim nga një shkop, sepse siç ka thënë i motshmi: «Në rrugë shkopi të bën punë sa një shok».

Ikim me kokën prapa. Dielli ish zhdukur pas kodrës dhe hijet kishin filluar të zgjateshin. Pra, po afronte ajo kohë që është quajtur si më e përshtatshme nga mjaft njerëz, për të bërë punë të fshehta e gjysëm të fshehta. Se, diçka të tillë kishte edhe në këtë punën tonë.

Në dalje të katundit, Minella i thirri Ritës, një çupe të klasës, që po kulloste qëngjat. Ajo erdhi më vrap.

— Ç'ke kështu, Minella?

— Dëgjo Rita! Një sekret me rëndësi të madhe. Ti, këtë letër, sonte në darkë do ja çosh mamasë sime në dorë, se po t'ja japësh babait, bën vaki që të bërtet. Mamasë thuaji edhe me gojë se unë jam mirë dhe se nuk do të vonohem shumë.

— Po ku do shkoni kështu ju? — pyeti ajo e hutuar, duke na matur me sy të dyve. Sytë e saj të matnin mirë.

— Ne do të vemi në luftë, moj Rita. Atje në hekurudhë bëhet luftë e madhe. Po ti dëgjo, mbylle gojën dhe mos i thuaj gjë njeriut për këto. More vesh? Hajde, mirupafshim dhe mos harro letrën.

— Mirupafshim! — tha ajo me gjysëm zëri.

Vazhduam rrugën, pothuaj duke kërcyer nga gëzimi që edhe puna e letrës u rregullua kaq mirë. Se, në misionet e fshehta, çdo gjë duhet rregulluar mirë, përndryshe, ke marrë fund kur të duash!

Kërcimi në rrugë të gjatë të lodh para kohe, prandaj ne nuk e vazhduam shumë.

— Mirë, po sonte, ku do të flemë? — pyeti papritur dhe tepër i shqetësuar shoku im.

— Ku do të flemë? Pse pyetje është kjo? (Unë, sa herë që nuk përgjigjem dot aty për aty, përpiqem ta zgjat bisedën). Po qe se ty nuk ta mban të flemë përjashta, atëhere do të shkojmë te halla ime. Ajo do të na bëjë petulla, kështu që nesër në mëngjez jemi gati.

— Pse, nuk do të vemi që sonte në Durrës?

— Durrësi nuk është në Fier, more Nella!

— Po ku është Durrësi?

— Durrësi duhet të jetë andej nga ndërtohet hekurudha! Po me që andej po ndërtohet një hekurudhë, kjo do të thotë se Durrësi është ca si larg. Sidoqoftë, për këtë mund të na sqarojë halla.

Përpara nesh dolën tre veta hipur mbi kuaj. Megjithëse nuk i njohëm dot se kush qenë, ndërruam rrugë dhe u futëm në pyll. Këtë e bëmë, pasi kushdo që të ishin, ata mund të na prishnin fare lehtë planet tona.

Kur zhurma e potkonjve po largohej, ne dolëm prapë në rrugë dhe u dhamë këmbëve më shpejt, se dalëngadalë po na mbulonin hijet.

Na u desh të futeshim në pyll edhe dy herë të tjera, për të mos u ndeshur me katundarët që ktheheshin nga qyteti. Ky veprim, ndoshta nuk ishte edhe aq burrëror! Këtë e pranojmë. Por ama, ne nuk kishim tjetër rrugë! Qemë të vendosur, që pa një pa dy të arrinim në hekurudhë.

Në Radostinë, na dolën tre moshatarë përpara. Ata na prenë rrugën dhe na pyetën me kërcënim:

— Ku shkoni ju të dy?

— Në punën tonë! — ja prita aty për aty, duke i matur njëherë me sy për të kuptuar se sa para u bënte lëkura.

— Në punën tuaj ë? — vazhdoi ai që hiqej si kaposh. — Por ne do t'u rrahim. Se ne jemi komandantë të kësaj rruge. Dhe kushdo që guxon të kalojë pa lejën tonë, ne e rrahim! Ja kështu është!

— Mirë, po ku duhet t'i nxjerrim lejet?

— Ku t'u pëlcastin!

— Jo more!

— Po more!

Në çast, gjakërat u nxehën vërtet dhe nuk dihej se si do të përfundonte ky takim, sikur të mos kish mbrritur aty xha Hakiu me biroçë. Ai qe një miku i tim eti dhe unë nuk dija ku të futesha nga turpi.

— Zenel, ç'po bëni ju këtu në mes të udhës?

— Po ja xha Haki, këta çunat tuaj duan të na rrahin!

— Si? Duan t'u rrahin? — dhe ai zbriti nga biroça. Në çast të tre trimat u bënë tym e s'panë nga ikën.

— Hy, qërrohuni gjidi majmunë! Po ju të dy ku

vini kështu? — na u kthye pastaj neve me një ton atëror. Kjo pyetje, më kapi në befasi. Desh e humba fare! U përgjegja ashtu gëc-mëc:

— Po ja, te xha Dalipi. Halla është malluar për mua. Unë mora edhe Minellën, meqë ne të dy nuk ndahemi.

— Sa mirë, sa mirë! U paska ndihur fati. Edhe unë për te Dalipi jam nisur. Pra, hopa kolopuçër, hidhuni në biroçë dhe kapardisuni aty si dy gjela, se rrugën e kemi bashkë.

Ne u hodhëm në biroçë, po nuk u kapardisëm si dy gjela, me që gjel na dukej vetë xha Hakiu dhe tre gjela në një biroçë nuk mund të bëheshim!

E kisha provuar edhe herë të tjera, se rruga në biroçë është më e këndshme nga rruga më këmbë. Po këtë radhë m'u duk akoma më e këndshme... Eh, sikur të shkonim me këtë biroçë deri në hekurudhë!

— Domethënë ju të dy jini mysafirë sonte, apo jo? Bukuri! Bukuri! E, halla do t'u bëjë petulla dhe pastaj do ja shtroni me gjumë. Po me mësim si vini?

— Ne të dy vemi mirë me mësim, xha Haki.

— Po, kam dëgjuar! Unë kam dëgjuar vetëm për Zenelin, po me që ju jini shokë, kjo do të thotë, se edhe ti mëson mirë! — ju kthye Minellës. — Mësoni, djema, mësoni, se jeta për ju është. Ne e kullotëm çairin tonë. Kurse ju çairin tuaj duhet ta kullotni ndryshe. Fare ndryshe!

Kjo puna e kullotjes së çairit, megjithëse nuk e dëgjoja për herë të parë, mua më çudiste. Ne nuk gemë as lopë dhe as viça që të kullotnim në çair. Po ashtu nuk qenë të tillë edhe ata që thonin se e pas-këshin kullotur... Por, nuk guxova ta pyesja xha

Hakiun, meqë ai ishte më i madh, ishte me biroçë dhe dinte ç'liste.

Ai nuk flet kurrë kaluar! — thoshte për të im atë. E, megjithatë xha Hakiu nuk zbriste nga biroça kur fliste!

PËRPARA

Petullat e hallës dhe Qanua i saj. Ne bëhemi tre dhe nisemi për rrugë të gjatë.

Përpara nesh u hapën dy kanatat prej hekuri të një porte të rëndë. Kuptohet se kanatat nuk u hapën vetëvetiu, por vetëm pas trokitjes së fortë të xha Hakiut.

Biroça u fut në oborr. Aty na pritën xha Dalipi dhe halla. Pastaj doli Qaniu me të motrat, të cilat, unë, sipas nënës, i kisha kushërira të para. Sa për Qanon, atë e kisha vërtet kushëri dhe këtë gjë e dija pa ma thënë nëna. Ai vinte shpesh verës te ne, po motrat nuk qenë dukur ndonjëherë.

Qaniut i pëlqenin fort manat dhe rrushi, ashtu si edhe mua. Ja që ne ngjanim si kushërinj! Sa për bostanët, ai nuk para i vinte në gojë, vetëm rrallë herë pas buke donte nga një pjepër me vete.

Si u përshëndetëm të mëdhenj e të vegjël, halla me krahët e saj të gjatë na përfshiu dhe na futi brenda.

Të mëdhenjtë u veçuan në dhomën e pritjes, kurse ne të vegjëlit, në kuzhinë. Kjo është një punë e mirë dhe unë mendoj se nuk ka si bëhet ndryshe. Të vegjëlit gjithmonë duhet të futen në kuzhinë.!

Halla, si na puthi edhe njëherë në të dy faqet, doli me nxitim jashtë dhe ne mbetëm të rrethuar nga kushërirat e mia. Qanua rrinte pak më lart dhe se çfarë bënte mbi një sepet.

— Po ti Qani, me se merresh? — e pyeta pa patur ndër mend t'i prish punë,

— Po ja more Zenel, mamaja ka bërë një alamet byreku dhe ne s'kemi ngrënë as gjysmën akoma. . .

— A, pse për atë s'po të zë vendi ty? — ju kthye me inat Buçi, motra e tij e madhe. Ajo në çast u ngrit e përzuri nga sepeti. Qaniu, pa bërë fjalë, erdhi dhe u ul te ne. Mua, të them të drejtën, më erdhi shumë rëndë, që atë e përzuri e motra. Te ne kjo nuk do të ngjiste kurrë. Ne ishim më trima. Sidomos me femrat.

Pas pak u ndie krakërima e fundit e një pule, që me sa dukej, halla ja këputi kokën për hatrin tonë. Edhe për këtë më erdhi keq. Ç'kusur kishte pula pse shkelëm ne aty? Po ja që ajo e pësoi dhe fjalët genë të kota!

— A dalim një xhiro djema? — propozoi Qanua. Unë nuk e prita me kënaqësi këtë propozim, pasi jo vetëm isha i lodhur nga rruga, po edhe pse mendoja për rrugën që do të bëja të nesërmen.

— Po ku do të dalësh more, ku do dalësh tani? — ju sul atij e motra, Buçi. — Çudi, çfarë njeriu! Si nuk rri dy minuta në një vend, xhanëm! Kini parë të tillë millet ju?

Unë u mata t'i përgjigjem, se kishim parë diku, po Qanua s'më la radhën.

— Ama dhe ti Buçi! Më je bërë si ferrë! Pse moj, pulë jam unë që të ngulem të vatra që tani? Unë dola djema. Po deshët ejani. Ju pres te porta! — dhe fluturoi jashtë.

— Mirë, mirë, po ta rregulloj unë ty te xhaxhai!
— Ja ktheu me inat Buçi. Xhaxha, ajo i thoshte të
jatit, ashtu siç i flas edhe unë xha Dalipit.

Qanua doli dhe ne mbetëm si me turp! Ai më
priste te porta, kurse unë isha ngulur te vatra si ma-
çok. Pashë ç'pashë dhe pasi i bëra shenjë Nellës,
u çova. Pas meje edhe Minella.

— Po rrini more Zenel! Pse mëntë e atij të kri-
suri do të merrni ju? Atij ja ndreq unë te xhaxhai,
kini për të parë ju! — më tha Buçi.

— Nuk do të vonohemi! — ja ktheva unë, pa
besuar se ajo do t'ja ndreqte samarin të vëllait, pasi
xha Dalipi nuk qe marrë kurrë me të tilla punë. Ai
qe berber dhe kurrë nuk kishte ndërruar zanat.

Te porta Qaniu na futi krahët dhe ne dolëm të tre
në rrugën e gjerë. Qe bërë natë. Këtë e vërtetonte jo
vetëm errësira po edhe qielli i mbushur plot e përplot
me yje. Çudi, sa shumë yje!

— A doni karamete? — na pyeti Qaniu. Pa pritur
përgjigjen tonë, në se deshëm apo jo, u nis për te
dyqani në anë të rrugës.

— Dua njëzet lekë karamete! — i tha shitësit
dhe ai, pasi na përfshiu me një shikim të ëmbël, i
dha karametet Qaniut. Im kushëri i ndau në tri pjesë
të barabarta. Si u larguam ca, Qaniu më pyeti:

— Po ç'të reja kemi andej nga katundi, more
Zenel? A do të shqepemi me rrush sivjet? Po vreshti
i babë Xhelos, si është? — pyeti ai për vreshtin e
dajos së tij.

Si njeri me edukatë që qe, atij i takonte të pyes-
te më përpara për babë Xhelon dhe pastaj për vresh-
tin e tij. Po Qanua, gabime të tilla i bënte dendur,
veçse pa të keq.

Përpara nesh po kalonte një çun me një pako në dorë.

— Hej, Xhepi! — i thirri atij Qanua.— Pa hajde këtu!

Xhepi u kthye dhe erdhi e na qëndroi përballë. Ishte një djalë i pakët, me një palë pantallona të shkurtëra e plot arna. Disi më tepër se në ato tonat.

— Ku shkon kështu? — e pyeti rëndë-rëndë Qanua.

— Në shtëpi, — ju përgjegj Xhepi me një ton fajtori, megjithëse unë kurrë nuk do ta merrja me mend, se ç'faj mund të kish bërë Xhepi.

— A është e vërtetë, se ti ke kapur nga bishti atë maçokun tim të bardhë? — e pyeti me kërcënim Qanua.

— Jo Qano, qafsha të gjithë, jo!

— Thuaj të drejtën!

— Jo pra. Kur të qaj të gjithë. . .

— Thuaj të drejtën, se mua nuk ma hedh dot. Po qe se i ke kapur bishtin, unë do të të kap veshëf! — dhe Qanua e kapi nga të dy veshët, gjë që nuk më bëri përshtypje të mirë.

Kisha parë e bile kisha provuar edhe në veten time të kapurit nga njëri vesh. Por ama, ta kapje tjetrin nga të dy veshët, për të parën herë ma zinte syri!

— Lere Qano! — i thashë unë me një ton të prerë, pasi e kisha provuar edhe herë të tjera se ai nuk ma bënte dy.

— Eh Zenel, nuk e njeh ti se ç'ngackë është ky që të duket kaq i humbur. Mirë, këtë radhë po e fal, vetëm se i ziu ai po i ra prapë më qafë maçokut tim të bardhë.

Në të vërtetë Qanua është vetë ngackë, ndaj

shpesh mua nuk më pëlqen. Edhe me mua është ngatërruar ndonjëherë më të rrallë. Por, unë, si katundar që jam, nuk ja zgjat shumë. E rrok për beli dhe e vë poshtë. Harrojmë që jemi kushërinj të parë dhe përleshemi një copëherë. Unë e bëj zap. Ai kurrë nuk ma merr për të keq!

Në këto raste zënkash, nëna më këshillon të mos prishem me të, se e kam kushëri të parë dhe se ai është i dashur në shpirt. Dakord, ashtu është. Edhe unë jam i dashur në shpirt, po si të bëj kur më bien më qafë?

Kur u kthyem te halla, buka që në të shtruar e sipër, gjë që na gëzoi.

— Po ku humbët, mor kolopuçët e hallës! — na përkëdheli ajo, duke na ulur rreth sofrës.

Qanua, sapo filluam bukën, më tha papritur:

— A e di ti Zenel, se unë jam i pagjarpë?

— E përse qënke i pagjarpë? — e pyeta, duke mbajtur të qeshurit. E pashë se këtu diçka luante, po nuk duhej të qeshja jashtë masës, se isha mysafir. . .

— As unë nuk e di, po mamaja kështu më thotë.

— Ha këmbët tani! — i hoqi vërejtjen e jëma.

— Ja e dëgjon si thotë, Zenel? Ha këmbët! Po a hahen këmbët? Dhe ja ta zemë se e bëra këtë proçkë. Po me se do të eci pastaj?

— Aq de! Leri njerëzit të hanë bukë, o i palyrë! Kur ha bukë nuk bën të flasësh! Se të zihet në fyt, — e këshilloi halla.

Qanua është tërë qyfyre, vetëm se unë nuk e kuptoj, përse nuk i le për pas buke ato qyfyret e tij, pasi në të ngrënë e sipër, dy herë desh u mbyta nga të qeshurat.

Më në fund na shtruan një tas me petulla dhe një tjetër me kos. Gostia karakteristike e hallave.

Nëna, shpesh më këshillonte: te të tjerët duhet të hash me terbiet. Të mos përtypesh shumë, të mos hash shpejt sikur nuk ke parë bukë me sy...

Këto qenë fjalë me vend dhe unë isha dakord me të. Vetëm për atë punën e të ngrënit shpejt, kur je me Qanon nuk ke nga ja mban. Po të hash me terbiet, ai të lë me gisht në gojë.

Na shtruan të treve bashkë në një cep të dhomës. Ne ishim vetëm. Unë gëzohesha që nuk na pyetën përse kishim ardhur. Pra, e morën për një ardhje të zakonshme, siç qëllonte shpesh.

— Nesër nga do t'ja mbajmë? — pyeti papritur Qanua.

Kam vënë re se në shtrat njeriu ka më tepër besim, si te të tjerët, ashtu dhe në veten e vet. Unë vendosa t'i hapem Qanos. Ai nuk do të na tradhëtonte. Ai qe shpirt njeriu. Mund të jetë ca i pagjallpë, siç thotë halla, po i pabesë nuk është.

— E kemi sekret! — ja ktheva. — Ty ta tregojmë, por me kusht që të mos ja zësh njeriu në gojë.

— Po pse, ç'më bëtë ju mua!

— Jo, po duam që të mos e marrë vesh njeri. Se ne jemi nisur për në Durrës. Do të vemi në hekurudhë.

— Atje do t'i kaloni pushimet e verës?

— Po, atje do të shkojmë për të ndërtuar udhën e hekurt. Atje ka shkuar edhe Pajua vet i gjashtë.

— Shikoni, shikoni, po rrush dhe bostan a ka atje në hekurudhë? — pyeti Qanua me seriozitet. Megjithëse nuk isha i sigurtë për këto, puna ma donte të përgjigjesha disi prerë:

— E përse të mos ketë rrush dhe bostan?

— Kjo do të qe një punë e bukur! Po, e bukur! Mirë pra, e përse të mos vi edhe unë me ju?

— E përse të mos vish, de?

— Hajde, me besa-besë, të mos ndahemi kurrë nga shoku-shoku.

— Hajde!

Dhe të tre, nën jorgan lidhëm duart e dhamë besën, për të mos u ndarë nga njëri-tjetri. Pas kësaj bese të madhe ne na zuri një gjumë i thellë!

...Pashë ëndërra të bukura atë natë... Aq të bukura sa që nuk i kujtoja dot ashtu siç i pashë... Ku ta dish... Ndoshta i shikoj prapë. Se ishin aq të bukura, saqë ja vlen t'i shohësh për së dyti.

NISEMI DHE MBËRRIJMË

Gazmorë, me shumë besim dhe me pak aventura, arrijmë te vendi për ku ishim nisur.

Të nesërmen, pasi u hoqëm mënjanë, siç u ka hije shokëve të besës, Qanua më pyeti:

— Po tani?

— Tani duhet të nisemi për në Durrës! — ju përgjegja i vendosur.

I vendosur, po pa e patur as vetë të qartë, se si do të bëhej kjo nisje për në Durrës. Nisja e sidomos, mbërritja!

— Për këtë do të shkojmë në agjenci, — tha Qaniu dhe na udhëhoqi drejt vendit, të cilin ne nuk e dinim se nga binte dhe çfarë ishte.

Te agjencia që një gjurulldi e vërtetë! Njerëzit shtyheshin përpara një barrake. Ishte barrakë, ndërsa i thonin, agjenci! Dëgjoheshin vetëm britma, klithma, zënka.

— Një biletë, shoqeeee!

— Shoqe, mua një biletë...

— Moj Vangjë, po e kam unë radhën, moj të shkretën!

— Shoqe, u dërmova moj shoqe!

U afruam me ndrojtje te gjurulldia. Ndërkohë

mua më shkeli në këmbë një goxha këpucë ushtarake, po i zoti i saj nuk qe ushtarak.

Kështu, unë u hoqa mënjanë nga lufta, pa arritur ende të futem në betejë.

— Po ti piçiruk, ku do vesh? — më pyeti një burrë i parruar e me flokë të gjata.

— Në Durrës! — ju përgjegja me ndrojtje.

— Po a ke prerë biletë?

— Jo!

— Mirë, m'i jep mua paret, se ta pres unë biletën. E ku merr dot ti në këtë kaladibrance.

— Pse, me lekë janë biletat? — pyeta jo fort i sigurtë, duke parandjerë se kisha këputur një budallallëk me brirë.

— Unë kështu e di, po ti provoje njëherë se mos e pret pa lekë! — ma pat me përçmim mirëbërësi dhe më ktheu krahet.

Aty për aty, kuptova se këtu kisha të bëja me një tjetër botë, e jo si në katundin tim të qetë e të humbur. Prandaj duhej të mos nxitohesha në muhabete me njerëzit e të mos këpusja ndonjë proçkë tjetër.

Kështu thoshja unë me vete i mbështetur në atë qoshe muri larg përleshjes së biletave. Po nuk qe e thënë të më linin të qetë. Atë çast mbi mua u vërvit një pallto, dikush uluriti, pastaj u dëgjua një e sharë:

Ç'kishte ngjarë pra? Si shpërtheu papritur ky sherr? Por këto as sot e kësaj dite nuk arrita t'i mësoj!

Si pushoi gjurulldia, unë kapërceva derën pa e kthyer kokën pas. Nuk desha të më kapte aty ndonjë tufan tjetër.

— Po ku humbe, o i uruar! Ne menduam se të gamë, — tha Qanua, duke më futur krahun.

— Lere, lere se ç'vajti!

— Mirë, mirë, po tani si do të bëjmë? — pyeti Minella.

— Si do të bëjmë? Unë them të nisemi më këmbë, — propozoi Qanua.

— A thua? — pyeta unë me mëdyshje. Po për të mposhtur çdo keqkuptim, vazhdova: — Më këmbë! Kjo është gjë e bukur. Po kush e di rrugën, se! Dhe a është larg?

— Deri në Lushnjë e di unë. Më tej do e gjejmë me të pyetur. Nuk besoj të jetë shumë larg, — tha Qanua.

— Përse nuk beson të jetë shumë larg?

— Se boll larg është Lushnja. E po të jetë shumë më larg Durrësi, atëhere i bie të jetë në fund të botës.

Ky arësyetim i Qaniut m'u duk i drejtë. Hapin e parë e hodhi vetë Qanua. Dhe kështu u nisëm! Më të dalë të qytetit, ne qëndruam sa për të nxjerrë tre shkopinj nga një frashër i moçëm.

Dalëngadalë filluam të djersitim. Kishim ecur goxha, kur na doli një çezëm përpara. U freskuam dhe u ulëm.

— Unë nuk jam lodhur fare! — tha Qanua.

— As unë! — pohoi me gjysmë zëri, Minella.

— As unë! — e pashë të udhës të them edhe vetë për të mos mbetur me turp përpara vërsnikëve. Ama, isha lodhur që ç'ke me të.

Udhëtimi më këmbë është një gjë e bukur. Sido mos po të mos lodhesh aq tepër nga këmbët.

Aty nga mesdita, Qanua na tha se dhe pak rrugë na kish mbetur.

Në këto e sipër ja mbërriti një karrocë nga Fieri.

— Të kujt jini or çuna? — pyeti karrocieri, pasi nduku frerët.

— Të Dalip Hadërit! — ja ktheu serbes Qanua.

— Aaa, çunat e zotit berber? S'e dija që paska tre binjakë. Po ku shkoni kështu?

— Në Çermë, te një miku i xhaxhait!

— Po pse më këmbë?

— Se ashtu na u duk më mirë. Thamë ta provojmë njëherë më këmbë. Me këmbët tona!

— Shumë mirë, shumë mirë! Ju jini trima. Tani hipni në karron time, t'u çoj deri në Lushnjë, pa do kini kohë për të ecur më këmbë.

Ne hipëm, pa pritur të na thoshte dy herë, ashtu siç e kërkon edukata. Me sa dukej, qemë lodhur më shumë nga ç'pandehëm.

Si bëmë një copë rrugë, karrocieri, pyeti Qanon (me sa kuptova, atë e mori për të parë të binjakëve, gjë që nuk ishte aspak e vërtetë).

— Po sa para do më paguani mua?

— Ooo, ç'para more! Po ti na ftove vetë të hy-pim, — ja ktheu Qanua.

Dhe bëri mirë, se ashtu qe me të vërtetë.

— Shiko, shiko! Edhe ti kapedan, si zoti Dalip dashke të bëhesh. Po këta dy vëllezërit e tu, mos janë gjë memecë?

— Po të dy. Ky këtu, — i tha Qanua duke u drejtuar me paturpësi nga unë, — është shurdhuar para disa vjetësh nga plasja e një bombe. Ajo qe një bombë aq e madhe, sa karroca jote. Kurse, ai tjetri është memec i lindur. Po megjithatë, janë çuna të mirë. U jepet për çdo punë dhe xhaxhai thotë, se nuk do t'ua hajë qeni shkopin.

— Duken, duken, — ja ktheu karrocieri, duke na parë me dhëmshuri. — Si more, njëri shurdh e tjetri memec? Gjynah nga perëndia! Goxha djem. I gjori Dalip. Nuk i paska ecur fare me binanë? Eh, botë, botë! — dhe s'kuptova përse karrocieri psherëtiu thellë.

Por unë nuk mund ta pyesja, pasi isha shurdh e, si i tillë, nuk duhej të kisha dëgjuar gjë.

Megjithatë, si pa e kuptuar as vetë, po merrja inat me tim kushëri që gënjente kaq hapur. Vërtet që edhe ne në fshat gënjejmë nganjëherë, po jo kështu, ama. Kaq sheshit dhe kotsëkoti. Pastaj, kur na del në shesh e vërteta, na pi e zeza. Po, unë isha i sigurtë se Qanos këtu nuk kishin për t'i dalë lakrat dhe nuk do ta pinte e zeza.

Për më tepër, nga njerëz kaq të mirë si ky karrocieri baballëk. Unë do ja nxirrja në shesh një nga një të palarat Qanos, sikur turpi të mos rëndonte mbi xha Dalipin. E kërcënova nja dy herë me grusht Qanon, po ai s'ma vari. Në fund e pickova në këmbë. Ai u hodh përpjetë dhe karrocieri e pa me habi!...

Në këto e sipër, kishim arritur në Lushnjë. Unë dhe Qanua, falënderuam karrocierin, kurse Minella, si memec që ishte, duhej të bënte një shënjë falënderimi. Po ai nuk qe mësuar me shënja dhe do e kishte përsheshur gjithë muhabetin, sikur Qanua të mos e kishte tërhequr fort për mënge.

Në Lushnjë u kthyem në një kafe, në murin e së cilës që shkruar me gërma të mëdha e të shtrëmbëra: «Veresie s'ka». Pimë nga një dhallë të freskët. Këtë e pagoi Qanua, pasi nuk di me ç'marifat kishte marrë ca të holla me vetë.

Në të dalë të Lushnjes, u kthyem nën udhë dhe u çlodhëm ca. Qanua zgjidhi grykën e trastës dhe na dha disa nga ato petullat, të cilat ne mbrëmë nuk i hanim dot me kos. Ndërsa sot, pa kos dhe të ftohta, ishin aq të shijshme, sa nuk lamë asnjë thërrime.

— Ti Qano, mos gënje kaq shumë dhe mos u bëj aq edepsëz, të mori djalli, të mori! — ja nisa unë.

— Ne jemi nisur për në hekurudhë dhe nuk na ka hije të sillemi si rrugaçë. Përpiqu të na zbavitësh me të tjera çudira dhe jo me gënjeshtër të tilla.

— Ama ç'na the. Turp është të vjedhësh dhe jo të gënjesh. Unë të kam ditur më të zgjuar.

— Jo, jo. Edhe ashtu edhe kështu turp është.

— Po Durrësi, a është edhe shumë larg — pyeti Minella.

— Besoj pas asaj kodrës atje përtej do të jetë, — ju përgjegj Qanua, duke shënuar diku në hapësirë.

Nata na zuri në Çermë. Si e pleqësuam një copë herë se ku do ta shkonim natën, vendosëm të kthehemi në ndonjë shtëpi, megjithëse, unë nuk isha për këtë. Unë doja të flinim përjashta, po Qanua me Nellën, si trima që ishin, shfaqën dyshimin se mos na hante ujku.

U kthyem në të parën shtëpi në anë të rrugës. Na doli përpara një grua myzeqare e thyer në moshë.

— Mirëmbërma! — e përshëndetëm ne.

— Mirësevini djema! — tha duke e parë disi me habitje këtë treshe shtegëtare.

— Nëno, a do ketë mundësi ta kalojmë natën këtu? — pyeti me njerëzi Qanua.

— Urdhëroni, urdhëroni brenda! — na ftoi ajo.

Çdo gjë në këtë vend na u duk mikpritëse, me përjashtim të një qeni të zi, i cili nuk donte t'i ndërpriste të lehurat edhe pasi kishim hyrë brenda. Çudi, se ne andej, qentë i kemi më të edukuar.

— Unë jam vetëm me nusen e djalit, — na sqaroi e zonja e shtëpisë. Djalin e kam në ushtri. Burrin ma ka vrarë Hamit Matjani, që e gjetë nga mos e pandeh-të, siç do ta gjejë një ditë.

Shtëpia që përdhese. Puro myzeqare! Muret qenë kallam me baltë. Çatia që nxirë e tymosur nga zjarri i oxhakut.

nën e zotit, që nuk dashka t'ja dijë për doktor. Këtë radhë Qaniu po vepronte me mend dhe unë e pashë të udhës të futem në valle, duke mbajtur anën e tij. Këtë gjë e bëja më shumë për hatër të dokoreshës Meri se për Qanon.

Unë nuk e njihja dokoreshë Merin, po në shtëpi kisha dëgjuar se ajo mjekonte dëndur fëmijët jetimë dhe të varfër. Kështu që për të kisha edhe respekt edhe mirënjohje. Sikur të sëmuresha ndonjëherë, unë do të vizitohesha vetëm te ajo. Po ashtu dëshëroja që edhe fëmijët e tjerë të shkonin vetëm te ajo dokoreshë zemërmirë.

I sëmuri kishte nevojë për doktor dhe jo për perëndi. Unë i fola për dokoreshën Meri dhe për malarjen e tim vëllai. Për tim atë që nuk e kishte zënë fare në gojë perëndinë dhe megjithatë, im vëlla u shërua. Xhaxhua na dëgjonte me mëdyshje. Po sado të na dëgjonte me mëdyshje, ne qemë dy. . .

Në Rrogozhinë Qanua na bleu nga një kulaç dhe ne po e përtpnim me përpjekje të mëdha. Unë kurrrë nuk kisha vënë në gojë të tillë kulaç në jetën time. Stralli qe diçka tepër i butë në krahasim me këtë kulaç.

Me përpjekje vetëmohuese, duke rrezikuar nga rrënjët dhëmbë e dhëmballë, i përtpnën më në fund kulaçët e hekurt.

— Po ju pionierë, ku shkoni kështu? — buçiti prapa nesh një zë.

Kthiem kokat dhe pamë një burrë shtatlartë, me mëngë të përveshura dhe me një bidon në dorë.

— Në hekurudhë! — ja ktheva unë disi me ndrojtje. Ndoshta s'duhej folur me këdo për planet tona të fshehta.

— Jo bre! Si o në hekurudhë? Doni të bëni sehir, ë?

— Po ne... jo, ne duam edhe të punojmë, — u përpoqa ta sqaroj unë disi i çuditur, që ai nuk po i merrte dot me mend këto gjëra kaq të thjeshta.

— Për të punuar! Ju qenki djem shumë të mirë. Epo, hajdeni se u eci fati. Do t'u çoj me maqinën time. O burrani, hipni lart. Veç rrini ulur, mos u varni në sponte dhe mos i bini kabinës me grushte.

Ne aq deshëm. Sakaq u shtruum në karroceri, si në shtëpinë tonë. Dhe kabinës nuk i ramë me grushte. E përse ta bënim atë punë?

— Kësaj here me të vërtetë na eci fati! — tha Qanua, pasi u nis maqina.

— Ky shofer duhet të ketë qenë partizan! — nuk di sepse më ërdhi ky mendim.

— E përse duhet të ketë qenë partizan? — pyeti me të drejtë Minella. — Unë them se... po atë çast maqina u shkund mirë në një gropë, gjë që e bëri Minellën të kafshojë gjuhën.

— Po shoferi përse nuk na porositi që edhe të mos flisnim gjatë rrugës! — u ankua Minella. Por atij nuk i ktheu njeri përgjigje.

Ankesa e tij mbeti e pasqaruar dhe ai nuk u kthye më te ajo. Udhëtimi me maqinë ishte më i këndshëm se ai më këmbë. Unë më përpara kisha patur rast ta provoja këtë, por kësaj radhe u binda plotësisht.

Unë doja që maqina të ecte më mengadalë, meqë nuk po vëreja mirë se çfarë po linim prapa më të djathtë e më të mëngjër. Desha të shikoj me hollësi çdo gjë, në mënyrë që të kisha me se t'u mburresha vërsnikëve kur të ktheheshim.

Shoferi, sikur të ma kish kuptuar dëshirën, e

ngadalësoi shpejtësinë dhe më në fund qëndroi. Në anë të rrugës, gurgullonte një çezëm. Ne u hodhëm menjëherë poshtë.

— Hë trima, si ja kaluat? A do të pini ujë? — na pyeti, shoferi.

— Oh, plasëm! Aty në maqinën tënde ishim si në gjalpë — ja ktheu i pagjalpi Qano, që rrallë na linte radhë për të folur ne të tjerëve.

Shoferi, si mbushi e zbrazi në maqinë disa gaveta me ujë, ndezi një cigare dhe hipi në timon.

— Mbahuni djema se dhe pak rrugë na mbeti.

Sakaq, maqina jonë e shpejtë si era, u lëkund dhe pastaj u vërsul përpara me vrapin e një pele të pavrarrë ende nga shala.

Ne na dukej sikur fluturonte, gjë që bënte të mos i ndjenim as gropat e udhës, as lëkundjet e karrocërisë.

HEKURUDHA

Paraqitja dhe pranimi. Të mëdhenjtë e hekurudhës.

Ne arritëm në hekurudhë, por jo në Durrës. Me sa dukej, në këtë mes kish patur një keqkuptim. Durrësi, për çudinë tonë, qe ende larg. . .

Mbi xhade, ne u takuam me rreshtat e parë të vullnëtarëve të cilët ecnin me kazma, lopata e karro dore.

Shoferi na zbriti përpara disa barrakave dhe u nis prapë në punë të tij.

— Po tani? — pyeti Minella i hutuar, duke shikuar rreth e rrotull.

Në fakt, ne të tre ishim aq të hutuar, sa që edhe po të kishim zbritur në ndonjë planet tjetër, nuk do ta kishim humbur kështu pusullën.

Dikush vraponte me karro dore duke bërtitur, «Hapni rrugën kalon harusha», një tjetër ngulte kazmën, më tej dikush thyente gurët me varë.

— Tani duhet të paraqitemi te i madhi i hekurudhës, — tha Qanua dhe ne bëmë përpara. Duhej të pyesnim dikë, se kush qe i madhi i kësaj hekurudhë. Mirë, po kë të pyesnim se! Këtu, të gjithë ishin aq shumë të zënë me punë, sa që nuk të bënte zemra t'i pengoje duke u bërë pyetje.

Ja, përballë nesh po vinte një burrë me dy varë në dorë. I nxirë nga dielli. I veshur me një gjysëm këmishe dhe me pantallona deri në gju. Megjithëse pamja e tij m'u duk disi e ashpër, unë i dola para dhe e pyeta:

— Me leje shok! Kush është këtu i madhi i hekurudhës?

— I madhi i hekurudhës? Ha, ha, ha... Këtu or mik, të gjithë jemi të mëdhenj. Prandaj ma thuaj me emër se kë kërkon:

— Po unë nuk ja di emrin!

— Në qoftë se nuk di se kë kërkon, hapëm rrugën, se unë nuk kam ngenë tënde! — dhe ai bëri përpara i nxituar.

Në këto e sipër drejt nesh po vinte një azgan. Ai mbante në dorë një varë të madhe me bisht të thyer. «Ky, me siguri, duhet të jetë kovaçi i hekurudhës», thashë me vete dhe vendosa ta pyes. Në Fier njihja dy kovaçë shumë të sjellshëm. Me të vërtetë ashtu më doli edhe ky i hekurudhës.

— Ju kërkonit të madhin e hekurudhës? Pa ejani me mua, ejani.

Ai përpara, unë pas. Pas meje dy shokët e mi. Përpara një barrake, ai uli varënë dhe hapi një derë. U futëm në një dhomë me një tryezë në mes dhe me disa karrike dosido anash.

— Pa më thoni, nga vini dhe si është puna? — na pyeti me një ton dashamirës kovaçi, sapo u ulëm. Zëri i tij më dha kurajo ta mirrja vetë fjalën. Këtë më shtynte ta bëja edhe një tjetër shkak. Nuk doja që Qanua të niste nga përrallat e tij.

Ne këtu kishim ardhur në hekurudhë, pra nuk na kishte hije të gënjenim, ashtu siç bënte me këdo Qanua.

Nuk e di pse më që mbushur mëndja, se në hekurudhë s'kishte gënjeshtarë. Se s'kishte si të ngrihej me gënjeshtër një udhë e hekurt, ku njerëzit punonin dhe edukoheshin.

— Po ne shok, deshëm të takonim atë të madhin e hekurudhës, — i thashë pa më shkuar ndër mend se mos e fyeja.

Dhe me të vërtetë, ai nuk u fye aspak.

— Ja pra, unë jam i madhi i hekurudhës! Ju mos jini ndonjë delegacion pionierësh që kini ardhur të na vizitoni?

— Jo, për vizitë nuk kemi ardhur. Ne kemi ardhur, si të thuash, ashtu si vullnetarë, për të punuar tre muaj këtu në hekurudhë! — i thashë me një frymë nga frika se mos ma prishte fjalën në mes.

— Shiko, shiko! Vini vullnetarë, ë? Po kush u tha ta bëni këtë punë, o çapajeva?

— Ne... ja, ashtu e bëmë, si të thuash, me kokën tonë.

— Dhe prindërve me siguri nuk u kini marrë leje, apo jo? — pyeti ai, gati i sigurtë, prandaj mund të mos i përgjigjeshe, meqë kjo merrej me mend fare lehtë nga pamja jonë. Po unë për edukatë, ja ktheva.

— Ne nuk u kemi marrë leje prindërve, jo pse jemi rrugaçë, por trembeshim se nuk do të na linin. Pa leje këtu kanë ardhur edhe shumë të tjerë.

— Shiko, shiko! Po nga e dini ju këtë?

— E si nuk e dimë? Këtu ka ardhur edhe im vëlla para një muaji vet i gjashtë. Edhe ai ka marrë me vete disa pa lejen e prindërve. Këto m'i tregoi vetë që të mos bëheshin merak nga shtëpia.

— Shiko, shiko! Prej nga vini ju pra dhe cili qenka ky yt vëlla?

— Nga Fieri. Im vëlla është Pajua.

— Pse, nga Fieri qënki ju?

— Jo, ne banojmë në Fier. Nga Fieri është vetëm Minella, — sqarova unë, duke treguar shokun tim, — kurse ne të dy jemi nga Kurveleshi.

— Shiko, shiko! Nga Kurveleshi! Bre, bre, si nuk m'u ndanë asnjëherë këta kurveleshasit, xhanëm! Në batalion, kurveleshas, në brigadë, kurveleshas, në hekurudhë, po kjo. Besoj se dhe në hënë po të vete, kurveleshas do të gjej. Hej, njerëz interesantë paskeni qënë...

— Po ç'të keqe ka në këtë mes, o shoku komandant! — protestova unë, pa qënë i sigurtë, në se i duhej folur, komandant apo ndryshe.

— Jo xhanëm, të keqe nuk ka. Unë, si të thuash, do t'ju falënderoj nxehtësisht për vullnetin tuaj dhe do t'ju kthej për në shtëpi me maqinë.

— Si? Pse robër lufte jemi ne, që do të na ktheni në shtëpi? — shpërtheu në çast Qanua, që deri atëhere kish duruar shumë pa folur.

Të them të drejtën, mua më hante parreshtur frika e tij, se e dija që nuk do t'i rrihej pa këputur ndonjë aguridhe. Sidoqoftë, këtë radhë më erdhi mirë, pasi ai tha një fjalë me mend.

— Shiko, shiko! — tha dhe ja shkrepiti të qeshurit komandanti kovaç. — Mor, po ju qenki brisk nga goja. Ju do më lidhni mua, kështu siç e kini filluar: Po mirë, pa më thoni, si erdhët që nga Fieri?

Ne i treguam për rrugën tonë të larmishme. Dhe si mbyllje thamë:

— Siç e shikon shoku komandant, ne mezi arritëm këtu. Po edhe sikur fare më këmbë të kishim mbetur, ne prapë do të arrinim. Në mos sot, nesër, fundja edhe pasnesër! Kurse këtu, ju doni të na ktheni në shtëpi. Hiqeni këtë mendje. Po e bëtë këtë,

ne do të qahemi më lart. Se nuk kemi ardhur të na ktheni.

— Shiko, shiko! Hajde Kurvelesh, hajde! Mirë, bre çuna, po a e dini ju që ardhja në hekurudhë bëhet në mënyrë të organizuar? Nejse, kjo s'ka ç'u duhet, po ne nuk mbajmë pionierë.

— Si ore nuk mbani? Po pionierë mbajtën edhe çetat partizane në mal e jo të mos mbani ju këtu. Komandanti ja dha të qeshurit, sa u lëkund tavolina. Nuk kisha parë njeri deri atëhere që të qeshte ashtu... me gjithë shpirt... me gjithë krahërorin...

Na mori me radhë të treve emrat dhe adresat e shtëpive.

— Ne do t'ju mbajmë, bre çapajeva të vegjël. Por ama, shtëpitë tuaja do t'i lajmërojmë me telegram që të mos bëhen merak. Sa për atë vëllanë tënd, mos u merakos hiç. Ka dalë tri herë sulmues deri tani. Do ta gjesh pas pak. Dhe tani ejani me mua t'u rregulloj me punë e me të fjetur. Juve, me siguri u ka marrë uria, apo jo! — u kujtua ai të pyeste më në fund. Këtë pyetje duhet ta kishte bërë që në krye.

Komandanti na përfshiu me ato duart e tij të gjata e tërë damarë, sikur të ishim një tufë me shqerra. Na dërgoi drejt e në kuzhinë.

— Shaqo, o Shaqir! — thirri dikë aty.

— Urdhnoni, urdhnoni! — ju përgjegj atij një zë që brënda.

Pastaj përpara nesh u shfaq kuzhinieri. Ai mbante një përparëse, e cila, po ta ggykoje nga cepat, dikur duhej të kish qenë e bardhë. Diçka e tillë mund të thuhej edhe për skufjen që kish rrasur në kokë. Sa për fytyrën, ajo më kujtoi një bostan të bëshëm, të cilin dielli e ka zënë vetëm përgjysëm.

— Këtyre pionierëve do t'u japish diçka për të

ngrënë, se vijnë nga larg, pastaj do t'i mbash këtu që të të ndihmojnë në punët e kuzhinës.

— Siurdhnon, shoku kapitan! — u përgjegj ai.

— Nuk jam kapitan, por komandant!

— Ani, s'prish punë. Komandant, kapitan, është po ajo. Kët gja unë nuk e di mirë, sepse... por ai ja fuste kot, pasi komandanti qe zhdukur me kohë në punë të tij.

— Pra, ju doni me hangër! Ju nep lala me hangër. Folni, ç'ka doni... taran-hallvasi, axhem pilaf, imambajildi, tavë Elbasani, salep Izmiri, apo salep Stambolle... Ma tepër s'kam besa! — tha ai dhe ja shkrepri kot së koti një të qeshure me bujë, po pa hije.

— Na jep ç'të duash! — i thashë unë, meqë ato lloj gjellësh për herë të parë m'i zinte veshi.

— Aha, çfar të due unë? E pra, unë s'po ju nap çfarë dëshiroj veti, por atë ç'ka më gjindet në vorbë. Nji supë me kungull.

Dhe nuk e bëri të gjatë. Na mbushi tri gaveta me një lloj lëngu ngjyrë hiri.

Sa doli kuzhinieri përjashta, ne të tre i boshatisëm gavetat. Në çast u kthye dhe kuzhinieri. Ai u hodhi një sy gavetave të zbrazura, pastaj u kthye nga ne dhe po na shihte me aq habi, sikur të ndeshte për herë të parë me racën njerëzore.

— Bre, bre, ju jini ujë apo çakej! Si bre i përlatë në dakike ato alamet gavetash ku hanin e faheshin tre ushtarë italianë? Mos kini ardhë me na farue kuzhinën tonë, a? Po ku, bre, ku m'i gjejnë mue kta farë gryksash? Ose nuk po e marr vesh unë, ose këto po m'i bajnë për inat. Mua më kanë inat. Duen me më farue! Po pasha diell e dhé, sa të kem

në dorë këtë alamet hanxhari, po ja u baj gropën tanë hasmëve të mi.

Dhe për të na mbushur mëndjen në ato që thosh-te, kapi me të vërtetë nga muri një goxha hanxhar. Në çast, Minella me një kërcim që ja vlente ta matje, u gjend jashtë kuzhinës. Qanua, gjithashtu po bëhej gati të kërcente nga dritarja, kurse unë, ca pse u hutova, ca pse nuk isha hasëm me kuzhinierin, nuk lojta nga vendi. Le që edhe sikur të doja, nuk kisha nga t'ja mbaja.

Kuzhinieri, si e vari në vend hanxharin, u kthye nga unë dhe më tha:

— Ti pra, qenke kapitani i tyne! Tash, çou dhe u pri në punët e kazanëve. Të tanë këta kazana duhet me i la mirë e mirë. Se do gatujmë prapë në ta! Çezma nuk asht larg.

— Si? Pse për të larë kazanët kemi ardhur ne këtu? — protestoi ashpër Qanua. — Jo byrazer, — vijoi ai, — kazanët t'i lash vetë, se ti je kuzhinier. Ne do të punojmë me karro dore.

— Bre, bre, po ju qenki ç'na qenki. Po pse, sa për me hangër nga një gavetë me groshë ju kanë pru këtu? Po ku m'i gjejnë vetëm sa për me hangër. Ç'do hanë mandej vullnetarët? Kryet e mi?

Ne që nuk kishim të bënim as me sherrin dhe as me kazanët, u drejtuam për nga komandanti, te baraka ku na priti në fillim. Papritur, kuzhinieri na thirri nga pas.

— Hej, kapitan! Ec këtu, ec! Ec se ta kam një llaf.

— Hiç mos shko, për inat! — tha Qanua. Por unë duhej të kthehesha.

— Më pritni këtu! — u thashë shokëve.

— Si është puna? — e pyeta kuzhinierin.

— A e di ç'ka? Ajo e kazanëve është përnjimend punë e randë për ju. Ma mirë qëroni patate. Kazanët po i laj vetë, se u kam marrë dorën. Sallnji prej jush të më ndihmojë sa me i çue në çezëm e me i prue. Se as për ju e as për mue nuk është mirë me i shkue kapitanit. Ai asht nevrík dhe i merr fort inat ata që i ankohen.

U thirra shokëve. Ata u kthyen. Por, me mëdyshje. Sikur prisnin, sa t'ju thoshja unë diçka, pastajt'ja mbathnin prapë për ku genë nisur.

— Ju të dy do të qëroni patate, kurse unë me ustanë do të lajmë kazanët, — thashë me një ton të prerë, jo pse kisha të drejtë të urdhëroja, por nga frika se mos Qanua do të ankohej prapë. Dhe jo më kot u tremba.

— Pse, për të qëruar patatet kemi ardhur ne? — tha ai me aq foddullëk, sa unë pa dashur ula kokën.

— Hajde Qano, mos na nxirr telashe tani. Për këtë urdhëroi vetë komandanti. Përndryshe, ai të hipën në maqinë dhe fishek e nga erdhe.

— Po xhanëm, atë gjë e ka në dorë ai. Fundi sot po i qërojmë patatet, po nesër të na japin një punë tjetër.

Qanua përpara dhe Minella pas, hynë në kuzhinë. Pas tyre edhe ustai.

— Uluni këtu. Ja ku i keni patatet. Po a kini qëruer ndonjiherë patate? — pyeti sërish ai.

— Ne andej i hamë patatet të paqëruara! — ja ktheu Qanua, duke më shkelur syrin. Ustai e pa një herë më dyshim, pastaj mori dy thika dhe jua dha.

— Ja si qërohen patatet, — filloi t'i mësojë ai. — Me dorën e djathtë kapet thika, me të majtën patatja. Po mos i qëroni trashë, si sholl openge, se kështu s'mbetet gja për në kazan.

Dhe si qëroi në sy të tyre dy-tri patate, ustai ma bëri shënjë dhe tok kapëm për veshësh një kazan.

— Prej nga vini ju? — më pyeti ai, kur ju afruam çezmës.

— Nga Fieri! — ju përgjegja.

— Prej Firi? Po pse, bre, Firi dërgon camërdhoka si ju në hekurudhë? A nuk paska të rritun atje?

— Ne nuk jemi camërdhoka, po pionierë!

— Ani, ani, po pse ju dërguen këtu?

— Nuk na dërgoi njeri. Ne kemi ardhur vetë.

— Si? Keni ardhë vetë? Me kaptinën tuej? — Dhe pasi rregulloi kazanin në çezmë, m'u kthye prapë: — Pra, ju paski ardhë vetë! Bre, bre! Po pse kini ardhë?

— Po ja pra, që të punojmë! Ti pse ke ardhur? — ja prita me çudi, pasi pyetja e tij m'u duk pa vend.

— Si? Ju paski ardhë vetë për me punue? Në këtë moshë! Besa ju kenki sokola të mirë fort. Hej, m'ja u lumtë, bre! Po ju e paski hallall. Hajt pra, se unë do ju nap me hangër sa të doni. Kini ba mirë fort që kini ardhë! Dhe tash shiqo e mëso për vedi se si lahet kazani! — dhe ai ju përvesh me një leckë të sapunisur atij alamet kazani, ku mund të ziente një viç i tërë.

VULLNETARËT

Mbi sjelljet e reja dhe mbi fytyrat e reja me të cilat duhet të mësohemi.

Në darkë ne ndihmuam kuzhinierin tonë për të shpërndarë ushqimin e vullnetarëve. Gjatë kësaj kohe nuk kisha mundur të shkëputesha nga kuzhina, për të kërkuar tim vëlla, Pajon. Këtë nuk e bëra, jo se nuk më kishte marrë malli! Qe tjetër arsye. Nuk doja që ndokush të mendonte se unë po i fshihesha punës.

Me supjerë në dorë, po ndiqja këmba-këmbës një skuadërkomandant, i cili nuk e gjente dot se ku ish ulur skuadra e tij. Atë kohë, prapa meje dëgjova një zë vajze:

— Uuu, po ky pionieri këtu? Pa shikoni sa i vogël që është! Dhe sa simpatik! Po kam frikë se atë supjerën do ta përmbysë. . .

Ajo u afrua, më hodhi duart në qafë dhe papandehur. . . më puthi! Unë u hutova aq shumë, sa që supjera më rrëshqiti nga duart dhe u derdh e tëra mbi këmbët tona. Po shyqyr, supa nuk qe aq e nxehtë sa të na nxirrte telashe. Ajo vajza ja plasi gazit bashkë me gjindjen që na rrethonte, ndërsa unë nuk kuptoja se ç'kishte këtu për të qeshur?

Ishte e para vajzë në botë që më puthte. Pra, më duket, së kisha jo vetëm arësye të hutohesha, por të derdhja edhe supën.

Si u çlirova nga krahët e saj të fuqishëm, u futa në kuzhinë dhe gjeta një cep ku u struka, si një njeri të cilit ja kanë marrë nëpër këmbë nderin në mes të rrugës.

Si, të vijë vajza e botës dhe pa të njohur, faqe milletit të të puthë, sikur je bebe! Pse, prandaj erdha unë në hekurudhë që të më puthin e të më tallin vajzat e botës? Apo që të bëhem gazi i hekurudhës... Ka rregulla këtu, apo jo?

Isha në një gjendje për të qarë hallin... Duhej gjetur një njeri për këtë punë. Dhe, hallin ma qau kuzhinieri.

— Ti or camërdhok, nuk ke pse të koritesh që të puthi ajo çika. Ban vaki që ti i ke qit mallin e vllaut të saj ma të mitun. Pra, banu burrë e mos u tut kësodore prej nji të puthure!

Nuk ma mbante të dilja nga kuzhina. Aty në derë po bënin muhabet një tok me vajza dhe mjafton që ato të më puthnin vetëm nga njëherë... Ç'do më mbetej mua pastaj? Kur as me kaq nuk di në më ka mbetur faqe të dal në shesh të burrave...

Ç'të bëja unë, kur Pajua nuk po dukej gjëkund? Ai ua rregullonte samarin... Apo nuk e ka atë dorë...

Minella po hante një gavetë me patate, ndërsa Qanua diç po nuhaste në një qoshe. Më dukej, sikur të dy ata më shikonin vetëm mua. Por e kisha gabim. Ata kishin punë me gavetat e tyre.

Pashë njëherë nga dera. Grumbulli i vajzave që shpërndarë.

Dola me kujdes jashtë. Vullnetarët qenë mbledhur grupe-grupe dhe ja kishin marrë këngës. Ja,

një vullnetare po këndonte këngën e Ali Pashë Tepelenës. Pak më tej, këngë për hekurudhën. Këtë e dëgjoja për të parën herë. Një grup tjetër po këndonin «Te selvitë e Namazgjasë». Përziheshin aty këngë himarjote, këngë labe, gjirokastrite... Unë vija rrotull midis këngësh!

Pa pritur buçiti një zë i njohur:

— Zenel!

Në çast kënga u pre si me magji dhe të gjithë kthyen sytë nga unë. Pajua më përfshiu për qafe.

— Po ku je, o vllako dhe qysh paske ardhur këtu? Hajde trim, hajde! Dhe ne të mbanim për shënjerak! Po nga mbive, jahu? Hë de fol, ç'më rri si mërhum? Ke ardhur kaq larg dhe tani nuk hap dot gojën.

Pajua gabohej. Unë e hapa gojën. Më qarkuan të gjithë. Edhe vullnetarët e katundit tim. Ata këtu më dukeshin si njerëz të shtëpisë... Dhe sa kishin ndryshuar! Pa shiko, Kristina! Kurse kjo na qënka Margarita... Desh s'i njoha.

Më dëgjonin me aq habi, sikur unë t'u tregoja gjëra të pangjara faqe këtij dheu. Pastaj, të gjithë përnjëherësh dhe pa mbajtur radhën, më mbuluan me pyetje për atë e për këtë, për ato e për këto, për... Mua po më mbulonin djersët, por nuk kisha nga t'ja mbaja. E kisha kërkuar vetë! Me këmbët e mia...

— Ç'po bëni aty? — buçiti një zë i njohur, që më ngriti flokët përpjetë. Dhe si për bela, ata alamet djemash, i hapën rrugën drejt meje asaj vajzës së prapë, e cila më kishte puthur qëparë.

— Kush u tha të talleni me pionierin? — pyeti ajo, duke parë me ashpërsi rreth e rrotull, me një sy që të përpinte.

Erdhi drejt meje dhe më hodhi krahun në qafë,

po për fatin tim, atë marifetin e qëparshëm, nuk e përsëriti. Ajo u ul bri meje, pa e ditur se mua nuk po më mbante vendi.

— Ne nuk po tallemi, shoqja Shpresa, — tha një nga shokët e Pajos, — por ky sapo ka ardhur nga shtëpia. Këtu takoi edhe të vëllanë. Me sa duket ky piciruk ja ka mbathur nga shtëpia për të ardhur në hekurudhë. Por fajin për këtë e ka i madhi, — dhe ai qeshi.

— A është e vërtetë kjo, o shpirti i motrës? — pyeti ajo, duke më kapur nga supet.

— Puna është, se si të thuash, ne nuk ja kemi mbathur. Puna është, se si të thuash, ne erdhëm në hekurudhë... Po katundi tani ka nevojë për krahë pune... prandaj babait në fillim nuk do t'i vijë mirë.

— Ç'prallisni atëhere, se ja paskan mbathur? pyeti gjindjen, shoqja Shpresa, të cilën unë tani e shikoja si mbrojtësen time.

E kuptova shpejt, se asaj aty i shkante fjala. Pra, ajo mund të më hiqte nga kuzhina po të donte. Sidoqoftë, unë do t'i lutesha njëherë. Vetëm jo sonte. Sikur nuk bënte, që pa u njohur mirë të filloja nga lutjet...

— Në ç'klasë je ti petrit? — më pyeti ajo.

— Mbarova filloren dhe më quajnë Zenel.

— Si? Filloren?

Ajo u çua në këmbë dhe më mati me një shikim nga lart poshtë. Pastaj më kapi nga supet, më çoi edhe mua më këmbë, gjë që unë duhej ta kisha bërë vetë, dhe më mati me një tjetër shikim të ngadaltë e të menduar. Si u ulëm të dy, ajo prapë nuk m'i ndante sytë.

— Si, bre, filloren? Unë pandeha, të parën, ose e shumta, të dytën! Po me mësimë si ke kaluar?

— Shumë mirë! — u përgjegj në vendin tim Margarita, megjithëse ajo e dinte mirë, që unë nuk isha memec. E pashë me inat atë, pasi përgjigjen e saj duhej ta kuptoja si marrjen nëpër këmbë të sedrës sime. Po Margarita nuk ma vari fare dhe vazhdoi në të sajën:

— Ai ka kaluar dy klasa në një vit!

— Ashtu! Po kjo është një mrekulli! Duket ky, që do bëhet petrit! Pa shikojeni njëherë në sy? Nuk të merr më qafë! Shpirt i motrës! Mrekulli petrit, mrekulli. Po a di ndonjë këngë të bukur?

— Di!

— E ç'këngë di ti pëllumb?

— Po ja «Malet me blerim mbuluar plot me bukuri, bum».

Atë çast plasi gazi, megjithëse mua nuk më qesh. Se unë, jo vetëm atëhere, po edhe tani, përpara se të qesh, dua të zbërthej shkaku. Dhe vetëm si të më jetë mbushur mendja për të qeshur, atëhere qesh. Akoma nuk e kuptoj, përse duhet qeshur kot-sëkoti!

Shpresa ja mori këngës «Malet me blerim mbuluar, plot me bukuri, bum.» Menjëherë kënga u ngrit me buçimë, e fortë dhe e fuqishme, tamam si malet vetë.

Me grupin tonë u bashkuan edhe vullnetarë të tjerë, të cilët deri në atë kohë këndonin gjithkush për hesap të vet. Kështu që kënga sa vinte e mbushej, rritej dhe forcohej.

Krenohesha me vete, pasi më dukej se pikërisht unë isha shkaku që kënga u rrit aq tepër. Po prapë, dukej sheshit se pa Shpresën, kjo këngë do të mbej e dobët.

Pastaj kënduam edhe këngë të tjera, që unë nuk

i dija. Më në fund, Shpresa u çua pa m'i lëshuar duart, gjë që nuk më pëlqente fort.

— Dhe tani shokë dhe shoqe vullnetare, bini për të fjetur. Këtë petritin ma lini mua! — tha ajo, duke ju drejtuar Pajos. — Ju mos u bëni merak! Dhe pa pyetur, në se ai do të bëhej merak apo jo dhe në se isha edhe unë në këtë mëndje, Shpresa u nis pa ma lëshuar dorën.

Natyrisht, unë në atë moshë dija fare pak për demokracinë dhe për parimet e saj, ndryshe do kisha bërë ca debate me shoqen Shpresa.

Të të marrin për dore në atë moshë kur ti shkon vullnetar në hekurudhë, kjo gjë nuk të ka hije dhe ti nuk bën ta lejosh.

— More, se harrova fare, emrin si e ke ti?

— Të thashë njëherë, Zenel më quajnë! — ju përgjegjja me gjysëm zëri, pasi mendoja se çfarë do të punonte akoma me mua kjo shoqe.

— E gëzofsh! Dhe tani Zenel, më thuaj, çfarë do të bëhesh kur të rritesh?

— Kur të rritem? Këtë akoma nuk e kam prerë. Ka të ngjarë që të bëhem ose bari, ose mësues.

— Aq më mirë! Të bëhesh edhe bari edhe mësues!

— Ku po më shpini kështu shoqja Shpresa? — nuk m'u durua pa e pyetur. Ajo qeshi dhe u përgjegj:

— Ku tjetër, veçse atje ku do bësh nani-nani! Edhe unë do të bëj nani-nani, se jam lodhur shumë.

— Po si këndoje aq fort, kur qënke lodhur kështu?

— Sepse mua kënga më çlodh. Pa këngë nuk do të bëja asgjë, as bukë nuk do haja dot.

— Ç'vazhë e çuditshme! Të mos hajë dot as bukë pa kënduar! Tamam si im atë... Veçse ai, përveç

këngës do edhe nga pak raki. Mirë, po mua ku më shpie kështu? Po Qanua me Minellën?

— Shojja Shpresa, në jemi tre!

— Si qënkeni tre?

— Ja, unë një, Minella, shoku im i klasës dy dhe Qanua, djali i hallës time, tre!

— Po ata të dy ku i ke lënë?

— Në kuzhinë!

— Aha, hajde, se po i marrim edhe ata.

Vendimi i saj për të marrë edhe ata të dy ma bëri qejfin. Kështu ndryshonte puna. Nuk isha më vetëm. Kur të bëheshim prapë tre, ajo le të na çonte ku t'i tekej. Apo nuk e kisha bilbil nga goja atë Qanon. Do na shkrinte me ato qyfyret e tij.

Nuk kam si ta fsheh, se atë kohë fillova të kem më tepër respekt, jo vetëm për Qanon dhe për qyfyret e tij, po në përgjithësi për të gjitha qyfyret dhe shakatë! Ato të nxjerrin nga çdo situatë. Dhe shpesh, pa u lagur fare!

Me këto mendime optimiste në kokë arritëm në kuzhinë.

— Ku janë ata të dy pionierët? — pyeti Shpresa kuzhinierin.

— Ata, shoqja kapitane, i mori për me fjetë shoku kapitan, deshta me thanë shoku komandant. Ai e kërkoi boll edhe këtë camërdhokun, po nuk e pau kund.

— Natën e mirë, Shaqir!

— Natën e mirë, shoqja kapitane!

Kjo më dëshpëroi, aq sa unë mezi i hidhja hapat. — Shpresa nuk ma lëshoi dorën. Do të dëshëroja t'ja mbathja dhe këtë gjë do ta bëja sikur të isha i sigurtë se Shpresa nuk do më arrinte dot. Se po të më arrinte, për mua do të qe hapu dhë të futem.

Por, Shpresa nuk e zgjati ashtu siç pandeha unë. Hymë në një barrakë, më caktoi diçka si biçim krevati dhe më tha:

— Sonte do të flesh këtu. Nesër shohim e bëjmë! Tani, natën e mirë dhe gjumë të ëmbël!

— Natën e mirë shoqja Shpresa!

Ajo iku, ndërsa unë u shtriva. Dhe, përmes gërhimave, më kapi një gjumë i rëndë.

LUFTA

Largohemi nga hanxhari i Shaqos. Na japin nga një karro dore. Të reja mbi luftën!

Të nesërmen u zgjova në mes të një rrëmuje të plotë e të paparë ndonjëherë. Vullnetarët mbathnin këpucët, pantallonat, rrëmbenin xhaketat në dorë dhe vërsuleshin përjashta, sikur diku të kish rënë zjarri. Bile njeri, në vend të xhaketës rrëmbeu batanien.

Vetëm te dera mori vesh se ç'kishte bërë, kur shoku që vinte prapa i shkeli padashur cepin e batanies. Ai i këputi një të sharë, shokut apo vetes, këtë nuk arrita ta kuptoj, dhe u kthye për të këmbyer batanien me xhaketën.

Nuk po merrja vesh përse nxitonin kështu. Si doqoftë, kjo gjë më shtynte që të nxiroja edhe unë. Përderisa të gjithë nxirojnë, përse të mbetesh pikërisht ti i fundit? Pra, u çova dhe për dera e jashtë. Po nxitova kot. Kështu zgjoheshin çdo mëngjez vullnetarët.

Të parin njeri që përshëndeta, qe shoqja Shpresa.

— Hë, si fjete, petrit? Dhe tani eja me mua. Sot do të punojmë së bashku.

— E përse të mos punojmë gjithnjë bashkë? — e pyeta unë jo fort i sigurtë në se duhej folur kështu me komandanten, apo jo.

Fundi, dinte shumë më tepër nga unë; prandaj nuk duhej t'i bëja ndonjë pyetje të pamatur. Vetëm se nuk dija si t'i matja pyetjet e mia. Po ajo nuk ma mori për të keq.

— Po kush tha se nuk do punojmë gjithnjë bashkë? — ma ktheu ajo me dashamirësi. — Nuk më thua, përse nuk të pëlqen kuzhina? — më pyeti pa pritur.

— Të them të drejtën, nuk më pëlqen se aty nuk para gatuhet për të qënë. Po të qe kuzhinieri halla ime që e kam në Fier, puna do të ndryshonte. Ajo do na ngopte për ditë me byrek dhe me petulla. Kurse ai Shaqua juaj, nuk di të qullojë gjë. Ai një e dy e te hanxhari e ka mendjen. Po se çfarë pret me atë hanxhar, unë nuk e marr vesh.

— Ti qenke një pionier i lezeçëm. Vetëm një gië nuk kuptoj: këto fjalë të shpëtojnë, apo m'i thua me gjithë mend? Hë shejtan i vogël, folë!

Pyetja e saj, megjithëse m'u duk e sigurtë, më kapi në befasi të plotë.

— As unë nuk e di se si, shoqja Shpresa. Këtë pvetie e dëgjoj për herë të parë, prandaj nuk e kam përgatitur! — ja ktheva unë më se i sigurtë në ato që thoshia.

— Edhe unë kështu mendoj. — tha ajo, duke nxituar hapin. — Sidoqoftë, ti do të bëhesh një djalë i mirë. Po tani më thuaj, ku do t'i gjejmë ata shokët e t'u?

— E ku ta di unë, shoqja Shpresa?

Por nuk qe nevoja t'i kërkonim. Qaniu me Minnellën, në vrap e sipër, u përplasën me ne.

— Më ngadalë, mor trima, për ku vraponi kësh-tu? — i pyeti ajo.

— Për në punë, për ku tjetër? — ja ktheu ash-për Qanua.

— Po ku do të punoni?

— Ku të gjejmë! Me të tjerët edhe ne. Po ti Zenel, ku na humbe?

— As unë nuk e mora vesh, Qano! Po tani nuk do të ndahemi më. Tani e tutje do të punojmë me shoqëri Shpresa.

— E kush qënka kjo shoqja Shpresa dhe përse të përzihemi me të?

— Ja pra, nuk e shikon? — dhe unë i çuditur që nuk po e shikonte atë alamet vajzë, ja tregova vetë.

— Po pse, këtu nuk punojnë veç vajzat dhe veç djemtë? — pyeti i çuditur Minella.

— Hajdeni tani dhe i lini këto shaka. Këtej e tutje ju do të punoni ca në kuzhinë dhe ca me ne. Pra, në dy fronte — na tha Shpresa.

Ne pranuan pa thënë asnjë fjalë.

Më në fund arritëm. Shpresa na dha nga një karrë dorë. Na tregoi se ku do t'i ngarkonim karrot dhe ku do t'i zbraznim. Deshi të na mësonte edhe se si shtyhej karrua, po për këtë nuk qe nevoja ta vinim në mundim.

Ajo na i mbushi vetë karrot sa të hapësh e të mbyllësh sytë, ndërsa ne u nisëm varg njëri pas tjetrit.

— Zenel, kësaj i shkoka fjala këtu, prandaj duhet ta kemi grurë me të! — nxori mësimin e parë Qaniu.

Shpresa punonte me kazëm dhe me lopatë. Po se ku e gjente gjithatë fuqi, unë nuk e merrja dot me mend. Po të them të drejtën, unë duhet të pranoi se pas disa rrugësh, u lodha. Atëhere u kujtova se në kuzhinën e Shaqos ishim më rehat. Atje nuk shtynim as karro, dhe as ngarkonim me lopatë. Po, me që

e kishim kërkuar vetë, unë nuk mund t'ja zija prapë në gojë shoqes Shpresa. Ky do të qe një turp për mua. Zaten, Shaqo na tha njëherë, se do ta kujtonim, po unë nuk i hyra kuptimit të asaj thënieje. Ngushëlloheshim se kur të donim mund të shkonim të punonim në kuzhinë.

Sapo u kthyem me karrot bosh, Shpresa na urdhëroi:

— Tani do të çlodheni pesë minuta. Uluni se u them vetë kur duhet të filloni.

U ulëm pa e bërë dy, pasi e kishim provuar shpesh, që kur kërkon t'ja bësh fjalën dy më të madhit, e humbet davanë.

Përpara nesh kaloi një vullnetar me ca rroba të lerosura me naftë.

— Puna mbarë, shoqja Shpresa! Më thanë se po merre me fëmijët, — i tha ai komandantes sonë. Këto fjalë mua më qëndruan shumë rëndë. Por, nuk desha t'i përgjigjem faqe Shpresës. E shikoja me kujdes, që ta mbaja mend. Pastaj dikë mund ta sqaronim se çfarë fëmijësh qemë ne.

— Këta janë pionierë shëmbëllorë o Xhemal, prandaj nuk bën keq sikur të matesh më tepër, kur flet për ta! — ja ktheu me ustallëk Shpresa, që me këto fjalë, u bë shumë më e dashur për mua.

— Unë bëra shaka, shoqja Shpresa! Nuk desha të fyej njeri. Këtu për mua të gjithë janë të dashur dhe të shtrenjtë. Hajde, mirupafshim! — dhe ai humbi në turmat e vullnetarëve.

— Zenel, ç'llomotiti ai kështu? — më pëshpëriti Minella.

— Mos u mërzi Nëlla! Këtu jemi.

— Po, po, këtu, por ai dashka argasur ca!

— Ëhë, po po...

Rreth e rrotull vullnetarët punonin pa përtim. Djersa u kullonte çurk nga gjokset e zbuluara. Duke i parë kështu, nuk m'u duk sjellje e matur që na të rrinim ulur. U çova. E pashë të arësyeshme që edhe unë ta zbuloja gjoksin tim. Ashtu bëra.

— Mos u mbeti qejfi nga fjalët e Xhemalit? — më pyeti Shpresa.

— Jo shoqja Shpresa, vetëm se mua nuk më pëlqen ai njeri.

— Ashtu? E përse nuk të pëlqen?

— Nuk e di mirë! Di vetëm që nuk më pëlqen. Po se përse, as vetë nuk e kuptoj dot.

— More Zenel! Po ty shumë veta nuk të pëlqyen këtu, sapo erdhe. Kuzhinieri nuk të pëlqeu, motoristi po ashtu. Po kur të rrish disa ditë?

— Jo, unë për kuzhinierin nuk thashë gjë. Vetëm se nuk desha të punoj në kuzhinë.

— Hajde, hajde, pa ashtu të duket tani në fillim. Unë nuk e zgjata, po kapa dhe shtyva karron përpara. Ku ta dish? Ndoshta me të vërtetë ashtu më dukej. Fundi, Shpresa di se ç'flet.

Aty afër drekës u bë një gjurulldi e madhe. Tutje, ndo dyqind metra larg nesh, shpërtheu diçka si bombë. Menjëherë rreth e rrotull u mblodhën vullnetarët. Nga ne, e para vrapoi Shpresa. Ne i shkuam pas, po ajo nuk arrihej dhe shpejt na humbi nga sytë.

Ju afruam me nxitim vendit. Vullnetarët mbanin në duar dy shokë të gjakosur. Ashtu, në duar, i çuan në barraka.

— Plasën minat. Ishin që në kohë të gjermanit.

Çfarë gjermani more? — ndërhyri me aq furi një tjetër vullnetar, tamam sikur do t'ja ngjeshte dikujt turinje. — Ato qenë bomba greke. Bomba nga të Zervës.

Në këtë muhabet u trazuan më pas aq shumë fjalë dhe emra, sa që ish e pamundur të mësoje diçka të saktë për atë që ndodhi.

U kthyem pranë karrove tona të hutuar dhe pa ditur ç'të bënim. Por, pas pak aty erdhi Shpresa. Ajo dukej aq shumë e nevrikosur, sa që nuk guxova ta pyes për asgjë.

— Tani lereni punën, se erdhi dreka! — na tha ajo pa qejf. Po ahtu, pa qejf, lëshuam edhe ne karrot dhe i vajtëm pranë komandantes.

— Si është puna? — pyeta unë, me që ajo m'u duk tepër e dëshpëruar. Shpresa ngriti kokën, më hodhi krahun supeve dhe më tha:

— Punët venë mirë! Për mrekulli venë! Por këtu, jo vetëm punojmë, të dashur pionierë. Këtu punojmë dhe luftojmë. Luftojmë dhe punojmë. . .

— Po pse, nuk ka mbaruar akoma lufta? — pyeti pa u matur Minella. — Mua më duket se. . . Po ai nuk arriti të thoshte çfarë i dukej dhe çfarë nuk i dukej për mbarimin e luftës.

Përpara mencës genë grumbulluar aq shumë vullnetarë, sa që të dukej se nuk do të vinte radha kurrë për të hyrë brenda.

Në krye të shkallëve dikush fliste. Dukej sheshit se vullnetarët ishin të gjithë të një mendjeje me të, pasi e brohoritnin dhe e duartrokkitnin herëpashere.

U afruam me nxitim se mos merrnim gjë vesh edhe ne nga gjithë ajo bujë e shamatë. Zëri i vullnetarit dëgjohej qartë:

— Shokë! Ne po ndërtojmë të parën hekurudhë në Shqipërinë e re! Kjo po i tërbon armiqtë. Kjo po i çmënd ata. Dhe ç'nuk bëjnë kundër nesh. Komplete, sabotime, vrasje! Jo shokë, lufta nuk ka mbaruar, siç pandehin disa! Ajo vetëm se është bërë më e ashpër

dhe më e fshehtë. Armiqtë po punojnë dhe do të punojnë. Por ne, me këto duar që përkulim dhe thyejmë hekura, do t'ua thyejmë kokën të gjithë armiqve tanë, një nga një.

Shokë! Kudo që të punoni, hapni sytë! Hasmi nuk flë! Kapeni atë shokë vullnetarë, përpara se ta shtrijë dorën. Kapeni dhe këputjani kokën. Po, këputjani kokën, ashtu siç na mëson i madhi Stalin, ashtu siç jua bën edhe Stalini armiqve.

Në çast, turma buçiti nga brohoritjet dhe duartrokitjet. Ne të tre rrihnim shuplakat me sa fuqi që kishim.

Duke parë gjithë këto, desha të them edhe unë nja dy fjalë, po atë çast u hapën dyert e mencës dhe vullnetarët u dyndën brënda.

Hymë dhe ne të tre, nën krahët e gjatë dhe të fuqishëm të Shpresës.

Në shtëpi unë haja më ngadalë nga të gjithë, sidomos kur e kisha ushqimin më vete. Nuk di pse haja aq ngadalë. Ndërsa kjo që një tjetër arsye që e siguronte tim atë se unë do të bëhesha një vulëhumbur dhe merhum.

Këtu në hekurudhë puna ndryshonte. Unë e për-laja pjatën sa të hapje e të mbyllje sytë, pa qënë nevoja të numëroja një, dy, tre... Me siguri im atë do të çuditej jashtë mase kur të shikonte se me ç'shpejtësi rrufeje, i nxirrja tabanin enës.

Si hëngrëm drekë, u dha aty Shaqua. Ai, pasi më shikoi ashpër, u kthye nga Shpresa dhe i tha:

— Shoqja kapitane. Nuk më kallzoni si asht kjo punë. Kërkush nuk don me punuë me mue në kuzhinë. Ma përpara më ikin se më vinë me më ndihmue. As unë nuk di nga t'ja mbaj. Ç'kanë pra që s'duen me i pa bojën kuzhinës seme?

— Ku ta dish Shaqir. Por ti mos u mërzit. Nëse asnjëri nuk vjen të punojë te ti, krenohu, se të gjithë vijnë për të ngrënë. Pra, pa ty askush nuk ja del dot.

— Kjo asht tjetër punë. Unë due të më ndihmojë dikush. Veta s'ja dal dot. Ja kta camërdhokët i pata fort mirë. Po as këta nuk e mbushën ditën. A thue dikush don me më prishë punë? A thue hasmët e mi?

Shpresa i premtoi ta ndihmonte në këtë hall dhe Shaqiri u largua duke ju kërcënuar egër dikujt.

— Pse përherë zë në gojë disa hasmën ky? — pyeta Shpresën.

— Eh more Zenel. Ti nuk di ç'i ka ndodhur atij. Gjatë luftës një bombë ka rënë mbi kasollen e tij. Vetëm ky mundi të shpëtojë, pa ndjenja.

Që aherë, shpesh turbullohet, sidomos kur nuk i venë punët mirë. Prandaj dhe ne nuk ja prishim. Ai kurrë nuk të bie më qafë.

NDIHMA

Një shfaqje e posaçme mbi ndihmën e madhe dhe mbi telashet e saj.

Nganjëherë, jo vetëm fëmijët po edhe koha nuk di ç'bën. Fjala vjen, të marrim atë ditë. Atë ditë, aty hapej koha dhe aty mbyllej. Sikur të luante symbyllazi. Pas pak ja niste një shi i imët, që nuk zgjaste shumë. Më pas dilte dielli, ashtu copa-copa midis reve të çara e të grisura. Prapë fillonte shiu, ashtu faqe diellit, sikur të mos pyeste fare për të! Ja çdo të thotë, të mos ketë rregull! Edhe shi edhe diell! Për më tepër në behar! Të qe stina e shirave, ndoshta nuk do të na bënte shumë përshtypje. Po pa pyetur për përshtypjet tona, koha bënte të sajën!

Kishte dy ditë që më shumë binte se pushonte! Një mot i tillë nuk e ndihmonte aspak punën tonë. Më e keqja, ne nuk mund të vinim dorë në këtë hall...

Në hekurudhë ja kalonim për mrekulli, por jo për shtatë palë qejfe! Kjo ndoshta do të duket si një fjalë papërgjegjësi dhe e lëshuar ashtu në rrugë e sipër. Po e vërteta qëndron krejt ndryshe. Të mësosh një për një vlerat ushqimore të makaronave me kungull dhe të luftosh dhjetë orë në ditë për të marrë flaminurin, dhe, prapë të mos ndjesh lodhje. kjo është me të vërtetë një mrekulli! Në këtë përfundim, ndonse

me vonesë, arriti edhe Qaniu. Në këtë përfundim arriti edhe i urti Minella! Them «i urti» me rezervë, pasi në shkollë, ai qe një sheleg përroi. . Po këtu, nuk di pse, natyra e tij, ndryshoi disi. Ndoshta nuk qe mësuar me kaq shumë njerëz, me kaq zhurmë. . . Ku ta dish si e kishte hallin. . .

Gjë e bukur këtu në hekurudhë ishte edhe kënga! Kurrë nuk kisha menduar se kënga qe një gjë kaq e bukur, një forcë kaq e madhe! Po ashtu, atje në fshat, kurrë nuk do të më kishte shkuar ndërmend se me këngë nuk e ndjen urinë, as lodhjen dhe as të ftohtit. Po ashtu, një gjë tjetër e mirë në hekurudhë ishte edhe sulmi. Po, sulmi! Sa herë që gjëndeshim ngushtë, prapa me normën, me punën, Shpresa lëshonte kushtrimin: «Shokë dhe shoqe, në sulm!»

Atëhere ne bëheshim copë. . . Dhe kështu nuk kish gjë që të mos e arrinim. Mjaftonte të hidheshim në sulm! Përndryshe mund edhe të mos quilloshim gjë.

Një tjetër e mirë e madhe, bile më e madhja ishte flamuri. Për flamurin vullnetarët bëheshin më copë se për sulmin. Por, pak kishin fat të buzëqeshnin para një fitoreje të tillë. Kjo vinte se flamur kishte vetëm një, kurse ne ishim shumë. Nuk e kuptoja, përse kishin bërë vetëm një flamur? A nuk mund të bëheshin më shumë? Për supë, fjala vjen, nuk shtyhej njeri, po sa për flamurin, qeni i kallaixhiut loste!

Për të marrë flamurin njerëzit punonin pa orar, coheshin fshëhurazi natën, bëheshin copë. Bile dikush, një topolak me pantallona të çjerra (me sa mbaj mend), deshi të rrihej me teknikun, pse i thoshite mëndja, që matjet ishin bërë gabim. Por nuk e lanë të rrihej me teknikun, gjë që atij i mbeti pikë

në zemër. Me të vërtetë u pikëllua aq shumë, që se lanë ta zhdëpte atë tjetrin, sa që kur u largua, sytë ju mbushën me lotë.

Kjo gjë më preku edhe mua, megjithëse lotë nuk derdha.

Duke llogaritur kështu të mirat e hekurudhës, ndjeva një dorë që më mbylli sytë.

— Qanua?

— Minella?

— Pajua?

Jo, ishte Shpresa! Dhe vërtet, si nuk më shkoi ndërmend, se ajo dorë që më kish zënë sytë, duhej të qe vetëm e saj...

— Çohu Zenel! — më tha ajo.

— Ç'ka ngjarë? — e pyeta, duke e ditur se ajo nuk të binte kot në qafë.

— Do ta shohësh vetë. Do të mbahet një fjalim. Pastaj do të vizitojmë një dhuratë që i ka ardhur hekurudhës nga fqinjët tanë.

— Dhuratë? Po ç'dhuratë është kjo? Mos na kanë dërguar karro dore të reja?

— Jo, diçka më shumë. Një makinë të re!

— Fringo?

— E sapo dalë nga fabrika!

— Makinë? (Përse të mos jem i sigurtë: habia ime qe tepër e madhe. Kjo, ndoshta, nga që unë isha aq i vogël! I thonë makinë, or babam, jo shaka!)

— Po nuk janë harxhuar ca si shumë kështu, shoqja Shpresa? Një makinë të tërë për ne?

Shpresa më pa në sy pa ndonjë entuziazëm, siç e prisja unë. Ajo diç kërkonte në sytë e mi. Kjo më trishtoi, pasi unë trishtohem lehtë! Mjafton që diçka të më dalë ndryshe nga ç'e pres dhe unë menjëherë trishtohem. Kjo më mban, së paku, dy orë.

— Nuk bën mirë të flasësh kështu! — më tha ajo.

— Siurdhëroni! — ja ktheva unë, jo fort i bindur por për t'i bërë qejfin asaj.

«Nuk bën të flasësh kështu!»! Po pse, çfarë thashë unë, që nuk duhej thënë? Eh, përse nuk ma thotë copë si qëndron puna? Përse nuk më mëson ajo vetë, se si duhet folur?

Ajo, me sa duket kujtoi se u pendova, më kapi nga dora, më mori për qafe dhe më shtrëngoi, pa menduar se mund të më thyente kockat dhe vazhduam rrugën.

Qiellin e kishte prerë një hark i shkëlqyer. Unë, që i vogël mahnitësja pas ylberit! Bile ky zakon, akoma nuk më kish lënë, gjë që më detyronte të mendoja se duhet të jem ende fëmijë...

Kisha mbajtur hapat dhe po sodisja ngjyrat e bukura të ylberit... Padashur, shikimi im ra në sytë e Shpresës dhe gjeti aty diçka tepër të afërt me ngjyrat e ylberit. Kjo më shastisi fare.

— Zenel, ç'patë? — më pyeti ajo, me aq dhëmshuri sa që do të dëshëroja shumë ta përqafoj, gjë që mund edhe ta kisha bërë, sikur të isha ca më i gjatë.

— Ja, perëndoi sapo fole ti! — i thashë buzëvarur, me që ato çaste ylberi qe zbehur e me zi dallohej.

— Aha, ylberi! Aq shumë e dashke? Do të bëhesh pra një njeri zemërpastër! Ashtu siç na kërkon revolucioni...

Përpara nesh turma qe grumbulluar me kohë. Nga karrocëria e makinës-dhuratë, dikush po fliste...

— Në saje të kësaj ndihme buiare ne do ta ndërtojmë hekurudhën përpara afatit. Bile, edhe socializmin do ta ndërtojmë përpara afatit... Se ndihma

është aq e pakursyer, aq bujare dhe aq pa interes sa që nuk ka se si çdo gjë të mos e kryejmë përpara afatit (vijojnë ca fjalë që nuk po i përmend, pasi jam i sigurtë se edhe oratorit nuk do t'i vijë mirë).

...Armiqtë nuk duhet të harrojnë se ne kemi miq. Po edhe miqtë nuk duhet të harrojnë se ne kemi armiq! Dhe këta janë armiq të përbashkët! Se miqtë janë armiq me armiqtë tanë! Ne do t'i kapim të gjithë armiqtë si miun në çark. Do t'i kapim dhe do t'ua marrim shpirtin... (Këtu, oratori, përveshi njerën mëngë të këmishës, sikur me të vërtetë do t'ja merrte shpirtin dikujt).

Si i paralajmëroi kështu armiqtë, për fatin e zi që i priste, oratori ju vërsul Çerçillit. E bëri leckë fare, aq sa vështirë të kish sy e faqe ky farë Çerçilli, për të dalë sërish në shesh të burrave.

Fjalimin e tij të zjarhtë oratori e mbylli kështu:

— Dhe tani, ata që marrin turnin, le të hypin lart se do t'i çojmë me makinë.

Ata që merrnin punën ishin aq shumë, sa që pothuaj e mbuluan fare këtë dhuratë të bukur.

U desh të lëshoheshin urdhëra të reja, të vihej rregull, derisa në karrocëri të mbeteshin dyzet vetë. Kuptohet, të gjithë më këmbë.

Ne i hapëm rrugën makinës, por ajo nuk nxi-tohej. Shoferi merrte e jepte atje brenda, por makina nuk ndizej fare. Se, siç kisha dëgjuar, makina duhej të ndizej para se të nisej. Ndoshta do të që në të mirën e saj dhe të punës, sikur makina të ndizej pasi të nisej, po kjo nuk varej nga unë. . .

Në fakt, kjo makinë nuk po bënte dot as njerën dhe as tjetrën! Së paku të bënte njerën dhe ne do të kënaqeshim: ose të nisej pa u ndezur, ose të ndi-

zej dhe pastaj të nisej. . . Fundi, ajo sot qe mysafire!
Nuk duhej ta lodhnim.

Një vullnetar kapi manivelën dhe i doli përpara makinës. Dukej aq me inat, sa thojë se do ja hiqte m'u në lule të ballit atij motori kokëfortë, që nuk dëgjonte të ndizej. Por ai nuk i ra ballit. Futi diku manivelën dhe filloi ta rrotullojë.

— Paf... puf... çaf. . . — filloi të tështijë makina.

Vullnetari që i jepte manivelës i kishte shtrënguar aq shumë dhëmbët, sa vështirë se do t'i hapte prapë. Mua ma thonte mëndja se ai i kishte shtrënguar ashtu dhëmbët që të mos shante! Se kur puna të vete aq ters, nuk ke si të mos shash! Por aty pranë ishte Shpresa, kishte edhe shoqe të tjera, pra nuk do të qe mirë të shante. Edhe mua nuk do të më vinte hiç mirë, sikur në sy të Shpresës të lëshonte ndonjë sharje të ndyrë.

Çaf. . . çuf. . . Paf! kollitej motori i ngathët.

— Kjo me siguri është lodhur nga rruga e gjatë, prandaj nuk ndizet, — desha të sqaroj Shpresën.

— Zenel, nuk bën të flasësh kështu!

Vullnetari me manivelë, pasi hoqi dorë nga ajo punë e pasuksesshme, tha, si nëpër dhëmbë:

— Kjo e do në lule të ballit. . . Ta shkrijnë prapë miqtë e ta bëjnë hekur. — Dhe u largua duke humbur në grumbullin e shokëve.

— Ta shtyjme, shokë, ta shtyjme! lëshoi dikush kushtrimin.

— Po shokë, ta shtyjme! O burra!

Sakaq turma u lëshua përpara dhe filloi ta shtyjë makinën-dhuratë. Desha të ndihmoj edhe unë në këtë aksion fisnik, por nuk munda. Për mua nuk pati as vend dhe as nevojë. Aty s'kishe ku të hidhje një kërr gorice dhe jo të futeshin duart e mia. Por, men-

dova se edhe pa duart e mia, do t'ja arrinin qëllimit.

— Çaf... puf, paf... dhe maqina bëri përpara. Kjo u shoqërua me brohoritje, gjë që i dha zemër edhe makinës edhe shoferit, i cili tha:

— Mjaft, shokë! S'ka më nevojë. Tani ecën vetë.

Por, ai ishte gabuar rëndë. Sapo u larguan vullnetarët motori u fik dhe makina ndali si e kapitur. Shoferi zbriti me inat, përplasi derën e kabinës dhe shau rëndë. Pastaj hapi kapakun e makinës dhe futi duart brenda, sikur diçka do të merrte. Po asgjë nuk nxori.

— Shokë, kjo s'ka benzinë! O burra, benzinë.

— Oho, benzinë! E dija unë, po, po, dija. Patjetër që nuk duhej të kishte benzinë! — tha një vullnetar, i cili kishte hedhur xhaketën krahëve.

Sakaq erdhi një bidon me benzinë dhe shoferi e derdhi të tërë në grykën e makinës. Ne morëm frymë të lehtësuar, pasi më në fund u zgjidh edhe kjo ngatëresë.

Por edhe pse u ngop me benzinë, makina nuk donte që nuk donte të ndizej, apo të nisej. Dukej se ishte nga racë kokëfortë!

Filluam prapë ta shtymë, me që kështu erdhi një urdhër. Ajo duhej të punonte me të shtyrë! Jep e merr dhe motori filloi të kollitej, si një gjysh që e ndez llullën esëll.

Dukej sheshit se makina nuk donte të ndizej, po se si e kishte hallin, unë nuk po e kuptoja. Po që e kishte një farë halli, kjo dukej sheshit.

Sa keq kur ke të bësh me një send të pagojë! Se po të kishte gojë kjo makinë, ne diçka do të mësonim për hallin e saj.

Makina ecte e shtyrë nga duart e vullnetarëve. Motori i saj lëshonte zhurma të vështira, kollej,

teshtinte, e kapte lemza. Me siguri që e kujtonin shoqet e saj atje ku i kish lënë para se të vinte këtu.

Unë shikoja Shpresën në sy dhe nuk di pse m'u duk e trishtuar. E menduar dhe e trishtuar! Pa dyshim që këtë hije duhej të kisha marrë edhe unë.

Atë çast më erdhi shumë keq për të! Një vajzë aq gazmore dhe që këndon më bukur nga të gjithë, nuk duhet kurrë të trishtohet. Për më tepër, një komandante!

Doja me gjithë zemër t'ja largoja trishtimin. Dhe kjo mund të arrihej fare lehtë, me ndonjë fjalë të mirë. Po çfarë fjale, se?

— Shoqja Shpresa, përse mërzite? Sot makina nuk u ndez, se qe e lodhur nga rruga e gjatë dhe bën pak ftohtë. Po nesër që do ta marrë veten, ke për të parë.

— Zenel, nuk bën të flasësh kështu xhan i motrës! — më tha ajo për herë të tretë, duke më shkuar dorën në flokë.

NJË AVENTURË NATËN

Aventura fillon treshe: Nella, Qaniu dhe Zeneli, po përfundon dyshe, me dy të tjerë.

Ne kullonim ujë në djersë, kur Shpresa na lajmëroi të linim punën. Kishte vajtur ora. Atë kohë, unë me karron time isha në nisje e sipër. Pa i dhënë karar, në duhej ta zbrazja edhe këtë karro apo ta lija ashtu të ngarkuar, bëra tutje.

— Zenel! Nuk ka nevojë! — dëgjova nga pas zërin e komandantes. Ktheva kokën. Ajo nuk e kishte lëshuar kazmën. «Bëni si them unë, por mos bëni si bëj unë», m'u kujtua dhe i dhashë karros përpara.

Desha të mbush edhe një tjetër, po Shpresa më zgjati bishtin e lopatës, si një postbllok dhe unë u detyrova të dorëzohem pa vullnetin tim, po për respekt të komandantes sime.

Kishte mbetur një sasi dheu goxha e madhe, të cilën ne s'arritëm ta transportonim. Mua më dukej, se faji kryesor në këtë mes binte mbi ne që punonim me karrot e dorës. Për këtë u binda përfundimisht, sidomos kur dëgjova vërejtjet e Shpresës:

— Sikur ta kishim transportuar edhe këtë dhé, norma do të arrinte 130 për qind.

Në zërin e saj ndjeva edhe qortim edhe dëshirë

për të bërë diçka më shumë. Kjo gjë më shtyu të them:

— Shoqja komandante, ne nuk jemi lodhur. Ne jemi në gjendje t'i japim fund edhe kësaj pune. Përse të mos i vihemi?

Ajo më pa drejt e në sy, gjë që më bëri të mendoj. Por, mendimi im kaloi menjëherë, me që ajo më buzëqeshi, ashtu siç nuk mund t'i buzëqeshet një njeriu që gabon.

— Nuk ka nevojë, Zenel! Nesër kemi tërë ditën përpara. Tani, pas meje.

Ne u vumë me kënaqësi pas saj. Së paku unë isha tepër i kënaqur. Një gjë e tillë ndodhte, jo vetëm se prej aty do të vinim drejt e në mencë, por edhe sepse në mencë do të shkonim me shoqen Shpresa.

Ajo nuk e dinte se çfarë mendoja për të... Ja, sikur unë ta kisha motër, vallë a do ta doja kështu si tani, apo më tepër? Apo nuk do ta doja fare?

Njeriu, në shumicën e rasteve e ka të vështirë të pyesë dhe në të njëjtën kohë të përgjigjet vetë për atë që pyet. Po ashtu edhe unë nuk pata mundësi ta sqaroja vetëveten.

Për të pyetur Shpresën nuk guxoja, pasi jo vetëm që kjo më dukej si një pyetje delikate, por edhe se mos këputja ndonjë nga ato aguridhat që nuk honepsen.

Dhe ashtu, me atë kokë, e cila buçiste ende nga zhurma e rrotave të karrove të dorës, unë vija pas komandantes sime. Por, mendjen e kisha disa çape më pas, te ai dheu i gërmuar që ne s'arritëm t'i ndërrojmë vendin. Përse nuk na lejoi ajo?

Shpresa, si vajzë zemërmirë që është, duhet të na kishte lejuar. Përse pra nuk e bëri këtë? Mos

vallë nuk qe aq zemërmirë sa dukej? Bah! Jo, kësh-
tu nuk duhej të qe!

Derisa ne e respektonim aq shumë, derisa ajo
na donte, s'kish si të mos qe tepër e mirë!

Duke baritur ashtu u pengova në një traversë të
lënë në mes të rrugës.

Dy dhëmbët e mi të sipërm, pasi kafshuan një
goxha copë çakëlli, u lëkundën, por nuk ranë. Ja
çdo të thotë të lëshosh traversën në mes të rrugës.

M'u desh të mbaj dhëmbët me dorë gjatë gjithë
rrugës, nga frika se mos më binin papandehur. Edhe
bukën e hëngra me siklet, vetëm me dhëmballë se
ndryshe, pa dashur, mund të haja edhe të dy dhëmbët
e mi gjysëm të këputur.

Haja duke menduar, kështu që nuk mbaj mend
mirë në u ngopa apo jo. Pavarësisht nga kjo, fill
pas darkës, unë ju vodha shoqërisë së komandantes
dhe hoqa mënjanë dy shokët e mi. Me sa duket,
ata si djem të mirë që ishin, e kuptuan se unë diç
do t'u thoshja. Në këto raste, ata nuk pyesnin, po
vetëm prisnin. Dhe unë u thashë:

— Dëgjoni. Kemi punuar mirë sot, po mund të
punonim edhe më mirë.

— E si mund të punonim më mirë? — pyeti me
kureshtje Qanua.

— Po ja, si të them, atë dheun e gërmuar ta ki-
shim çuar të gjithë në vend. Me këtë norma do të
arrinte 130 për qind or babam! Shaka i thonë?

— E ç'faj kemi ne? A nuk i the ti komandantes
dhe ajo vetë s'pranoi? Pse nuk deshi ajo? Hajde
gjeje! Unë them se asaj i është rritur mëndja. Të
qe për mua, kurrë nuk do t'i bëja vajzat komandante.
Merre me mënd: një vajzë gjenerale që të komando-
jë ushtrinë. Unë këtë nuk e kuptoj dot.

— Ai qypi yt nuk e merr dot me mënd, se e ka grykën të ngushtë! — ja ktheva unë midis inatit dhe ironisë.

— E po mirë atëhere! Meqë vetëm ti ke një qyp për të qënë, bën si të duash, përse na pyet neve? — dhe bëri të largohej.

— Qano prit pak!

— Çfarë? — dhe ai ktheu kokën pas.

— Në hekurudhë erdhëm bashkë, pra s'bën të ndahemi. Lipset të jemi përherë bashkë, apo jo?

— Mirë xhanëm, po ç'të rrimë akoma? A nuk do të flemë?

— Aty e kam edhe unë.

— Pa hë?

— Po ja. Të presim gjersa të tjerët t'i zerë gjumi dhe ne, hop e më këmbë. Karrot për dore dhe drejt e te dheu që lamë pa mbartur. Një orë punë është, po norma, fësht e 130 për qind. Hë, si thua?

— Unë jam i lodhur, po nga shokët nuk dua të ndahem, — tha Minella jo fort entuziazat. Diçka të tillë mërmëriti nëpër dhëmbë edhe Qanua. Kjo ma prishi qejfin. Pothuajse përherë, mungesa e entuziazmit mua më trishton. Por ç'të bësh!

Ramë pa u zhveshur. E kishim lënë me fjalë, që sapo kapanonin ta zinte gjumi, të çoheshim.

Unë prisja me vëshët ngrehur, ashtu siç kam dëgjuar, se presin lepujt. Ndërkohë, dy shokët e mi filluan të gërhitnin. Pandeha se do ta kishin bërë me fjalë për këtë, në mënyrë që unë të mbetesh vetëm.

Shkunda së pari Qaniun. Ai lëshoi një gërhimë dhe tha ca fjalë gjysma-gjysma nëpër gjumë...

— Nuk dua moj mami... nuk... boll... u ngopa me petulla... dua... gjumë... — dhe u kthye në krahun tjetër.

E pashë se qe punë e kotë të humbisje kohë më tepër me të! Me gjysëm zëmre dhe me gjysëm shprese u ktheva nga Minella. Ai kishte gjumë të lehtë. U çua! Hapi gojën dhe fërkoj sytë. Shikoi disa herë rreth e rrotull, sikur të mos shquante asgjë, pastaj u ngrit. Më hodhi një shikim, sikur nuk më njihte, dhe pyeti:

— Po Qanua nuk vjen?

— Lere se ka ngordhur për gjumë!

— Aha...

Në majë të gishtave dolëm jashtë. Qielli vetë-tinte nga zjarret. Dhe përmes tyre, hëna bariste e qetë si në shtëpinë e saj. Atë kohë, një yll nuk u mbajt dot më gjatë pas kupës së lëmuar të qiellit dhe u këput e ra kushedi ku. Kjo më bëri të mendoj, se yjet duhet të mbërthehen më mirë në tavanin e qiellit. Të mos bien ashtu kotsëkoti e të thyejnë qafën tëposhtë.

Puna me karrot e dorës na shkundi nga gjumi. Ato zhurmat e rrotave na prishnin ca punë, pasi kishim frikë se mos diktoheshim. Megjithatë, ne e vazhduam punën.

— Zenel! — më foli Minella. — Përse të mos punojmë gjithmonë natën? Bën më freskët, lodhesh më pak dhe qetësi ka më shumë.

— Atë e di Shpresa!

— E, ashtu thua gjithnjë ti. Atë e di Shpresa, këtë e di Shpresa! Po pse, aq e ditur qënka ajo?

— E pse të mos jetë aq e ditur?

— Ku ta di unë... Po ja... dhe se çfarë deshte të shtonte, por unë nuk munda ta marr vesh.

Nuk na kishin mbetur më shumë nga shtatë-tetë karro me dhë, kur pa pritur na u faneps aty Shpresa.

— Oho, puna mbarë petrita! Hë, a nuk u doli një ditë e tërë? Kur do të flini ju?

Ula kokën, ashtu siç bën kushdo që kapet me presh në dorë. Prisja tani qortime tepër të rënda, megjithëqë faji nuk më dukej aq i madh. Shpresa nuk m'i ndante sytë.

— Nejsë, keq nuk kini bërë, po as mirë nuk kini bërë!

Oj, po si qënka kjo? As mirë, as keq nuk paskemi bërë! Po çfarë paskemi bërë atëhere?... Se që diçka e kishim bërë, kjo dukej sheshit. Kurse tjetra vjen e të thotë, as mirë, as keq! Po a hahet kjo?

— Zenel, ti e ke bërë këtë? — më pyeti.

— Me ndihmën e shokëve... — gjegji Minella.

— Shiko, shiko! E paskeni bërë me fjalë. Me besa-besë, apo jo? Dhe komandantes tuaj nuk i kini treguar gjë! Po pse, unë u kam mbajtur gjë të fshehtë juve? Flisni!

Ne nuk folëm! Nuk folëm jo pse s'donim, por se nuk dinim çfarë të thonim... Ku ta dinim ne, në se na kish mbajtur gjë të fshehtë komandantja jonë apo jo...

— Dhe tani, drejtim kapanonit, me vrap! — urdhëroi komandantja. Ne, me gëzim që faji ynë nuk u mbyll me ndonjë dush të ftohtë. u nisëm me vrap.

Rrugës, Minella e prishi qetësinë:

— Shoqja Shpresa! Shoqja komandante... kam dashur të të them se ti... ti je shumë e mirë... Po edhe ne nuk jemi djem të këqij sa të na vësh edhe natën përpara si këcërit.

Minella këtu në hekurudhë që bërë ca i çuditshëm! Fliste më shumë natën. Më shumë dhe më mirë. Edhe për të punuar, kishte qejf që më shumë të punonte natën...

Shpresa ju përgjegj:

— Unë e bëj këtë se çapkenët i kam qejf, por nuk dua që ju të lini gjumin përgjysëm. Ju nuk duhet ta bëni më tjetër herë këtë marifet, përndryshe do ta prishim. Si thoni?

— Besa-besë, nuk do ta bëjmë më! — gjegjëm njëzëri.

— Dorën këtu! — kërkoi ajo dhe na zgjati të sajën. Ne ja rrokëm dorën me kënaqësi dhe të bindur se kurrë nuk do bënim gjë pa pëlqimin e saj.

Ramë, po mua nuk më zinte gjumi. U shtriva në kurriz, pastaj u ktheva në krah të mëngjër. Pas pak, me një gjysëm rrotullimi, ndërrova krahun dhe më në fund u ktheva përmbys mbi dyshek. Po gjumë nuk kisha që nuk kisha. Me sa dukej, edhe gjumi që zëmëruar me mua, si Shpresa në fillim...

...Mirë që na përzuri, po vetë ku shkoi?

Mos vallë ka nisur e punon vetëm? Bah, e si mund ta lëmë vetëm? Natën! Jo, po që vetëm, nuk duhet lënë kështu kjo punë.

U ngrita dhe shkunda Minellën. Por ai nuk dëgjonte më. Pa nguruar, u nisa. Ajo nuk që vetëm. Këtë e vura re përpara se të më vinin re ata. Dhe, nuk di të them me saktësi përse u fsheha. Nga frika apo nga turpi. Sepse, ata të dy... u përqaftuan.

U mbështeta pas një tringu... Zëmra më rrihte si varë. Faqet më digjnin, këtë e ndjeja mirë, pasi nuk që i pari rast që turpërohesh. Pra, ata u përqaftuan dhe unë duhet të skuqesha, të turpërohesh. . . Shpresa nuk qënka vajzë e mirë siç e pandehja. Dhe e doja si motër. Po ai bandilli, kush do të jetë? Pa dale, shiko, shiko! Prandaj paska ardhur Pajua këtu në hekurudhë? Për këto punë i paskan dhënë gj-

thato «S»? Hë, se ja tregoj unë te babai, kur të kthehemi.

Me grushtet të shtrënguara, me fytyrën spec dhe pa fshirë sytë, dola nga vendi ku isha struktur. Nuk desha të fshihesha më!

Ata në fillim u hutuan më tepër nga ç'pandehja. Kjo më bëri qejfin dhe më dha zemër.

Shpresa lëshoi një «ah», Pajua, një «ehë» dhe pastaj mu afruan. Nuk dija në duhej të bëja pas, apo të qëndroja në vend. Po burri nuk bën pas, sido që ta ketë hallin. Edhe unë doja të tregohesha burrë, megjithëse përpara Pajos një trimëri e tillë kish mjaft mundësi të merrej nëpër këmbë dhe të të kush-tonte disi. . .

Hapat e Pajos drejt meje ishin më të gjata dhe më pak dashamirës. Padashur, nuk di se si u hoqa dy çape anash. Po jo prapa.

— Po ti përse nuk flë, po vjen e përgjon këtu rrotull?

— Atë do të ta tregoj unë te babai — i thashë pa i peshuar fare fjalët. Kjo gjë bëri që ai të çojë dorën lart. Por jo si ata që dorëzohen. Se ata çojnë të dy duart. Shpresa lëshoi një «mos» dhe e kapi nga dora. Ky gjest i saj më zëmëroi më tepër me të.

Nuk kisha më nevojë për mbrojtjen e saj. Nuk isha katandisur në atë ditë. Unë i kisha marrë në sy të gjitha, pa e vënë më në hesap mbrojtjen e saj.

Nuk e di ç'lloj gjaku më kish hipur në kokë, por mua më dukej vetja jo vetëm më i madh, por edhe më i fortë nga ata. Këtë dukuri, Pajua mund ta rrëzonte për tokë me dy dacka, por unë isha i sigurt se ai një gjë të tillë nuk do ta bënte dot.

Pajua rrëmbeu një karrocë të zbrazur dhe bëri

tutje i mbushur tërë inat. Ndoshta, prandaj nuk vuri re se karrua ishte bosh.

Shpresa më hodhi krahun supeve, gjë që unë e prisja.

— Shiko Zenel! Ti nuk je i vogël tani dhe ne kemi besim te ti! Ajo më fliste krejt ndryshe nga ç'më kish folur gjer atëhere. Më fliste, siç flitet me një vërsnik. Sikur unë, papandehur të isha rritur brënda kësaj nate dhe të isha bërë barabar me të. Mua më qante zëmra për një të folur të tillë me komandanten time dhe e prita krahëhapur bisedën e saj.

— Ja si është puna. Ne të dy duhemi. Ne do të martohemi bashkë. Këtu s'ka asnjë të keqe.

— Posi, pse për të martuar vijnë njerëzit në hekurudhë?

Ajo bëri buzën në gaz. Fundja, me që duheshin, le të martoheshin, po për t'u përqafuar pse të përqafoheshin?

— Jo, në hekurudhë nuk vjen njeri për t'u martuar, po kur rastis, nuk priset punë.

— Po leje i kini marrë njeriut? Babës tënd, tonit?

— Unë nuk kam baba... Ai juaji besoj se...

Pa e kuptuar, ajo qe ngashëryer... Ngrita kokën dhe pashë në gjysëm errësirë se sytë e saj ishin fryrë nga lotët. Unë pothuaj se u këputa në çast. Si njeri zëmërmirë isha gati t'ja shkrepja vetë të qarit, ajo veç të mos lotonte. Nuk është mirë të lotojë një komandante. Fundja, mua ç'do të më kush-tonte në të vërtetë një e qarë? Sidomos për hatër të Shpresës!

Sa për Pajon, ai se ku u zhduk më gjithë karron e dorës. Dhe nuk bëri keq, pasi kështu unë shpëtoja

nga çdo lloj kërcënimi. Dhe mund të flisja me komandanten si vërsnik, si i barabartë me të.

Që paskeshin ndër mend të martoheshin, nuk them se s'më bëhej qejfi! Por mendohesha se si mund të bëhej dasma këtu në hekurudhë... Ku do t'i gjenim ne krushqit, mishërat dhe rakinë? Nga do të vinin dhe si do të vinin krushkat? A do të pranonte babai dhe çfarë do thoshte nëna?

Të gjitha këto u mpleksën dhe u ngatërruan në një gjumë të thellë e plot ëndërra të bukura...

ANALFABETIZMI

*Kurset dhe kusuret kundër analfabetizmit,
ku unë marr pjesën time.*

Pas asaj nate të paharruar, unë flisja me Shpresën pa drojtje. Jo ashtu siç duhet folur me komandantin tënd.

Me sa kuptoja, ajo nuk ma mirrte për të keq. Veç kësaj, kjo gjë nuk ndikonte aspak në mbarëvajtjen e punës. Se unë punoja më tepër.

Natyrisht, unë prisja që Shpresa të ma hapte vetë atë muhabetin e dasmës në hekurudhë dhe nuk e kuptoja përse heshte lidhur me një çështje kaq të rëndësishme.

Duke dashur që më në fund ajo ta hapte gojën, i thashë pa nguruar:

— Ti më ke qortuar, që unë i kam mbajtur të fshehur komandantes sime vendimin për të punuar natën. Po ti shoqja Shpresë, më ke mbajtur të fshehta vendime më me rëndësi se puna e natës. Nuk di a kam të drejtë të të qorto për këtë.

— A shejtan, shejtan. Po kush të tha se unë ta kisha mbajtur të fshehtë? Vetëm se nuk kishte ardhur koha, apo rasti për ta thënë. Kurse në sjellje

unë nuk lija gjë mangut. Tjetër punë pastaj sa e kuptoje ti komandanti tënde.

...Hëm... më duket, se këtu ajo ka të drejtë! Duhej të kisha kuptuar më tepër nga sjellja e saj e çiltër dhe dashmirëse... Jo të gjitha vullnetaret e tjera ishin sjellur ashtu me mua.

Por ja, një gjë e tillë më kishte shpëtuar. Më kot i rashë më qafë Shpresës. Kjo më kujtoi edhe sjelljen e Pajos pas asaj nate. Ai nuk më rrinte me plot seriozitet dhe kërcënim, si më parë. Shikimit tim sikur i vidhej. Sikur diçka donte të më thoshte, po sepse e zgjaste. As këtë nuk arrija ta kuptoja.

Nga kjo sjellje përfitoja për ta mbajtur veten më të madh e më me rëndësi. Më dukej se me këtë rast unë hakmerresha, për gjithësa Pajua, si më i madh, kishte punuar në kurriz tim.

Pak herë më kishte tallur? Apo ato shuplakat e tij që ngjisinin si pestili...

Mos vallë kishte ardhur koha që unë të hakmerresha? Kaq lehtë dhe kaq papritur! Vështirë të besohej.

Nga këto mendime më shkëputi zëri i Shpresës.

— Zenel, tani kemi shumë punë. Ti duhet të na ndihmosh. Kurset kundër analfabetizmit na kanë hapur telashe. Nuk kemi njerëz. Ose, më mirë të themi se njerëz ka, po nuk na dalin. Ne kemi menduar që të japësh abetaren te fillestarët. Po nuk dimë a do t'ja dalësh?

— Këtë as unë nuk e di mirë! Të bëhem mësues... — dhe menjëherë më shkoi mendja te mësuesi i klasës së parë, të cilin e imitoja fshehura prindëve çdo mbrëmje në shtëpi.

— Po! Të bëhesh mësues. Dhe t'u mësosh shokëve vullnetarë abetaren. Ne do të të ndihmojmë deri sa ta vëmë punën në vijë.

— Ashtu? Mirë xhanëm, po nuk di a do t'ja dal dot. Këtu janë të gjithë burra...

— Pikërisht se janë të rritur, prandaj dhe duan të mësojnë. Të hapin sytë...

E lamë të fillonim të nesërmen pasdite. Ata që do të mësonin shkrim e këndim u mblodhën në një sallë të madhe me stola. Aty pati edhe nga ata që u ulën këmbëkryq përpara meje, meqë nuk mjaftonin stolet. Bile, njeri prej tyre, para se të ulej bëri një, «bismillah». Po se ç'hynte këtu ky «bismillah», unë nuk arrija ta kuptoja atëhere. Dhe as pyeta. Më vinte rëndë ta pyesja se qe më i madh nga unë, e, megjithatë, ende nuk e kishte mësuar abetaren.

Në fillim, m'u dukën aq shumë njerëz, saqë ma çoroditën fare mëndjen. Por, dalëngadalë vura re se nuk ishin aq shumë sa m'u dukën në krye.

Kish aty me mustaqe e pamustaqe, të rruar e të parruar, të qethur e të paqethur. Por që të gjithë, (dhe kjo duhet marrë me mënd) më të mëdhenj nga unë.

Si më i vogli, unë duhej të bëja ato që më thoshin ata, por urdhëri nga komanda qe ndryshe: ata do të bënin ato që do t'u thoja unë. Fundi, unë isha mësuesi. Kjo ma turbullonte mendjen.

Nuk dija nga t'ja mbaja. Asnjëherë nuk kisha patur rast të udhëhiqja dikë. Unë vetëm se urdhërohesha! Ky është misioni i përjetshëm i më të voglit. Dhe unë këtë e kisha të lehtë. Po ja që këtu kartërat ishin ngatërruar dhe unë duhej të bëja të kundërtën. Të urdhëroja dhe të më bindeshin!

E kisha tepër të vështirë! Mezi mbahesha më këmbë. Dhe me siguri që do të më kishte rënë të fikët, sikur pranë të mos kisha shoqen Shpresa. Mjaftonte që ajo të largohej ndonjë hap dhe unë me

siguri do të pritesha. Do të bija si një kokërr dardhe, kur i këput bishtin.

Por ajo nuk u largua dhe ora e parë e mësimit kaloi mirë. Ora e dytë dhe e fundit për atë ditë qe tepër e vështirë për mua.

Shpresa, komandantja trime, nuk më shoqëronte më. Kisha mbetur vetëm për vetëm, si një fëmijë në furtunë. I vogli nuk është mësuar të komandojë më të mëdhenjtë. Prandaj ka të drejtë që i priset mëndja në këto raste. Por kjo nuk vijon gjatë.

Para derës, duke u futur në mësime, dëgjoja pëshpëritje të kësaj natyre: «Ka ardhur një spurdhas të na mësojë allfavitën!» Kësaj i thonë ç'i thonë...

«Të bukur psus që na gjetën...»

«Ka dalë veza mbi pulën!»

«Aq de! Mbylleni të shkretën! Ç'faj ka ai që ne jemi pykë në diell...»

«Po ne, ç'faj kemi?...»

Unë desha të mbyll veshët për të mos i dëgjuar të gjitha, por nuk dija se si mund të bëhej një gjë e tillë. Për të pyetur, as që guxoja. S'ishte punë që bëhej.

Në këtë hall, unë përpiqesha të imitoja sa më qartë, mësuese Leftën apo «zyshën» si i thërrisnim ne. Dhe i pushtuar nga kjo dëshirë fisnike, pa dashur bëra proçkën e parë të madhe, duke u thënë kështu kursantëve burra:

— A i mbani mënd këto, të dashur fëmijë?

Plasën të qeshura të tilla, sa që tavan i filloi të lëkundej dallgë-dallgë mbi kokën time.

E si të mos lëkundej nga këto të qeshura ai tavan prej kartoni aq të hollë? Le të lëkundej, por do të bënte mirë të mbahej ashtu si të mundte, që të mos binte mbi kokat tona.

Shpresoja që ndonjë shpirtmirë t'i priste i pari këto të qeshura torturonjëse, por me sa dukej, aty nuk ndodhej një njeri i tillë.

— Dreqi vetë paske qënë more!

— Ha, ha, ha. . . për ideal, ky paska qënë theatrua vetë! Thoni ç'të doni, po ai na bëri kalamaj. . . ha, ha, ha! Kalamaj me biberon. . .

— Është karagjoz laneti. Ky do të na kënaqë, se me të tilla qyfyre mësimi të futet më kollaj në tru.

— Fundi, derisa nuk dimë të vëmë as imzanë tonë, çilimij jemi!

Pashë se të qeshurat po mirrnin një kthesë tjetër, gjë që më interesonte. Veçse, nuk isha fort i sigurtë sa e vërtetë ishte kjo!

Mendoja se vullnetarëve duhej t'u vinte keq, që unë skuqesha për hatër të tyre. Kjo është një normë e lashtë në edukatën shoqërore.

Në fund të fundit çfarë të bëja? A nuk po luftoja edhe unë kundër analfabetizmit? Atëhere çfarë ka këtu për të qeshur?

Nga mesi i klasës u ngrit një mesoburrë, i cili, pasi shtriu barrën e mustaqeve me shpinë të dorës, tha:

— A, na kënaqe cinxo, na kënaqe! Po qysh do e psojmë këtë djall allfavite, turçe apo shqip?

Kjo ishte një tjetër e papritur për të më turpëruar! Unë kurrsesi nuk kuptoja se ç'hynte turçja në këtë mes! Por dikush prej tyre më erdhi në mbrojtje aty për aty.

— More, ti me atë turçen, mos vjen gjë nga Baba Qemua, apo nga Sulltan Pekmezi?

— Hajde turqi, hajde! — ja priti një tjetër.

— E a derëbardhë, se desha të bëj shaka! — u tërhoq ai.

Ligji më i natyrshëm i luftës: kur tjetri tërhiqet,

ti duhet të hidhesh në sulm. Se pastaj nuk i dihet!

— Shoku vullnetar! Në orën e mësimimit nuk lejo-
hen shaka. Në pushim, po!

— Jo more! — ma ktheu një tjetër. — Po ti ve-
të, paske oreks për shaka, kurse ne duhet të rrimë sus!
Pse kështu mor birçe, ma paç uratën!

— Dale a derëzi, — se kush u fut në valle, — e
pse psuesi të mos bëjë një shaka? Me ne të tjerët
puna qëndron ndryshe.

Kjo puna e shakasë u diskutua gjatë dhe me pa-
sion. Më në fund u vendos që gjatë orës së mësimimit
të mos bëhej kurrë më tepër se një shaka. Mund
të bënte ndonjë përjashtim një rast tepër i rrallë. Dhe,
me që ndonjë rast të tillë tepër të rrallë, ne s'patëm
asaj nate, e mbyllëm mësimin me atë shaka.

Dola si më gjëmbe nga mësimi, por jashtë më
priste Shpresa dhe unë sikur u lirova menjëherë nga
kjo barrë e rëndë për shpatullat e mia të njoma.

SQAROHEM DHE SQAROJ

Nuk mund të veproj ndryshe. Përpara se të sqaroj të tjerët dua të sqarohem edhe vetë. Përpara se të mësoj të tjerët, dua të mësoj edhe vetë.

Kursi kundër analfabetizmit më hapi telashe të mëdha — aq sa nuk më kishte shkuar kurrë ndërmend.

Në fillim e mora si një punë të lehtë. A-së i thonë A, B-së B e kështu deri në fund. Alfabeti ynë qe si një palë shkallë mermeri të cilat mund t'i ngjitja dhe t'i zbrisja symbyllurazi në minutë.

Por nuk qe kështu. Vullnetarët nuk ishin të gjithë në këtë mëndje. Ata mësuan shumë shpejt të shkruanin e të lexonin dhe tani donin të dinin më tepër.

Kështu më ngarkuan të jap edhe mësim natyre. Që në orën e parë dolën para meje shumë pikëpyetje. Unë s'dija asgjë nga mësimi i natyrës. Së paku, po të gjykoje nga ato që më pyetnin vullnetarët, unë nuk dija gjë:

— Sa yje kishte qielli?

— A ishte ky i gjithë një qiell, apo qenë shumë të tillë?

— Përse shiu bie me pika dhe jo me rrëke?

— Qënka e vërtetë se Toka është e rrumbullakët dhe se u rrotulloka rreth Diellit si flutura rreth llampës?

— Po qe se me gjithë mend Toka është e rrumbullakët, atëhere kush ecën me kokë poshtë, Amerika apo Evropa?

Për të sqaruar gjithë këto breshëri duhej që më parë të mësoja vetë. Në këtë mes më ndihmonte Shpresa. Ajo i dinte të gjitha. Për çdo gjë që më shkrepse mua në kokë për të pyetur (nga frika se mos më pyesnin vullnetarët) ajo më përgjigjej dhe më sqaronte.

Sikur të qenë pak gjithë këto telashe, kur ja në mes të orës së mësimit ja behu aty edhe im atë me Pajon dhe me Shpresën.

Pse kishte ardhur babai? Që të më zinte mua për veshi se ika pa leje, apo për Pajon që po martohej pa leje? Ndofta për të dy bashkë. . .

Kjo bëri që punët të ngatërrohen e të bëhen lëmsh. Një lëmsh të cilit unë kurrë nuk di t'ja gjeja fillin. Nga doli këtu im atë? Pse erdhi me Shpresën dhe me Pajon? A dinte gjë babai ç'kishin kurdisur ata të dy?

A duhej të vazhdoja mësimin, apo duhej të takoja tim atë, për të cilin, s'do mend, isha malluar!

Nga ky hall, si përherë, më nxorri shpirtmirja ime, komandantja ime, Shpresa. Ajo më bëri me she-një që të vazhdoja mësimin.

Të vazhdoja! Kollaj e kishte Shpresa të më thoshte kështu. Po si mund ta vazhdoja unë? Të jepja mësim faqe babait? Së paku të më lajmëronin! Po ja që nuk më lajmëruan.

Dalëngadalë, e mora veten. Im atë, Pajua dhe

Shpresa u ulën aty nga fundi. Duhej t'u përgjigjesha disa pyetjeve delikate.

— Përse viti ka katër stina dhe dymbëdhjetë muaj?

— Nga ka ardhur Toka gjer këtu ku është sot?

— Kush e ka shpikur alfabetin?

Këto pyetje qenë të mjafta për të më vënë me shtatulla për muri. Dhe, me siguri, që diçka e tillë do të kishte ngjarë, sikur të mos qe aty Shpresa.

Ajo me marifet e ktheu mësimin në një bisedë të përgjithshme, ku fare mirë mund të humbisnin gjurmët e paditurisë sime.

— Kemi qenë fare qorra! — tha një vullnetar. — Je prapa dynjasë, siç na thoshnin disa, po fare në fund të dynjasë.

— Neve kushdo mund të na e hidhte. Që nga xhandari, taksidari, e deri tek, me nder mbreti.

— Ha, ha, ha, me nder mbreti. . .

— E kur mendon se ata qenë vetë kalofa! hyri në muhabet im atë, gjë që mua më ngrohu. Përse të mos e mirrte fjalën ai, në këmbë time? Apo pak qyfyre dinte ai.

— Ja ç'i ndodhi në kohë të turkut një fshatarit tonë. Ju nuk e kishit njohur Xha Myftarin, rahmet pastë. Xha Myftarit i humbi gomari. E, që thatë ju, Myrtua e kërkoi sa e kërkoi, pastaj e pa që i binte kot dyzenit. Gomari i tij nuk dha asnjë shënjë jete. Kësh-tu, Myrtua, hoqi dorë nga kërkimi i gomarit të tij.

Po të afërmit nuk qenë në një mendje me të. Ata i mbushën radaken që të qahet tek kadiu.

Deshi s'deshi xha Myrtua, u nis dhe arriti te kadiu.

— Kadi efendi, taksirat i madh më ka gjetur! — i tha xha Myrtua.

— Ç'farë ka bërë vaki? — e pyeti rëndë-rëndë kadiu, duke shkuar dy nga dy tespijet.

— Më ka humbur gomari, kadi efendi!

— Të paska humbur gomari? Jezëk, jazëk. Pa të shohim ç'thotë ati Sherif i Gjylhanesë për këtë bela? — tha kadiu dhe hapi një çekmexhe nga tryeza e tij e madhe. Nxorri aty një copë kartë, mblodhi vetullat dhe këndoï rëndë rëndë:

— Zotrote, katundar xhahil dënohesh me 5 vjet burgim!

— Si? Unë kërkoj gomarin e humbur dhe u dëno kam me 5 vjet burgim? Je në fiqir kadi efendi, apo si është kjo punë.

— Unë jam në fiqir, siç do vetë zoti, o harbut millet. Po kështu thotë ati Sherif i Gjylhanesë. Po deshe, po nuk deshe thyej qafën dhe shporru prapa drellit.

— S'do mend, xha Myrtua nuk deshi të futej 5 vjet në burg se i kish humbur gomari.

Ai u largua, duke thënë me vete se një gomar mbi karrike nuk mund të gjeje kurrë një gomar që ka humbur.

Sa doli jashtë takoi një kushëririn e vet që punonte në qytet. I tregoi se ç'i kishte ngjarë me kadiun. I kushëriri qeshi dhe ja ktheu:

— Mos u çudit! Kadiu ynë është numër më vete. Hëm dembel, hëm xhahil. Çdo hall që t'i qash, ai hap një çekmexhe dhe ç'ti zërë dora të shkoqit. Ti bën shyqyr që në radhën tënde hoqi çekmexhenë ku kish vetëm 5 vjet burg. Po mund t'i kish zënë dora çekmexhenë e dënimeve me vdekje.

Kështu i qaheshin hallet milletit një herë e një kohë.

Ja ç'do të thotë të mos dish shkrim e këndim.

Për më shumë, kur dhe kadiu ja fut roma për toma.
Gjykoni vetë tani.

Me këtë histori u mbyll edhe ora e mësimit. Salla u zbraz dalëngadalë duke mbetur me mua, me Shpresën, Pajon dhe tim atë.

Heshtje.

Një llullë e ndezur.

Tri frymëmarrje të drojtura.

Një ballë i rrudhur.

— Hë, e paskini pleksur ë? Dëgjo moj bijë. Ti nuk paske prindër. Nejse, kështu paska qenë fati yt. Po prindër do të kesh. Vetëm se nuk e di a e ke njohur mirë këtë derdimenin që paske vendosur ta marrësh për burrë. Po qe se të pëlqen merre dhe hallall të qoftë. Më mirë kështu. Sy më sy. Ballafaqe. Po u doli mirë, allavers. Po u doli keq, më qafë paçi veten. Ne nuk kemi ç'u bëjmë. Dhe në kemi bërë ndonjë gjë në jetë; këtë për të mirën tuaj e kemi bërë. Për të mirën e fëmijëve tanë. Tani ju sytë në ballë i kini. Edhe mëntë në kokë i kini. Si t'u bëhet më mirë!

Po, si t'u bëhet më mirë! Ndryshe na ndodhi neve. Vetëm se për fat, nuk na doli fare keq.

A e dini ju si u martova unë? Mbaj mend si sot kur vajtëm në Fushë të Bardhë për të parë nusen. Unë, merret me mend, i mbaja sytë për dhe. Po nusen e pashë. Një alamet vaje nja 18 vjeçe.

Birinxhi! Përse të mos e pëlqeja? Dhe fejesa u bë. Aq e pati. Të trashëgohen dhe vate.

Po ç'ndodhi më pas? Kur më erdhi nusja me kalë desh luajta nga fiqiri.

Në kalë kishin hipur një vajzë 13 vjeçe. Kjo na qënkësh ime shoqe. Po si ndodhi që vajza 18 vjeçe u kthye në fëmijë 13 vjeçe? Hajde gjeje, po deshe.

Desha ta kthej pas karvanin. Po kjo do të sillte

shumë belara. U bë si u bë! Fati fat. I dhashë karar dhe nuk u ndjeva.

Kështu u hallosëm ne! Tani erdhën kohë të tjera. M'u trashëgoftshi! — dhe im atë, i ashpëri babai im, u ngrit dhe e puthi Shpresën m'u në ballë. Mua m'u mbushën sytë me lotë. Po ashtu dhe Shpresës. Po ashtu edhe Pajos. Lotë gëzimi. Sa i mirë qënka im atë!

— Unë do të nisem. Zeneli do të vijë me mua apo jo?— pyeti ai sikur të mos qe i pari i kuvendit.

— Përse të mos vijë! — tha pa vend Pajua. Them pa vend, pasi atë nuk e pyeti njeri. Dhe kur nuk të pyet njeri nuk bën të përgjigjesh.

Unë e kuptoj pse donte të më përcillte im vëlla. Që të mbetej vetëm. Por jo, sa të isha unë aty atij nuk do t'i shkonte. Po të ikja unë, ai me siguri që do ta mërziste Shpresën.

— Jo, më mirë të pyesim vetë Zenelin — tha Shpresa duke u drejtuar nga unë.

— Unë dua të rri akoma! mezi pipëtiva nga turpi i babait e për inat të Pajos.

— Mirë biro! Bëj si të duash. Dhe si të dish vetë. Kështu i dua unë bijtë e mi. Trima. Po të pëlqeu të rri, rri. Së pak, këtu do të mësoh se si të nxjerrësh vetë bukën tënde. Epo, mirëmbeçi! — dhe ai pa e zgjatur na mori për qafe me radhë.

Shpresën e puthi prapë në ballë, kurse mua dhe Pajon nuk na puthi. Kjo s'qe e para herë.

Unë nuk mbaj mend që im atë të më kishte puthur ndonjëherë. As mua dhe as vëllezërit e mij më të mëdhenj.

Përse vallë nuk na puthte babai neve? Hajde gjeje po deshe!

MENDIME DHE HESHTJE

Njerëz që bien në mendime. Kjo më shtyu që të bie edhe unë në mendime. Një e papritur dhe ca grushta.

Me sa kisha vënë re, dashur pa dashur, në marrëdhënjet midis Shpresës dhe Pajos pati një ndryshim të çuditshëm: ata takoheshin më rrallë, por rrinin më gjatë me njëri-tjetrin. Po se çfarë shoshitnin në ato takime, unë s'mund ta merrja me mend dhe as që mund të pyesja. Nuk doja t'i jipja rast tim vëllai, që të prishte edukatën qytetare dhe rregullat e vendosura në hekurudhë.

Edhe kur ata të dy gjëndeshin veç e veç më dukeshin si më të menduar. Gjithmonë më të menduar. Taman sikur t'u qenë mbytur gjemitë, megjithëse këtu nuk kishim fare as gjemi dhe as ujë.

Përse mendoheshin vallë ata të dy veç e veç? Ec e gjeje ! Dhe përse mendoheshin kur rrinin bashkë? Unë vetë nuk e gjeja dot, dhe as që mund ta merrja me mend se si qëndronte kjo punë. Këta të marrët me mënd edhe mund ta bëja, por një gjë e tillë vinte në kundërshtim me urdhërin e mësuesit tim të parë: «more bylmez, kur nuk di një gjë, s'ke pse ta marrësh me mend». Dhe unë si çun i urtë, që nga ajo ditë nuk marr asgjë me mend.

Nuk e di as vetë, por ato ditët e fundit edhe unë

kisha filluar të mendoj-dëndur e më dëndur. Dhe kur bija në mendime, nuk doja të më trazonte njeri, ashtu siç dëshëron edhe mëzi, kur kullot livadhit.

Po unë përse mendoja? — do të pyesë ndokush. E përse nuk mendoja... Kisha lënë një jetë dhe kisha nisur një jetë tjetër! Pak ishte kjo? E, megjithatë, kjo nuk qe e tëra! Kjo jetë po më pëlqente për ditë e më tepër... Nga nxënës isha bërë mësues. Punoja sa mundja edhe në kuzhinë edhe në trase dhe aty-këtu dëgjoja fjalë të mira për punën time.

S'do mënd, unë sa Pajua nuk punoja dot. Se unë isha, pothuaj, sa gjysma e tij. Ai punonte shumë. Ndoshta nga kjo anë, mua më dukej se ai mendonte më shumë nga unë. Po përse mendohej ai kaq shumë?... Po për ato gjëra që mendoja edhe unë, apo për të tjera? Më duhej ta sqaroja këtë, po si? A bënte ta pyesja drejtpërdrejt? Po sikur të më vishte ndonjë turijve? Kjo nuk do të qe një gjë e mirë. Se unë e kisha vëlla! Dhe nuk bën mirë kur shikon tët vëllë aq të menduar dhe nuk e pyet se çfarë e mundon ashtu...

Por ai ja nisi vetë. Fare papritur. Dhe pa ju lutur njeri. Po bisedoja me Shpresën për disa çështje me rëndësi, për të cilat kërkoja shpjegime pasi nuk i kuptoja mirë. Dhe ajo përpqej të m'i shkoqiste.

Ca e çuditshme kjo komandantja ime! Nuk e kuptoja, pse nganjëherë ngulte këmbë si mushka në të sajën dhe meazallah se bënte rrugë.

Pajua na u afrua dalëngadalë. Po jo si tinzar! Ndoshta nga kjo arsye ne nuk i ndërpreme diskutimet, mbi pikëpamjet tona.

Pajua, pothuajse përherë vinte i vrazhdët! Çudi, i keq nuk është, po sa për i vrazhdët, shok veten ka! Me këta tipa unë nuk mund të miqësohem... Mund

t'i dua shumë, po për t'u miqësuar me ta nuk mund. Dhe për këtë më duket se faji nuk bie mbi mua. Bilë çuditem se si është miqësuar Shpresa me një nursëz të tillë!

Ata të dy filluan një diskutim majë më majë e gjëmb më gjëmb. Pak mirrja vesh se ku rrihte çekani. Për më tepër se çekani i tyre nuk rrihte mbi kokën time. Dhe kur çekani nuk të rreh mbi kokë nuk para mërzitësh.

S'di përse, po në këto debate, unë isha përherë me Shpresën dhe kundër tim vëllai. Ndoshta nga që ai qe më i madh, më i fuqishëm, apo pse? Dhe ç'është kjo mani për t'i dalë kundër më të fuqishmit? Apo mos është e vërtetë ajo që thotë Pajua, se mua më hanë brinjët kot së koti?

— Të lëmë këto kashtëra dhe të kthehemi te be-reqeti! — tha po me vrazhdësi Pajua. — Dhe pak ditë na mbetën në hekurudhë. Tani në fshat po afron koha e të mbjellave. Gruri pret. Toka pret. Eh, po ku i kuptoni ju këto gjëra? Ti je rritur në qytet, kurse ky shënjëraku, veç të trazojë qullin, nuk di të bëjë punë tjetër.

— A, se ti merr vesh shumë! — ja ktheva unë, pothuaj padashur, pasi nga një guxim i tillë, dreqi e di se ç'mund të më pillte:

— Po Zenel! Ky yt vëlla është njeri i ditur. I mësuar. Ky i di të gjitha. Po do ta shohim nga do t'ja mbajë dhe si do ta katranosë tani që do të kthehet në katund. Atje le t'i shesë këto të rënda.

Në çast, Pajua mori po atë pamje të menduar, që unë ja kisha vënë re dënduar këto kohët e fundit. Uli ballin e gjerë mbi pëllëmbë dhe tha ashtu nëpër dhëmbë me një të tillë, që nuk di pse të vinte keq kur e dëgjoje:

— Po, këtu ke të drejtë! Shumë gjëra kanë ndryshuar. Shumë gjëra duhet të ndryshojnë. Po hë për hë, ne duhet të kthehemi pas. Po a është e mundur të kthehet prapa njeriu? Jo, kjo s'është punë që bëhet. Pisk do ta kemi.

Të them të drejtën, unë në këtë mes nuk mirrja fort vesh, se ku e kishin hallin. Vetja më dukej si një budalla.

Përse do ta kishim pisk? Dhe përse qe aq zor të kthehesha prapa për të vajtur gjer në shtëpi? Apo nuk na prisnin atje! Apo na kishte marrë pak malli. . .

Dhe si mund të shqetësohej kaq shumë ky alamet Pajo! Duke qenë kaq i fuqishëm, kaq punëtor dhe kur kishte krah një komandante si Shpresa! Eh, përse të mos i kuptoj dot edhe unë këto gjëra?

Për këto desha ta kundërshtoj Pajon por një punë e tillë m'u duk edhe pa vend edhe me një farë rreziku të mundshëm. . . Prita!

— Disa gjëra duhen përmbysur. Disa të tjera duhen ndryshuar. A e kupton, Shpresa? Por nuk dihet se sa ujë do të mbajë pilafi.

— Epo, edhe lehtë nuk është, Pajo! Iku koha kur ne loznim cingla. Tani jemi në luftë, a e kupton? Dhe lufta po hyn kudo! Këtu, në katund, në shtëpi, e deri në veten tonë. E, po nuk luftuam ne, nga kush tjetër do të presim?

— Po pse, ne do të rrimë duarkryq? — e ndërpreva unë, pa menduar nëse duhej folur kështu, apo ndryshe. Por, as njeri dhe as tjetri nuk ma vari, gjë që bëri të më bjerë buzuku.

Desha të largohem, po prapë e mbajta veten si burrat. Këtu diç me rëndësi po rrihej, prandaj duhej që ta merrja vesh çdo gjë deri në fije.

— Dhe ti nuk do të më lësh në baltë, apo jo? —

pyeti papritur Pajua. Shpresa uli kokën. Unë desh ja dhashë gazit më të madhe. Kurrë nuk e kuptoja, përse mund të mbetej në baltë Pajua? Buall qe, apo kalë? Patjetër që ai ja fuste katundit me këto. Kështu e ka nganjëherë ai!

— Nuk ma ha mendja! — tha Shpresa pas pak dhe vuri buzën në gaz. Unë shikoja me kureshtje, herë njerin e herë tjetrin, po nuk kuptoja gjë prej gjëje.

Më vinte të bërtisja që të më shpjegonin diçka. Ç'ishte kjo padrejtësi që bënin me mua? Si flisnin kështu, në një mënyrë që të mos kuptoja gjë prej gjëje? Dhe, a është e drejtë që të flitet kështu në pranimë e një më të vogli? Në vend që ta sqarosh atë, me ato që thua ja bën fare sallatë dhe ato pak gjëra që di...

— Kjo është një punë e mirë. Dy vetë janë më shumë se një. Dhe janë më të fortë, oh, ç'punë e madhe që na pret... Gjithë ato gjëra!

— Po, po, katundi ka mbetur shumë prapa.

— Si? — prapritur, Pajua u skuq dhe u bë spec. — Si the? Na paska mbetur shumë prapa? Që kur kështu ti zonjushe? Nga na e nxore këtë? E ku e njeh ti katundin? Apo që nga përrallat e gjyshes? Katundi, ai katund që bëri luftën dhe çfarë lufte, na paska mbetur pas!

— Më ngadalë Pajo. Pikërisht pse u bë një luftë e tillë, prapambetja bie më tepër në sy. Ti mos ano nga katundi, sikur unë i ha të drejtën.

— Jo, po ju qytetarët, një e dy, e me katundin e kini të gjithë. Jo ka mbetur prapa, jo kemi fanatizëm, jo kemi analfabetë. Dhe ja, po na dilni përpara ju qytetarët dhe po na hiqni përdore. Nuk i duroj

dot këto. Katundarit i bie bretku në arë, kurse ju nuk e kini as idenë e mundit të tij.

— Po pse, punëtorit, nuk po i bie bretku? Po këtu në hekurudhë nuk po na bie bretku? Fjala është që ne punën ta marrim me gaz, me entuziazëm, ashtu siç bëjnë njerëzit e lirë. Se për këtë liri luftuam. Që punën ta bëjmë të këndshme dhe jetën të lumtur. Dhe kjo nuk do të arrihet siç pandeh ti: njëri duke i kthyer krahët katundit, tjetri qytetit, por duke i afruar, duke i vëllazëruar. . .

Hë më të lumtë moj komandantja ime! Unë isha i sigurtë që ti do ta dërmoje këtë Pajon krenar. Ai pandeh se i di të gjitha, po ama, nganjëherë nuk di as vetë se ç'flet.

Jo kështu, folë e folë dhe pastaj, kur një trimoshe si Shpresa të vë përpara, ngec dhe as gëk, as mëk. Hë de, folë, pse t'u mpi gjuha? Ehu, e di unë. Me Shpresën nuk e ha dot or babam! Ajo do të të kullandrisi paq ty, paçka se mua më shet mënd me okë, sikur je filozof. Paçka se je edhe më i madh edhe më i fortë se unë.

Kështu i gëzohesha unë me mend Shpresës, kur ata papritur, u ngritën. Unë nuk luajta nga vendi. Le ta mirrin vesh, se kur nuk më përfillnin, as unë s'do t'i përfillja. Përse të mos ndaheshim jek e jek?

Por u gabova, se pak më tej, Shpresa më thirri:

— Zenel, eja, ç'bën aty?

— Do të pres të dalë hëna! — u përgjegja dhe u ktheva në krahun tjetër.

Nuk di pse m'u shkrep papritur të mbetësja vetëm. Nuk doja pranë asnjëri dhe as zhurmë. U shtriva në shpinë me sytë nga qielli. Sipër, larg, tepër larg, vezullonin yjet. Them me sinqeritet se për yjet më vinte keq. Më vinte keq që ata qenë shumë të

bukur, por shumë të largët. Unë do t'i doja të ishin më afër. Të ngopesha me dritat e tyre, me ngjyrat e tyre. Po si mund t'ua transmetoja këtë dëshirë fisnike? Pa shiko si vezullojnë?

Dhe ec pastaj, e kujto atë llampën tonë të murit. Apo kandilin prej bronxi të kuzhinës.

Ja, sikur në dhomën tënde të kishe, në vend të llambës një të tillë yll... Ç'dritë do të bëhej përreth! Po ata mbeteshin të largët, të paprekshëm dhe zili-ndjellës. Apo nuk qenë shumë. Sikur do të bëhej qametë të kisha vetëm një. Me siguri që ata atje sipër e kanë festë e këngë nata natës, përndryshe nuk do t'i ndiznin të gjithë yjet. Dhe a thua, me të vërtetë nuk u vjen keq për gjithë këtë dritë që digjet fare kot? Nuk qenkan hiç nikoqirë ata andej...

Nën vete më dukej sikur ndjeja frymëmarrjen e gjërë të tokës! Po! Unë e ndjeja këtë, dhe jo për të parën herë. Sado që në mësim natyre nuk thuhet gje-kundi se toka merr frymë, unë e kam dëgjuar vetë, dhe bile jo njëherë, frymëmarrjen e saj të madhe. Bile, kur të rritem do të ngul këmbë që në mësim natyre të plotësohet edhe kjo mungesë e paarësyeshme.

E si nuk merr frymë toka? Si nuk psherëtin? Fle! Zgjojhet! Gulçon! Dridhet nga të ftohtit e muzgut. Lan sytë dhe gjoksin me vesën e mëngjezit. Shirat e freskojnë kokë e këmbë. Era i kreh flokët...

Ja, unë kam vënë gjoksin mbi të dhe i ndjej për mrekulli të dridhurat e saj...

Po drejtohesha qejfprishur nga kapanoni. Sa herë që ndahem me sende apo mendime interesante e të bukura, var buzët. Dhe nuk jam në qejf. Dhe nuk dua të më trazojë njeri. As për të bëra shaka, as për të më bërë qejfin... Ka disa që në raste të tilla

më shohin dhe mendojnë, se mua nuk më ka qeshur kurrë buza!

Përpara meje, një skenë e papritur. Dikush vrapon me sa i hanë këmbët, po jo drejt meje. Të tjerët, me sa duket edhe ata me sa u hanë këmbët, i janë vënë pas, duke thirrur:

— Kapeni qenin. . .

— Kapeni gjarpërin. . .

Qeni, gjarpëri, a kush qe, po afrohej. Ishte një njëri të cilit nuk ja dalloja dot fytyrën. Ndjekësit i qenë afruar shumë dhe sa ta kapnin, ai bëri një kthesë, duke i lënë në baltë.

Mua më vjen keq kur ndokush ngelet në baltë. Po ashtu si të kem ngelur vetë. Ai tani po vinte drejt meje.

Në fillim u hutova disi, pastaj me zemrën që më godiste, bëra pak mënjanë. Sa m'u afua, i dola përpara dhe ngrita një hu gardhi që e gjeta aty rastësisht.

— Ku vete krokodil! thirra kur njoha motoristin Xhemal. Por ai nuk më përfilli fare. Në vend që t'i bindej urdhërit tim, më rراسi një grusht në shpatulla dhe unë u shtriva për tokë. Aty pastaj, as sot e kësaj dite nuk e kam të qartë dhe nuk kam arritur ta sqaroj: ose unë arrita t'i bie me hu, ose ai vetë u pengua në të. Si ashtu, si kështu, përfundimi qe ky: ai u kap dhe e piu mirë!

Në këto e sipër, i pari u dha aty Pajua. E mbërtheu për zverku motoristin dhe së pari i ktheu atë gotitjen në shpatulla, që gabimisht e kisha marrë unë pak më parë. Me të goditurën e dytë, Pajua e hodhi Xhemalin shakull për tokë. Dhe pastaj, unë u kënaqa me një të rrahur vënçe, që do të ishte gjynah ta ndërprisje.

Vullnetarët që mbërritën aty, ja hoqën nga duart Pajos motoristin e dërmuar.

— Lere vëlla, se tani i ndan gjyqi lakrat me të.

— Byrazer, po ti kovaç më qënke? Hajde, krahë, hajde! Çfarë të goditura. E ç'i duam varetë e hekurta?

Ndjeva dy duar të njohura në supet e mia. Me siguri që ishte Shpresa. Dhe me siguri, që ajo i ka parë të gjitha! Edhe si rashë nga e goditura e atij qenit. Më vinte turp për dobësinë time. Dhe nuk desha që këtë gjë ajo ta kishte parë me sytë e saj.

— Ti Zenel, je i vogël, por do të bëhesh trimosh!

— dëgjova zërin e dashur të komandantes sime. E, përdërisa ajo vetë mendon se unë do të bëhem trimosh, përse të mos bëhem?

— Po ti çfarë do të bëhesh? — e pyeta me sinqeritet komandanten time të mirë.

Po ajo, me një ton, disi të pakuptueshëm, ma ktheu:

— Kemi aq shumë për të bërë, sa që as vetë nuk e dimë mirë se çfarë do të bëhemi. Rëndësi ka, që ne diçka do të bëjmë në jetë, diçka të madhe shumë...

Nuk e kuptova mirë, por me që ajo thoshte se ne do të bënim diçka të madhe shumë, s'kisha si të mos i zija besë. Dhe s'kishte se si të mos më bëhej zemra mal!

TJETËR ARRATISJE

*Ndodhira që më turbullojnë mendjen, por
e marr veten shpejt. Arratisja dështon!*

Minella:

— Zenel a nuk të thashë? Kot na ka shpëtuar nga sytë ai maskarai! Ne duhej ta kishim zbuluar me kohë. Ai nuk do të arrinte dot gjer këtu sikur t'i kishim hapur sytë mirë. Po tani, ama, e puthi halla! Sa keq që nuk e lanë Pajon t'ja zbërthente fare ato brinjë.

Qaniu:

— Po të më linin mua, do të shqepesha me të. Do ta rrihja, jo për t'i thyer brinjët, siç mund të bënte Pajua. Jo, unë do ta rrihja deri sa t'ja bëja brinjët kadaif.

Unë:

— Mos kini merak! Ka kush merret tani me brinjët e tij. Ka rënë në duar ustai dhe do t'i lajë një për një marifetet që ka bërë.

Qaniu:

— A thua do ta varin në litar?

Minella.

— Po të më pyesnin mua, më mirë do të qe ta varnin me rripin e mesit. Kështu do të lemeritej mirë. Është rripi i mesit të mbaron punë. Ta merr shpirtin

pak e nga pak. Edhe po të rrihesh me ndonjë, gjë më të mirë nga rripi i mesit nuk gjen. Veç duhet të marrësh masa që mos të të bien pantallonat.

Në muhabetet tona edhe Shaqiri dha një shpjegim interesant:

— Tash që u kap kreu i hasmëve të mi, ta po i lajmë hesapet. Kam tash ca mot që po e kërkoj kët rasat. Ta po ja godit shpinën me at hanxharin tem. Kur mendoj se i kam dhanë me hangër një krimineli më kcen gjaku në krye! Po tash po m'i lan të tana. Do ja qit makaronat fije për fije nga hundët.

Këto diskutonim ne të tre, sa herë që bëheshim bashkë. Por puna në hekurudhë, vrulli i saj, telashet, bënin që ne rrallë e më rrallë të bashkoheshim të tre.

Kënaqësia më e madhe që prisja të provoja ato ditë, që pa dyshim gjyqi i motoristit. Ai që kapur më presh në duar dhe me sa dukeshin bathët, do ta pinte mirë. Do të dënohej mirë, si ai, si shokët e tij që kishin po ato mend.

Përse vallë, këtyre banditëve, nuk u pëlqente hekurudha jonë, puna jonë, jeta jonë? Përse? Çfarë duan, ç'kërkojnë? Përse nuk e ulin kokën dhe të punojnë si gjithë të tjerët, po rrinë e na futin shkopinj në rrota? . .

Sa më shumë që mendohesha, aq më shumë pyetje më delnin. Veçse kjo gjë nuk më mërziste. Unë isha i sigurtë se të gjitha këto, do të m'i shkoqiste fije për fije komandantja ime e dashur. Bile, më bëhej qejfi që do të kisha arësye tepër serioze për të biseduar me të çështje me kaq rëndësi.

Dhe ndërsa prisja të takoja Shpresën, diçka e papritur tronditi vullnetarët. Qe arratisur, pa u kuptuar motoristi. . . Aq më keq. Motoristi që arratisur, kur orën e shërbimit e kishte patur Pajua.

Tamam sikur t'ja kishte bërë për inat, a për t'u

tallur! A mund të mos e tërbonte Pajon një gjë e tillë! Me siguri që po, përderisa edhe mua më vjen të tërbohem.

Shpresa më qetësoi. Ajo më tha se Pajua, atë ditë qe lodhur shumë. Kish bërë tre norma. Dhe, merret me mënd, në roje kish dremitur disi. Por i arratisuri nuk donte më tepër.

Kushedi se si do të qe bërë Pajua. Por nuk pata rast ta shikoja. Shpresa më tha, se ai qe bërë qymyr! Nuk e donte veten. Shtrëngonte dhëmbët dhe pa e dëgjuar njeri, i kish thënë vetëm kaq Shpresës:

— Nuk do të më shpëtojë edhe sikur zog me krahë të bëhet! — dhe qe larguar me hap të vendosur në kërkim të të arratisurit.

Shpresa qe çuditur me këtë kokëfortësi të Pajos, po unë që ja njihja prej kohe atë kokë tim vëllai, nuk u çudita fare. Bile, mendoja se edhe komandantja kot çuditej. E ç'kishte këtu për t'u çuditur?

Njëri u arratis, tjetri do ta ndjekë deri sa ta kapë! Çudi. Shpresa, që mua më shpjegon me mençuri gjithë ato gjëra, për vetë të saj nuk arrin të kuptojë diçka të tillë! Pra, koka ime nuk qënka fare bosh, siç pandeh nganjëherë.

Në kërkim të të arratisurit, tim vëlla nuk e lanë vetëm. Komanda e hekurudhës nisi pa vonesë edhe disa grupe të tjera me shokë, që në këtë punë nuk jua hante qeni shkopin.

Duke shkuar për të marrë punën, rrugës më arriti Qanua. Ai tani është građuar; punon me lopatë. Sipas tij, ky është një sukses.

— More Dhaskal! Po ku djallin fute tërë pasditeve. që nuk ta shohim fare bojën? — më qortoi ai. — Humbe fare me ato kurset kundër analfabetizmit. Kurse unë po merrem me teatër. Hej, si ikën koha

këtu! Nuk e shikon fare. Po ç'e do që u ndamë. Do të bënim punë më të mëdha po të qemë bashkë. Se përse vajte e u mplekse me ato kurset kundër anal-fabetizmit! Me teatrin, puna qëndron ndryshe. Ka qyfyre aty.

Duke dëgjuar të tilla llomotitje, ne arritëm në hyrjen e tunelit dhe aty u ndamë. Unë mbeta me Shpresën. Na duheshin edhe disa metra për ta hapur tunelin tejprtej. Nga lart ujët rridhte si me ulluk. Mua më binte drejt e në shpinë, po nuk kisha ç'bëja. Rrobat e qullura më ngjiteshin për trupi dhe më rëndonin.

Sa fillonim punën, trupi më mbushej me pluhur e me dhé. Lëkura më hante, sikur të kisha zgjeben. E, megjithatë, nuk kruhesha. Këtë s'e bëja, jo pse nuk doja, porse nuk mundja. Unë i mbaja daltën komandantes, kurse ajo qëllonte me vare. E si mund të kruhesh, kur i mban daltën komandantes?

Dukej sikur binte shi brënda tunelit. Të gjithë ishin lagur, po unë isha i bindur, se askush nuk qe bërë ujë e baltë ashtu si unë. Nuk u muar vesh se kush ja nisi këngës ashtu papritur:

Po na vjen behari...

Ai me siguri gabohej. Behari dalëngadalë po na linte shëndetin. Le që këtu në tunel, të dukej sikur ishe në mesin e dimrit. Çudi, si ju kujtua behari atij shoku, kur ne na dridheshin dhëmbët nga të ftohtit. Të tjerët veç nuk ishin të një mëndjeje me mua.

Vullnetarët, sikur nuk prisnin gjë tjetër, u bashkuan me të menjëherë. Krismat e vareve nuk i pengonin dot zërat të bashkoheshin, të buçisnin dhe të mbushnin plot e përplot tunelin.

— Komandante, si thua ti, a do ta kapë Pajua atë?

— Besoj se po! — u përgjegj ajo, duke i mëshuar varesë.

— Edhe unë ashtu them, po prapë trëmbem.

— E përse trëmbesh?

Unë, që në të vërtetë nuk e kisha fort të qartë përse trëmbesha; ju përgjegja:

— Trëmbem se mos nuk e kap dot.

Në pushim dola jashtë për të shpëtuar nga shiu i tunelit. Kjo ndokujt mund t'i duket si një sjellje e çuditshme pasi edhe jashtë binte shi. Po sipas meje, këtu kishte një farë leverdie. Së pari, jashtë shiu ishte më i rrallë dhe së dyti, ujët nuk ishte aq i ftohtë sa në tunel. Prandaj dola.

Si kisha bërë disa hapa, m'u afrua një teknik i huaj. Vinte tepër i gjatë. Ndoshta dy herë e më shumë nga unë. Ezmer dhe me një palë mustaqe të holla, më të holla se vëtullat. Mua nuk para më pëlqente. Nuk di pse, po ndoshta nga puna e mustaqeve. Më dukej se burrit nuk i kishin hije të tilla mustaqe. O i mbaj si të gjithë ato të shkreta mustaqe, o rruaji fare!

Edhe sikur t'i mbante ndonjeri te ne të tilla mustaqe, do ta tallnin e do ta bënin lolo, derisa t'u vinte briskun.

— Po ti, pionieri, përse ke ardhur këtu? — më pyeti ai.

Të them të drejtën, pyetja e tij më çuditi si tepër, saqë do tja kisha shkrepur të qeshurit, sikur të mos qe aq i gjatë dhe aq i vrazhdë. Pastaj pashë se e kishte seriozisht.

— Për hekurudhën! — ju përgjegja.

— Hekurudha, hekurudha. . . ju të gjithë për hekurudha. Sikur të gjitha do të bëni nga një hekurudhë. Po ti je e vogël, shumë e vogël. Përse ta vish këtu.

Tani nuk u çudita më, por u zëmërova. Unë pra, isha tepër i vogël sipas tij! Çudi, kjo nuk më kishte shkuar ndër mend! Po ja, ta zemë se është ashtu.

Ç'doli nga kjo? Dhe fundi, ç'i hyn në xhep këtij zdapi se sa i vogël jam unë?

Të mëdhenjtë, zakonisht, kanë më shumë mend nga të vegjëlit. Kjo dihet! Por ata gabojnë rëndë, pothuaj që të gjithë, në një pikë: kur të voglit i thonë se është i vogël! Ata nuk e kuptojnë dot, se sa lëndohet i vogli nga këto fjalë. Aq më tepër, pastaj nga mënyra se si ja thua. . .

Po ky shoku teknik, mos kërkon të më shesë mënd pse është i gjatë sa një kavak? Po a matet mençuria me gjatësinë e shtatit?

— Unë nuk jam i vogël! — i thashë edhe si me qortim edhe si me mburrje. — Ka pasur partizanë në moshën time. Edhe partizane ka pasur.

— Ajo tjetëra puna është. Po ti s'duhej ardhur këtu. Ti akoma duhet lozur. Duhet pish qumësht. Rritur duhet. Fort duhet.

Ndërkohë, qe afruar një shoku i tij.

— Eh, Draga, Draga, — ja nisi tjetri, — ti nuk i njeh mirë shqiptarët. As shqiptarët, as Shqipërinë! — i tha ai me një ton që më fitoi zemrën.

— Unë kam ardhur për puna dhe jo ta njeh, — ja ktheu ai me vrazhdësi, gjë që më bëri ta marr akoma më zët.

— Edhe të njohurit, o Drage, është një punë me rëndësi. Komunisti i mirë nuk e kryen dot deri në fund me sukses detyrën e vet, po qe se nuk arrin t'i njohë mirë njerëzit me të cilët punon.

— Këto janë debat filozofa! Ne kërkojmë puna, jo filozofa. Jo filozofa bosha.

— Si boshe? Ti thua boshe?

— Po! Unë them bosh. Unë, jo filozof, unë teknik. Këtu s'kam ardh për t'u pranuar dhe edukuar komunist, po si teknik. Unë jam teknik.

— Shiko se mos e ke gabim. . .

— Kush unë? Unë gaboj? Unë teknik!

Dalëngadalë ata u kapën me gjithë mend me njëri-tjetrin dhe mua më harruan fare. E, meqenëse, jo vetëm gjuhën, po edhe hapin e kishin më të gjatë nga unë, u larguan e më lanë pas. Po edhe unë nuk desha t'i arrij. Megjithëse sa vinte e flisnin me zë më të lartë, unë nuk i dëgjoja mirë se çfarë thoshnin. Por dukej sheshit se nuk po merreshin vesh dot me njëri-tjetrin.

— Shoqja Shpresa, si thua ti, a duhet që komunisti i mirë t'i njohë njerëzit me të cilët punon?

Ajo mbeti disi e habitur nga kjo pyetje, gjë që mua më rriti mëndjen.

— Kjo s'do mënd! Po ti, si e ke punën? Që tani ke vendosur të bëhesh komunist? Folë, ku t'i zuri veshi këto fjalë?

Duke qenë i sigurt, se asaj nuk i fshihja dot gjë, dhe meqenëse unë nuk kisha pse ta bëja një gjë të tillë, i tregova për bisedën e dy teknikëve.

Ajo tundi kokën me dyshim, më shikonte në sy dhe herëpashere ngrinte një tufë flokësh që i binte mbi vetulla. Kur mbarova tha vetëm kaq:

— Po, po, nuk ka pyll pa derra!

Nuk desha ta zgjat, meqë as pyjet dhe as derrat s'ngjallnin ndonjë interes për mua aty në hekurudhë.

Atë natë isha po aq i lodhur sa edhe netët e tjera, megjithatë qerpikët i kisha të lehtë si pendë. Më përziheshin një mori gjërash në mendje. Pajua që ndiqte të arratisurin, teatri i Qános, tekniku Drage, biseda mbi komunistët, komandantja e menduar, kurset kundër analfabetizmit. . . Dhe të gjitha këto zinin një qoshe të mirë të trurit tim të vogël duke mos lënë

aty asnjë vënd për gjumin, i cili më kot vinte rrotull shtratit.

E mira është, që kur vjen ora e gjumit, mendimet të mos vërshojnë kështu nga të katër anët. Se i thonë gjumë! Gjumi duhet respektuar. Ai ka orën e tij. Të drejtat e tij. Mendimet duhet t'i hapin rrugë atij. . . Por, më kot flisja kështu për mendimet. Ato nuk përmbaheshin dhe nuk pyesnin fare për pikëpamjet e mia mbi këtë çështje.

Pajua u kthye pas tri ditësh. Kjo më gëzoi pa masë, për më tepër se ai ja kish arritur qëllimit. E kishte kapur të arratisurin në pyjet e Bizës. Po për këtë ai nuk donte të fliste, dhe mua, të them të drejtën, nuk ma mbante ta pyesja.

Isha i sigurtë se Shpresa do të merrte vesh çdo gjë dhe kisha besim të patundur se ajo do të më tregonte pastaj për të gjitha.

Pajua kishte marrë një nishan në ballë. Motoristi kish dashur ta çante me thikë pikërisht në atë vënd. Po ta shikoje Pajon nga rrobat duhet të kafshoje fort gjuhën, për të mos ja shkrepur gazit.

Ai qe katandisur, siç i thonë sa as qeni s'kishte ku ta kapte. Por mund ta flinte mëndjen nga kjo anë, pasi këtu në hekurudhë asnjëri nuk mbante qen. Rrobat i qenë shqyer e grisur në shumë vende. Diku i kish mbërthyer me tel të trashë, diku me spango, e bile, në rripin e shollës kish përdredhur një copë tel me gjëmba.

Gjuri i këmbës së djathtë dhe tre gishtrinjtë të po asaj këmbë i kishin dalë përjashta. Disa lecka i vareshin dhe i tundeshin lirisht nga rrobat e tij dhe ai, me sa dukej, nuk kishte ç't'u bënte.

Po për çudi nuk ndjehej i lodhur sa ç'dukej i grisur.

ME KËRKOHET NDIHMË

Pajua kërkon ndihmën time. Unë jam plotësisht i gatshëm, po nuk di se si do ta ndihmoj.

Në ditët plot vrull të hekurudhës, Minella, për mua, sikur humbi në atë mizëri njerëzish. Por ai nuk kishte humbur dhe as që i shkonte nëpër mend një gjë e tillë. Mua, si puna, si zemra, më lidhën për ditë e më shumë pas komandantes sime, ndërsa Minella dhe Qanua po bënë bujë dhe gjurulldi në grupin e theatrit.

— A e kupton ti Zenel, — po thuaj më bërtiste Minella, kushedi për ç'loj faji që nuk e kisha bërë kurrë, — a e kupton se kjo është e padrejtë? Më kanë detyruar të luaj rolin e një dembeli që nuk ja gjen shokun në tri nahie bashkë. Përse të ma punojnë këtë rreng? Si thua ti, mos vallë pse jam më i vogël?

— Pse më i vogël, Qanua nuk është më i madh nga ti!

— Nuk është, s'do mend. Po ta dish ç'thelë këputi ai qerrata, pa! Komandant skuadre u bë. Dhe vjen e më shfryn, më heq veshin, më demaskon e më bën rezil pse nuk luaj kazmën. Po a durohet kjo? Jo vëll, nuk durohet. Do qahem tek shoqja Shpresa.

— Dëgjo Minella. Me sa di unë, shoqja Shpresa nuk i duron dot të qarat, prandaj mos e bën dëm

llafin. Pastaj duhet ta kuptosh, se ti je në teatër, e nuk je me të vërtetë dembel. Ti shiko si e si ta për-qeshësh më mirë atë dembelin që të kanë besuar dhe kësisoj, do të dalësh faqebardhë.

— Po pse, nuk do të më tallin mua më pas?

— Bah, e përse do ta bëjnë këtë? — u fut pa-pritur një zë i njohur në bisedën tonë. Ishte koman-dantja. — Ç'është ai llaf! — vazhdoi ajo. — Ti duhet t'i luash fenë atij dembelit tënd. Dhe pse të mos marrësh si shembull Rakon tonë? Ai do gjysëm orë të zgjohet. Mezi hap sytë, gojën vesh më vesh, shtrin kryqet, pastaj kthehet në krahun tjetër. E tundin prapë dhe ai fillon nga e para. Lere pastaj si e mbush atë të shkretë lopatë. Siç mbushet shosha me ujë! Ja që nuk e ke aq të vështirë punën sa e bën ti. Ti më mirë shiko Rakon ndonjë ditë nga mëngjezi në darkë dhe ja ku e hodhe lumin. Bën ato që do të shikosh te Rakua dhe ke për ta qarë rolin tënd.

— Do të përpiqem, do të përpiqem! — u bind Minella. — E gjithë puna është që mua të mos më tallin pse do të loz rolin e dembelit.

— Kjo s'ka pse të ndodhë. Edhe ti Zenel nuk do të qe keq sikur të na bëje diçka lidhur me këtë.

— Ç'farë? — pyeta tepër i gëzuar, që mund të plotësoja edhe unë një dëshirë të komandantes sime.

— Ty të vjen dore për vizatime. Ja na bëj diçka për atë Rako dembelin që ha shumë dhe punon pak. Vizatoje fjalë vjen, jo me lopatë apo me kazëm, por me kazanin e kuzhinës, apo me diçka tjetër të tillë. Ashtu si për të qeshur, de!

E pse jo! Dhe nuk kish ndonjë zor të madh për të vizatuar qoftë Rakon, qoftë kazanin. Si njeri, si tjetri, diç i kishin marrë hua shoku-shokut. Se çfarë

konkretisht, unë nuk e dija me saktësi, por do t'i vëreja me kujdes dhe besoj se do ta mësoja.

Kazani i kuzhinës me Rakon, me një fjalë, qenë binjakë. Po që se kazani ish plot me makarona, apo me supë, Rakua mund ta boshatiste edhe duke qënë vetëm për vetëm, pa u trembur se mos i nxihej faqja. Që të dy ishin të pangopur. Kishin vetëm një ndryshim: ndërsa kazani mbushej për të tjerë, Rakua mbushej vetëm për vete.

Minella u bind të lczte rolin e dembelit, kurse unë ju vura prapa kazanit të kuzhinës dhe Rakos, në mënyrë që të vizatoja diçka për ta.

Në mbrëmje i dorëzova Shpresës atë që kisha mundur të hedh mbi një letër të bardhë. Aty Rakua i qafej doktorit së kishte gëlltitur bashkë me fasulet edhe kazanin e kuzhinës. Tani donte ta villte, po kazani kish zënë vend dhe nuk dëgjonte të dilte prapë jashtë.

Shpresa qeshi me të madhe, gjë që më kënaqi pa masë, pastaj më mori për qafe dhe më tha buzagaz:

— Mrekulli Zenel, mrekulli! Po pse nuk ke bërë edhe gjëra të tjera po kaq të mira deri tani, po prite gjersa të të kujtonja unë. Apo nuk kemi patur nevojë për këto!

Unë ja ktheva rëndë-rëndë, me një ton prej plaku:

— Se gjërat e mira nuk bëhen aq lehtë!

Ajo qeshi përsëri, pastaj më kapi përdore dhe vajtëm te gazeta e murit. Aty ngjitëm vizatimin tim dhe bëmë tutje nga kurset kundër analfabetizmit.

Këtu punët nuk vinin keq, po ç'e do, kisha ngecur me një farë Zyberi. Ky Zyberi, për hesapin tim, ish një gjë tepër e trashë. Meazallah se i futej gjë

në kokë, daç me të shtyrë, daç me të ngjeshur. Bile, mua më dukej se nuk kishte fare kokë. . .

Edhe këtu isha gabuar, po nuk e kisha për të parën herë, prandaj vendosa të mos nxitohesha më, kur qe fjala për kokat e botës. Hallin e Zyberit ja qava komandantes.

— Çudi, tha ajo, — mua nuk më duket i tillë ai tip!

— Provoje! — ja ktheva unë gati i fyer. Si kish mundësi që ajo të mos më zinte besë? Dhe ashtu, pa folur, u futëm brenda.

Vajtëm të dy në një stol nga fundi, ku qe ulur Zyberi, dhe Shpresa e përshëndeti e para.

— Si i ke punët Zyber?

— Bereqarves shoqja komandante! — ja ktheu ai. Kjo përgjigje më ngriti nervat, se e dija mirë se ç'mavri bereqarves ishte ai.

Për çudi, Shpresa e gjeti gjuhën me Zyberin. Ajo e pyeste, ai përgjigjej pa ju marrë as goja dhe as fryma. Mua nga habia, më fryheshin sytë si të një bufi. Ç'qe kështu me këtë Zyberin? Me mua nuk ja ka bërë shkrap, sa herë që e kam pyetur, kurse me komandanten vete e bëhet bilbil. A durohej kjo?

Zyberi, sikur ta kish marrë me mend hallin tim, filloi të shpjegojë pa m'i hedhur sytë.

— E shikoj, se këtu kam bërë një gabim shoqja Shpresa.

— Cfarë gabimi paske bërë? — e pyeti ajo.

— Po ja, këtij shokut, mësuesit të vockël. (kjo shprehje më lëndoi) ja kam plasur shpirtin. Sa herë që më ka pyetur në mësim, nuk i kam kthyer xhevap.

— Pse kështu? — pyeti në vënd tim komandantja.

— Si të them, shoqja Shpresa, po ja, më vinte

hëm rëndë, hëm turp. Thoshja me vete: «Një pëllëmbë çilimi dhe të më japë mend mua. Dhe nuk ja bëja xhap. Po shoh, se s'kam bërë mirë dhe jap fjalën se nuk do ta përsëris.

— Shumë mirë po të mos e përsërisësh! — ja ktheu buzagaz Shpresa. Me sa duket, kjo nuk lehtësoi vetëm atë po edhe mua.

— Dua të mos ma marrë për të keq, (ai prapë nuk më drejtohej mua, po kjo nuk më zëmëronte më në prani të Shpresës) se kështu jemi ne: njerëz të pamësuar, po me sedër ama! Nuk e kam bërë këtë me qëllim të lig, po ja ashtu, se më vinte edhe rëndë, edhe turp!

— S'ka gjë, s'ka gjë. Mjafton që e ke kuptuar! — e qetësoi Shpresa. Edhe unë ashtu do t'i kisha thënë, po të më pyesnin.

— Jo, po e kam me gjithë mend. Edhe rëndë, edhe turp më vinte. Dhe nuk ja bëra shkrap.

Kisha mbaruar së shpjeguari mbi rolin dhe rëndësinë e lidhëseve dhe po bëhesha gati të hidhesha te parafjalët, kur papritur, më doli përpara Rako dembeli. Ai hapi derën me rrëmbim, pa trokitur fare, bile pa e ulur dorezën e derës. Kështu që krisma e derës i shkundi të gjithë.

— Ku është parë ky maskarallëk? — Rakua tundte në derë letrën. ku qe vizatuar me kazanin në bark. — Me ç'të drejtë më ke zografisur kështu, sikur jam i biri i djallit?

Jo vetëm unë, po edhe klasa ime që ish hedhur në sulm kundër analfabetizmit, u hutua disi nga ndërhvria e papritur e Rakos.

Një vullnetar në stolin e parë ja mori nga dora letrën dhe sakaq, ja plasi gazit. U mblodhën të gjithë rreth tij dhe klasa oshëtiu nga të qeshurat.

Mua edhe më qeshej, po edhe s'ma mbante. Rakua dukej aq i zemëruar, saqë nuk do ta kisha mirë, sikur të vazhdonte ashtu siç e kish nisur. Vërtet dembel dreqi, por jo duarthatë. Ai e kishte pëllëmbën sa një lopatë edhe pse nuk luante lopatën nga vendi. Dhe, sikur pëllëmba e tij të mbështetej mbi mua, kjo s'do të më pëlqente fare. Vërtet, të qeshurat që nuk po pushonin, e nxënë më shumë Rakon.

— A e di ti, o feçorr, se çfarë të punoj? — u ngërdhesh ai dhe bëri përpara sypatrembur. Unë isha përpara nxënësve të mi, prandaj nuk duhej të tërhiqesha. Mësuesi asnjëherë nuk duhet të japë shembuj që s'e nderojnë.

Në çastin që Rakua u mat të bënte një gjest burrëror, Zyberi e mbërtheu nga jaka e palltos, e hoqi pas dhe i shfryu:

— Ej, ti, xhandar ke ardhur këtu, apo milic? Ku e gjete ti të na prishësh mësimin? Ti je vullnetar, apo ç'të të them? Apo ke qejf të ta pllaqos një turinjve, sa të të duket njëshi kerrasë! Hy, shporru tutje! Mirë ta ka bërë, se dembel e kryedembel je ti; ja çfarë je!

— More, po ngjishja, ç'ja zgjat! — e nxiti dikush.

— Ku ka të drejtë ai të grisë gazetën tonë të murit?!

— E a derëzi, futi ca shqelma dhe lere t'ja mba-thë nga majat thembrat.

Po nuk u bë as njëra dhe as tjetra, se atë çast u gjend aty komandantja e revoltuar.

— Shoku Rako! Kush ta ka dhënë ty të drejtën ta grisësh gazetën e murit? A e di ti se ç'është gazeta e murit? Kush e ka fletën? — pyeti ajo, duke shikuar nga klasa.

— Mos ja vërë veshin shoqja komandare, se Ra-

kua ashtu e ka! — tha një vullnetar, duke dorëzuar letrën ku qe bërë karikatura e Rakos.

— Është ca nevrík dreqi, po në kuzhinë ama, të lë me gisht në gojë! — sqaroi një tjetër.

Isha tepër i interesuar të shikoja se si do t'i përballonte shoku Rako tani këto romuze pa anë e fund. Se, me sa shikoja unë, atij i qe lidhur gjuha si kapistër mushke.

— Ju vazhdoni mësimin, — tha Shpresa, kurse ti shoku Rako, do të vish me mua deri në shtab! — dhe e vuri përpara dembelin e hutuar.

Edhe pse doli Rakua, qyfyret dhe romuzet rreth tij vazhduan goxha, deri sa u vendos qetësia, gjë që më dha mundësinë të hidhesha prap tek parafjalët.

Unë dola i fundit. Sipas rregullores së shkollës, nxënësit duhet të presin derisa mësuesi të dalë nga klasa. Po këtu ngjiste gjithmonë e kundërta. Ndoshta kjo vinte pasi mësuesi këtu ishte më i vogël nga nxënësit. Dhe, nuk thonë kot: mos qofsh i vogël!

Të them të drejtën, fakti që isha aq i vogël, më lëndonte dëndur. Dhe ja sepse: po të isha ca më i madh, do të kisha dalë maleve partizan! E pse jo? Së dyti, disave do t'u tregoja vendin... Së treti... po e treta m'u zu në fyt, pasi më të dalë të derës, më mbërtheu për qafe një dorë e fortë.

«Tani e piva!» — thashë me vete dhe po mendoja ndonjë marifet për të dalë nga ky çark.

— Ku je more spurdhjak, që më je fshehur tërë ditën? Apo, helbete, u bërë mësues tani! — dëgjova zërin e Pajos dhe mora frymë i lehtësuar, pasi ai ma hoqi dorën nga qafa dhe ma hodhi krahëve.

— Kam ca punë me ty Zenel, — vijoi ai.

— Për hair! ju përgjegja unë si ç'kisha dëgjuar në

shtëpi në këto raste, duke dashur të imitoj më të mëdhenjtë.

— Dëgjo, mor i pagjalpë, dhe mos u tall, se do të ta ngjesh një turijve, që të mos shohësh nga të vesh! — më tha me një ton që s'kish asgjë të përbashkët me shantazhet dhe me kërcënimet e vërteta. — Ja si është puna. Ç'është e vërteta, puna është ngatërruar e është bërë lesh e li. As unë s'di, nga dhe si do ta kap.

Unë prapë desha ta hedh në shaka, po ai fliste aq seriozisht, sa që u binda se tani me të vërtetë do të ma ngjishte turijve, sikur t'ja ktheja në shaka hallin e tij të bërë lesh e li.

— Më kanë thënë se fill pasi të largohemi nga hekurudha, mua duan të më futin në shkollë. Në një shkollë ushtarake.

— Dhe ç'ka të ngatërruar në këtë mes? — Kjo ta paska bërë ty mëndjen dhallë?

— Dëgjo dhe mos më shit mënd. Kjo është një gjë e mirë dhe unë ku ta gjej shkollën. Po nuk di ç'do të thotë babai.

— Hëm... po... Ç'do të thotë? Ja si përherë... Prapa diellit të venë. Të nxjerrin bukën e tyre! — imitova unë babën.

— Të thotë ashtu ku ma gjen. Po sikur të mos dojë?

— Hëm... Kjo punë duhet parë mirë!

Por, nuk arrita të shikoj gjë, me që dikush nga pas më mbylli sytë me pëllëmbë.

— Komandantja!

— Bravo!

Ajo më doli në krah pa ma larguar dorën nga qafa. Ecëm një copë herë në heshtje. E shikoja me kujdes Shpresën dhe nuk di pse më dukej e turpëshme. Aqsa edhe mua më vinte turp ta shikoja ashtu

vjedhurazi. Prandaj i ngrita sytë lart në qiell. Edhe hëna shikonte si me turp. Ajo qe mbuluar me një napë të bardhë, gjysëm të tejdukshme dhe ngjante sikur e kish me mëdyshje atë shikim të largët... Sikur po pendohej, që përgjonte kështu natën shoqet e saj mbi tokë.

— Si venë punët? — pyeti komandantja, pa ju drejtuar asnjëri prej nesh. Këto pyetjet, në përgjithësi, kanë një të mirë: po të duash nuk u përgjigjesh dhe nuk mban asnjë përgjegjësi. Megjithatë, si më i vogël, e ndjeva për detyrë të përgjigjesha.

— Më mirë pyet se si do të venë punët.

— Aha, po! Prandaj jini hequr mënjanë? Po, po. Si do të venë punët, ë? Mirë do të venë. Mirë që ç'ke me të. S'ka si të venë ndryshe!

— Ashtu them edhe unë. Veçse për këtë duhet të pyeten edhe disa më të mëdhenj nga ne.

— Kjo s'do mënd, Zenel. Do të pyeten. Dhe do të nderohen si më parë. Prindët janë prindër. Ata kanë vendin më të nderuar në familje. Veçse një gjë duhet sqaruar mirë, si te prindët tanë, si te vetja jonë. Një jetë e re e pret familjen, katundin, qytetin, shoqërinë! Do të ndryshojnë shumë gjëra. Zakone, ligje, familje... Kjo duhet sqaruar mirë dhe me zgjuarësi. Se sqarojmë prindët tanë, e jo dokëdo. Prindërit tanë të mirë!

MINAT ME SAHAT

Dy vetë që nuk i zë gjumi! Një tjetër që duan ta ngrenë nga gjumi. Të tjerë që nuk flenë...

Ata të dy që nuk i zë gjumi, jemi unë dhe Qanua. I treti, të cilin duam ta ngremë nga gjumi, është Pajua. Por ai ish çuar para nesh. Të tjerët, pastaj, që nuk flenë, janë ata që do t'i përmënd më poshtë.

Ajo natë ishte si gjithë të tjerat. Dhe unë, si çdo natë tjetër, isha shtrirë për t'ja marrë me gjumë.

Në fillim, pandeha se fajin ma kishte jastëku i mbushur me kashtë e me gjethe dushku. E ktheva dhe e rregullova disa herë, duke dashur të sheshoj xhungat që formoheshin brenda tij. E, megjithatë, gjumi nuk më zinte. Me sa dukej, fajin nuk ma kishte jastëku, pasi ai i tillë kishte qenë edhe në ato netë, kur unë kisha fjetur si qëngj. Po, kush ma kishte fajin që nuk më zinte gjumi? Këtë nuk munda ta sqaroj, as atë natë dhe as më vonë. Fajtori, duan të thonë, jo përherë dalka në shesh, pavarësisht nga shkalla e fajit.

U ktheva dhe u vërtita herë në një krah e herë në krahun tjetër. Prapë qepallat i ndjeja po aq të lehta, sa edhe një pendë zogu.

Duhet shënuar se në fjetore kish qetësi, po të mos llogaritim këtu ato dhjetra stile gërhimash, që mbushnin anembanë fjetoren. Fillova të dëgjoj stilet

e ndryshme të gërhimave, gjë që në krye më zbavitë. Arrita të numëroj deri në 14 lloje gërhimash. Në një provë tjetër më dolën 19 lloje. Dikush imitonte për mrekulli poçen me fasule kur i mbaron uji, dikush kusinë me qumësht, tjetri kazanin e teshave. Por kjo zbavitje nuk mbajti gjatë dhe nisa të mërzitem.

Isha lodhur tërë ditën dhe duhet të flija, po ja që edhe kjo nevojë kaq personale, pak varej nga unë. Nuk kisha ç'të bëja. Vendosa të rri në pritje. Po që se gjumi do të më vinte, le të urdhëronte. Nuk isha kundër. Po që se nuk do të vinte, aferim i qoftë!

Vura re se edhe Qanua në shtratin tjetër, pranë meje, vërtitej sa në një krah në tjetrin. Për një çast dyshova, se edhe atë nuk e kish zënë gjumi. Për të vënë në provë dyshimin tim, i pëshpërita:

— Qano, përse nuk fle mor Qano?

Ai nuk u përgjegj, gjë që më bindi se flinte.

— As unë s'e di! — foli fare befash dhe u kthye nga unë. U çua në brryl dhe i dha ca përpara trupit.

— Edhe ti s'paske gjumë Zenel? Çfarë ke kështu, mos të dhëmb gjë?

— Mua? Jo! Po ty?

— As mua... Sonte po mendoj. Për çfarë do të pyesësh. Po ja përse. Ditët janë në mbarim. Do të kthehem nga erdhëm. Po si do të bëjmë atje?

Si do të durojmë pa hekurudhën? Kështu mendonte edhe Minella. Bile, ai ish i mendimit se do të që më mirë të ndërtonim një tjetër hekurudhë andej nga Myzeqeja. Shiko ç'i pjell kungulli! Po, Zenel, këtu u mësuam keq. Tjetër jetë. Të tjerë njerëz! Dhe është një jetë që nuk i ndahesh dot. U mësuam keq. Me të vërtetë që u mësuam keq!

— Këtu ke të drejtë, Qano! Po tani hapen shko-

llat. Mua më ka marrë malli për mësuesin, për shokët, edhe për atë bangën time. . .

— Çfarë bange mor fyell? Nuk e ke marrë vesh ti?

— Ç'të marr vesh?

— Që nuk do të kthehesh më te ajo banga jote. Shpresa më tha vetë sot në drekë. Ne të dy do të vemi në Liceun artistik. Ti për pikturë, unë për çfarë të më dalë! Komandantja më thotë se kam vesh për zurna dhe mund të bëhem muzikant. Si ai de, si Zequa që e marrin nëpër dasma e ziafete. «Po pse, ç'u bëra unë shoqja komandante, i thashë, që t'i bie zurnasë si Zequa? Ajo qeshi me mua, më fërkoj flokët dhe më tha: «Jo, ti nuk do të bëhesh ashtu. Ti do të bëhesh artist. Këtu ndryshon puna. Zequa nuk është artist. S'e s'kam dëgjuar t'i flasë njeri kështu. Po ti mor Zenel, do të bëhesh piktor, ë? Do të zografisësh syfete si ato të Rako dembelit me shokë. Zanat i bukur, apo jo?

— More, do e zini gjuhën apo jo, se na latë pa gjumë! — na u kërcënua dikush nga vullnetarët. Megjithëse nuk e morëm vesh se cili që ai gjumash, ne e premë muhabetin.

Tani unë mendoja për Liceun artistik, për syfetet si të Rako dembelit, për zyrnatë e Qanos. . . Isha i sigurtë se edhe Qanua po këto shkonte nëpër mëndje, por nuk ma mbante të flisja me të. M'u kujtua, se njëherë kisha dëgjuar babanë tek thoshte: «Po nuk të zuri gjumi, fut kokën në ujë të ftohtë».

Me këtë mendim të vendosur në kokë, unë e mblodha të fut kokën në ujë. Fillova të vishem dalëngadalë e me përtim.

— Ç'bën ashtu Zenel? — më pyeti Qanua.

— Do të dal jashtë, Qano.

— E çfarë do të bësh jashtë tani?

— Atje ta them, se këtu bëjmë zhurmë.

— Do të vij edhe unë! — dhe sakaq nisi të vishet.

Jashtë qe po ajo natë, po ai qiell me të cilin isha mësuar tërë javën e fundit. Yjet ishin shpërndarë në qiell, po ashtu siç mund të shpërndash me një shkelm, në dhomë, zjarrin e vatrës. Për mendimin tim, ai që kishte vepruar kështu nuk kishte bërë hiç mirë. Yjet ishin kaq të vegjël, kaq të bukur, sa të vinte keq t'i shpërndaje ashtu kuturu nëpër qiell. Përse të mos renditeshin më me kujdes? A nuk do të ngjanin më bukur ashtu? Me siguri!

— Ç'ke ndër mend të bësh tani? — më pyeti Qanua.

— Do të fut kokën në ujë të ftohtë. Është një me një. Bile, ka mundësi të të zërë gjumi, ashtu me kokën të futur në ujë.

— Hajde leshko, hajde. Kush ta paska mbushur kështu mendjen? Po me këtë marifet, as për tri netë nuk të zë gjumi.

— Jo more, nga e di ti?

— Ja, provoje po deshe!

— Do ta provoj që ç'ke me të.

Por nuk arrita ta provoj. Sakaq u dëgjuan hapa dhe pëshpëritje. Në fillim nga frika, pastaj nga kurioziteti, në bëmë pas dhe u fshehëm në të ndarën e fjetores. Kaluan dy hije. Njëri qe i gjatë dhe i hollë, pak i krrusur në shpatulla. Ai më ngjante me Dragen. Të dytin nuk e dalloja dot.

— Te ura! E qartë? — pyeti ai që më ngjante me Dragen.

— Po, e qartë, te ura! — u përgjegj tjetri. Pাপritur, trupin ma përshkoi një drithmë dhe kapa padashje, krahun e Qanos. Edhe ai, po ashtu, kishte kapur krahun tim.

«Te ura!» — m'u ngulit mua. Ç'qe pra kjo? Çfarë donin aty, ç'punë kishin ata me urën në këtë orë? Ura nuk qe vend për të fjetur. As për takime natën. Të thoje se do të punonin në këtë orë, as kjo s'hahej, pasi ura edhe pak e po mbaronte. Pastaj, nuk ngjanin me ata që e bëjnë natën ditë. . . Bile, ata s'kishin më punë te ura. As Drage dhe as ai i panjohuri tjetër.

— Zenel, ura!

— Ç'dreqin kërkojnë ata te ura në këtë orë? — pyeta Qanon. — Nuk më ngjajnë si ata që duan të thyejnë kazmën, kur të tjerët flenë. Si thua ti?

— Unë? Unë them se këtu ç'qoz luan. Të zgjojmë Pajon. Edhe ndonjë tjetër.

— Po, të zgjojmë Pajon.

Veçse nuk qe aq lehtë të zgjoje Pajon. Ashtu siç kishte punën, ashtu kishte edhe gjumin. Njëri nga koka, tjetri nga këmbët, po e luanim aq fort sa që krevati u zgjua përpara të zotit. Pastaj, ne i hoqëm bataniet. Ai kishte rënë përmbys. E kapëm të dy për beli, duke dashur ta kthenim në shpatulla. Kështu me siguri do të zgjohej.

— Po ç'dreqin keni me mua xhanëm? Unë nuk jam Pajua! — dhe ai u ngrit shesh mbi krevat. Ai me të vërtetë nuk qe Pajua.

— Ç'djall millet qënki ju? Përse nuk i lini të tjerët të flenë? Apo pak jemi lodhur nga puna? Pa hajt, qërohuni nga sytë se po u ngrita do t'u shqep në dru.

— Na fal shok, se nuk deshëm! — ja ktheu atij Qanua.

Ai me të vërtetë nuk ishte Pajua. Vetëm atëhere vumë re se krevati i tim vëllai qe bosh. Me sa duket prandaj qemë gabuar.

Si të bënim tani? Ku do të qe Pajua? Nga ta kërkonim?

Një gjë ishte e qartë. Pajua duhej gjetur patjetër. Po si dhe ku? Dolëm jashtë për ta menduar më mirë këtë hall. Vetvetiu bëme nga ura. Ashtu, dalëngadalë dhe pa u marrë vesh që më përpara me njëri-tjetrin ne po i afroheshim urës. Dhe asnjë nuk donte të fliste. Unë vetë nuk flisja, pasi nuk dija ç'të thosha. Se përse nuk fliste Qanua, këtë s'e merrja dot me mend.

Shkelnim pa i ndjerë hapat tona... Po ja, m'u duk sikur përpara nesh, po ecte Pajua. Ashtu, pak i krrusur dhe i heshtur, tamam si ne të dy. Pra, ai paska rënë vetë në gjurmë.

Atë çast më gufoi zëmra nga gëzimi. Pas pak Pajua nuk e di pse ktheu kokën prapa, na dalloi dhe bëri me dorë një shenjë të cilën ne nuk e kuptuam dot mirë: të ktheheshim apo ta ndiqnim?

Duke përfituar nga kjo paqartësi, ne vazhduam në heshtje rrugën tonë. Fundi, ne kishim të drejtë të mirrnim vesh se ç'po kurdisej këtu në hekurudhë! A nuk ishim edhe ne vullnetarë si gjithë të tjerët? A nuk kishim rënë vetë në këto gjurmë të dyshimta? Ç'të drejtë kishte Pajua të na kthente prapa?

Ecnim rreth dhjetë hapa larg Pajos, pa guxuar të flisnim, apo të shkelnim lirisht me tërë shputën e këmbës.

Ndërkohë shikonim edhe rreth e rrotull, me shpresë se syri mund të na zinte ndonjë gjë interesante. Pajua ecte pa zhurmë, por me hap të gjatë dhe të vendosur, të rëndë. Dukej sikur ai në çdo hap dikë shtypte me ato opingat e tij shollëtrasha.

Afër urës, Pajua qëndroi dhe vuri veshin në përgjim. Dashur pa dashur, të njëjtën gjë bëme edhe ne.

Por veshët tonë ishin më larg nga ata të Pajos, kështu që s'morëm vesh gjë.

Zemra më rrihte si atëhere kur mësuesi më ngrinte pikërisht atëhere kur shkoja i papregatitur. Po se si i binte hilesë mësuesi në këtë mes, hajde e merre vesh!

Më në fund, Pajua bëri përpara me hapat që s'i ndiheshin. Vetëkuptohet, të njëjtën gjë bëmë edhe ne. Kur arritëm te barraka pranë urës, qëndruam ca nga frika, ca nga që nuk dallohej gjë. Ura i ngjante një pusi të kthyer në brinjë. Pajua dukej si një gjë e murme, që edhe pak e do të shkrihej me errësirën. Pa pritur buçiti një zë:

— Mos lëviz se t'i hodha trutë në erë! — dhe papritur pranë veshit tim krisi një pushkë. Edhe sikur plumbi të kishte dalë nga veshi im, nuk do të kishte bërë aq zhurmë, dhe veshët e mi nuk do të buçisnin si nga gjëmimi i një aeroplani bombardues.

Për një çast pata përshtypjen se llapa e veshit tim kish rënë për tokë. Të themi atë që është, si unë si Qanua, kishim rënë për tokë sapo u dëgjua krisma, megjithëse nuk na urdhëroi njeri për këtë.

Njëherë mendova se duhej kërkuar përdhe llapa e veshit tim. Ndoshta, prandaj dora më vajti vetëvetiu te veshi dhe u qetësova, meqë llapa ishte në vend.

Në krye të urës buçiti mbytur një goditje që më gëzoi. Më gëzoi, pse e dija mirë që kjo ishte dora e Pajos. Vetëm ai dinte të godiste ashtu. E kisha provuar vetë.

U ngritëm dhe bëmë përpara. Qanua nuk më ndahej. Mora në duar një goxha gur, duke menduar se do të më hynte në punë. Por, nuk qe nevoja.

Pajua e kish vënë poshtë tjetrin dhe i kishte ngjeshur gjurin në bark.

— Na kërmë! — dhe Pajua i ngjeshi një turijve.
— Kërmë do të të marr shpirtin. Atë shpirt prej qeni,
gjidi kriminel! — dhe Pajua ja veshi prapë.

Unë e besoja lehtë se Pajua, me ato duar, mund
t'ja merrte shpirtin sa të hapje e të mbyllje sytë.
Por ai nuk ja mori shpirtin. Se përse, mua nuk ma
mbante ta pyesja.

Por nuk ishte kjo e gjitha. Thellë, nga ana tje-
tër e urës, vinin të tjerë zëra, të tjerë zhurma. Ishte
një turmë e tërë që po na afrohej. Pas pak dalluam
Zyberin, Shpresën dhe disa vullnetarë. Edhe ata ki-
shin bërë zap dy banditë! Nuk di pse, po këta njerëz,
duke filluar nga Pajua, Shpresa, Zyberi, Qaniu e të
tjerë, më dukeshin më të afërt, më të dashur: një
familje, një gjak.

Përpara nësh tre kriminelë dhe nata! I shikoja
dhe më vinte të haja veten me dhëmbë. Përse? Ja
pse! Se të tre këta, deri tani kishin qenë me ne dhe
midis nesh. Si pra, nuk i pata vënë re që më përpara
ato fytyra aq të poshtra? Se mjaftonte t'u hidhje një
shikim dhe menjëherë e merrje me mend se çfarë
malli qenë! Pse pra nuk e kisha kuptuar me kohë kaq
gjë?

Vetëm tani vura re se Zyberi kish një të çarë nga
buza e deri te veshi i djathtë. Gjaku i kish mbuluar
gushën, po atij aq i bënte. Sikur nuk e ndjente fare.

— Maskarenjtë! — shfryu ai. — Na plasën! Ki-
shim dhjetë ditë që po i ruanim. Hap pas hapi. Boll na
e drodhën bishtin si të dhelpres. Erdhi sahati që t'i
lajmë hesapet një për një me ta.

— Bëni mënjane! — na urdhëroi Pajua. — Bëni
mënjane dhe u hapni rrugën qenve. Nisuni! Dhe,
kini mëndjen. Pak po e lojtët bishtin, plumbin e kini
pas koke.

— Balash, deshe të na hidhje në erë, ë? Kërmë do të bëhesh, kërmë që s'do të të hanë as korbat. Se ata nuk e hanë kërmën tuaj.

Pajua, në njerën dorë mbante revolverin, kurse në dorën tjetër mbante diçka që ne s'e dallonim. Por e merrnim me mënd se duhej të qe ndonjë gjë tjetër me zarar. T'i afroheshim nuk na e mbante, pasi Pajua qe nevrikosur si rrallëherë. Por, ai e vuri re kuresh-tjen tonë dhe na tha:

— Çfarë shikoni? Minë me sahat është. Që të na hidhnin në erë! Dhe harruan, se ai që i bën gropën tjetrit, bie vetë brenda.

Pajua kishte të drejtë. Ashtu qe: kush i bën gropën tjetrit, bie vetë brënda.

Në çast rreth e rrotull u mblodhën mjaft njerëz.

— Spiunë. Kriminelë! Do t'ua shtypim kokën si të gjarpërit!

— Ballista, gjermanë, të shitur për lëpushka!

— Fashistë, horra, zagarë!

— Zogista, zervista!

Njerëzit këtu, të shanin si mundnin.

— Mjaft! Ç'është kështu? — uturiu Pajua.

— Aheng! — u përgjegj dikush. Papritur u shfaq aty edhe Minella, sikur ai të qe mangut.

Keq ishte katandisur edhe njeri nga ata që kishte kapur Zyberi me shokë. Hundën, ose e kish vetiu të shtypur, ose do të kish ngrënë badiava ndonjë grusht kovaçi. Diçka e tillë duhej t'i kish ngjarë edhe me ballin. Këtu goditja duhej të qe bërë në kokë nga poshtë-lart, meqë nuk i kishte mbetur as dy gisht ballë.

— Minë me sahat! — sqaroi Pajua, duke na treguar ç'mbante në dorë.

— Si? Minë me sahat? — pyeti dikush. — Po edhe ky krushku ynë, me sahat e kishte.

— Qysh? — pyeti Pajua dhe u gjend përballë ballështypurit. — Në ç'orë që kurdisur ajo minë?

— Për në orën tetë të sabahut, vëlla! — u pergjegj Zyberi. — Kurse unë e ha sillën më nëntë sahati. Pra, do të vija zorrë zbrazur në atë botë. Keq e mos më keq! A nuk është padrejtësi kjo? Të vesh zorrë-zbrazur?

— Po, edhe kjo për në orën tetë paska qenë! — tha Pajua.

— Folë, ku i kini vënë të tjerat? — pyeti Pajua ballështypurin dhe i përmbloodhi një grusht tjetër turijve.

— Amani, bre se ma morët shpirtin?

— Pse, ke shpirt ti? Folë, të tjerat ku i kini?

Folë se ta mora shpirtin.

Për mendimin tim, ai ballështypuri duhej të fliste, me që Pajua nuk e kishte fort të vështirë për ta ngordhur.

— Të tjera ka, po unë nuk i di. Pyetni teknikun.

— Hë, atë kurrizon shalëgjatë? — dhe menjëherë u kuptua organizatori.

— Po, atë!

— Të shiturin! Kërma! Përpara!

Pështjellimi u bë akoma më i madh. Ca flitnin, të tjerë pyesnin, të tjerë sqaronin aq bukur, sa të thoshje se bota nuk duhej të kishte ndonjë gjë për të sqaruar më.

Shpresa m'u afrua dhe më hodhi dorën supeve.

— Po ju të tre, pse nuk kini fjetur?

— Përderisa nuk flenë ballistët, as ne nuk flemë.

Apo të na hedhin në erë me gjithë krevate! — ja ktheu Minella me një frymë. Ajo qeshi, duke më

trubulluar, pasi nuk e kuptoja përse mund të qeshej në këtë situatë kaq serioze.

— Ata nuk janë ballistë, Minella.

— Si nuk qenkan ballistë? Qysh qenka kjo?

— Ata janë sabotatorë, armiq, të shitur!

Edhe unë nuk isha i qartë, po nuk pyeta nga frika se mos këpusja padashje ndonjë të papjekur. A nuk qe po ajo, si ballistë, si armiq, si të shitur?

Turma bëri më tutje, kurse Shpresa ne të treve na ktheu për në fjetore.

— Tani ju kolopuçër duhet të bëni nani-nani. Ju e bëtë detyrën tuaj dhe nesër do t'u lavdërojmë përpara vullnetarëve. Ti Zenel, mendo t'i qëndisësh pak këta krushqit. Po nesër ama, kurse tani merrja me gjumë. Hajde, natën e mirë tani dhe pafshi ëndërra të bukura.

— Po a nuk kaloi nata, shoqja komandante?

— Bah, kini dhe pesë orë për të fjetur.

— Ashtu mbase, po neve nuk na flihet! — tha Qanua.

— Hajde, hajde, lerini këto. Duhet të çlodheni se nesër norma nuk bëhet vetë! Ajo na vuri përpara dhe na futi në fjetore.

— Natën e mirë bëfshi!

— Natën e mirë shoqja komandante.

Unë u preka disi, pasi kisha dëshirë të shikoja se ç'do të bëhej më tej me sabotatorët. Por urdhërin e komandantes nuk desha ta thyej. Ramë në shtrat.

— Si thua ti Zenel, çfarë do t'u bëjnë atyre?

— Unë them se do t'i varin!

— Jo more?

— E pse jo? Apo nuk e kanë hakë! Po sikur të mos qenë kapur, a nuk do të na kishin hedhur në erë?

— Nuk e ke keq ti, ashtu duhet, në litar!

— Po po, në litar, në litar!

NË SULM

*Puna me sulm dhe ngjarje të tjera po
kaq me peshë.*

Kapja e sabotatorëve ishte ngjarja më e madhe dhe më e bujshme në hekurudhë, qëkurse kishim ardhur ne. Kudo flitej për këtë. Edhe në trase, edhe në tunel, edhe te ura. Po ky muhabet në mencë, në kuzhinë, në fjetore.

Gjithkush e shprehte revoltën apo mendimin e tij ashtu si mundte. Fjala vjen, kuzhinieri Shaqo, shtrëngoi fort hanxharin në duar dhe tha: «Atyne u duhet këput kaptina bash me këtë hanxhar!»

Unë pak a shumë bashkohesha me këtë mendim të drejtë të Shaqos. Por kuptohet, një gjë të tillë ai nuk e bëri dot. Mendimi i përgjithshëm nuk qe aspak në favor të Shaqos, që faqezezve t'u pritej koka me hanxharin e kuzhinës. Këtu punët duhej të kryheshin me mjete të tjera.

Disa thoshnin «Në litar!» Disa, «Në hu»! Të tjerët «T'i djegim me benzinë»! Të gjitha këto qenë dëshira fisnike, por asnjëra nuk po realizohej, ndoshta nga që Shpresa tha:

— Diktatura e proletariatit ka ligjet e veta!

Fjalët e Shpresës qenë si një kapak i madh e i rëndë, sa që nuk gjëndej burrë ta luante nga vendi. Bukur fort! Diktatura e proletariatit le ta bënte të sajën! Pra, ata faqezesh duhej t'i binin më gjunjë diktaturës së proletariatit, e cila, nuk di pse s'na linte t'i shkonim në hu, apo t'i digjnim me benzinë.

Mua dhe Qanon na nxorën përpara vullnetarëve të rreshtuar dhe na lavdëruan për vigjilencë të lartë revolucionare. Na thanë edhe plot fjalë të tjera të mira, por që unë nuk i mbajta mend, se isha tepër i emocionuar.

Nuk është keq, sikur të kihet parasysh fakti që, kur tjetri është i emocionuar, nuk duhet folur shumë për të. Se ai shumë pak ka për të marrë vesh!

Atë kohë unë nuk dëshiroja gjë tjetër, veçse t'ja mbathja nga sytë këmbët e të humbisja diku aty nga rreshtat e fundit. Aty pastaj, do të përfitoja si më i vogli, do të fshihesha pas një vullnetari trupgjatë dhe nuk do të më vërente njeri si skuqesha. Por këtu nuk kisha nga t'ja mbaja. Vullnetarët i kisha përballë të gjithë! Të gjithë m'i kishin ngulur sytë dhe unë nuk kisha nga t'u vidhesha atyre shikimeve. Dhe vetëm skuqesha. Aq shumë skuqesha, sa më dukej se nuk po më kullonte djersë, po gjak i valë.

Më në fund shpëtova nga kjo torturë e paparë, me shpresë se nuk do të përsëritej më. Pastaj, mora letër vizatimi dhe fillova të bëj karikaturat e atyre të poshtërve.

Njërit i bëra një gjarpër në vend të gjuhës, të dytin duke vjellë mina me saha dhe të tretin me një torbë me para të huaja në vënd të kokës.

Stenda e gazetës së murit u mbush plot, sapo Shpresa i vuri aty vizatimet e mia. Kur u nisëm për në trase, binte shi. Dhe ne punuam nëpër shi. Ujët ku-

llonte nëpër të gjitha ulluqet e trupit, por kjo nuk ishte ndonjë gjë e re për ne vullnetarët prandaj nuk na bënte dhe aq përshtypje.

Me këtë rast pata mundësinë të konstatoj se trupi ynë përshkohet nga një sistem aq i përsosur ulluqesh, sa që edhe arkitektët më të mirë kanë mundësi të përfitojnë diçka.

— E përse ta prishim terezinë? — thoshte Zyberi. — Bie shi? Po punë e madhe! Do të bjerë sa do të bjerë e pastaj do të lodhet. Pastaj do të dalë die-lli dhe ne do të thahemi. Do të thahemi e do të na marrë malli për shi. Kështu së paku nuk na merr as etja. Fëmijët s'kanë nevojë të na sjellin ujë, kështu që ata do të punojnë me ne dhe norma do të tejkalohet. Ja cilat janë disa nga të mirat e shiut.

Mirë e kishte Zyberi deri këtu. Po sa për atë, ama, sa për atë punën e normës që do të tejkalohet, kjo më dukej pesë me hiç.

Binte shumë shi. Në këto rrethana duhet theksuar se shiu ishte kundër nesh. Dhe njëkohësisht kundër realizimit të normës. Pra, shiu nuk ishte aleati ynë!

Më keq nga të gjithë e kishin ata me karro dore. Keq në të ngarkuar, keq në të shkarkuar, e akoma më keq në të ecur. Karroca nuk shtyhej. Ec e ngec vinte puna.

Qielli më ngjante si një kusi e përmbysur me trahana. Por mbi ne, në vend të trahanasë binte shi. Nuk di përse m'u kujtua trahanaja... Ndoshta më kishte marrë malli për të. Për trahanënë, për macen larushe, për Balon trim... Edhe atje duhet të bjerë shi si këtu, apo jo?

C'bëhet vallë andej nga katundi? Babai me siguri turfullon e shan dikë. Ose ja ka shtruar me raki. Ku ta dish ç'këput për ne: «Hy, qafën të thyejnë, hara-

mët! Fundi, fëmija prandaj lind që të mos plakët në çitjane të së jëmës. Më mirë ta kërrej në vetë bukën e gojës, se ashtu do ja dinë kimetin. . . »

«Aq, adha, se i rëndoj zotit me këto llafe!» — ja pret me siguri nëna.

«Çfarë zoti, moj shënjerake, po rrih atë dhallë aty e mos u ndiej. Ç'hyn zoti këtu? Ata ikën. Bojën mos ua pafsha! Po i mori uria, këtu do të kthehen ta thyejnë kokën. Po nuk i mori, aq më mirë! Përse të bëhemi merak? Ata ikën. Kjo do të thotë se ata nuk qenë fare merhuma. Bënë si bënë, po bukën e gojës e nxuarën.

Pa tjetër diçka e tillë bisedohej atje larg në katund. Këtë bisedë unë ose e kisha dëgjuar dikur, ose e kisha parë në ëndërr.

Pothuajse gjithmonë ngjarjet e largëta i kam ngatërruar me ëndërrat e afërta. Se si bëhet ky ngatërrim, as që arrij ta marr me mend. Po ja që bëhet!

Karroca e Shpresës ka ngecur përsëri. Këtë s'kam si ta ngatërroj as me ndonjë ëndërr dhe as me ndonjë ngjarje të veçantë, me që karroca qëndron si e gozduar përpara meje dhe s'do që s'do të shkulet nga vendi. Ajo mbledh të gjitha fuqitë po asgjë.

Karroca luan nga vendi dhe niset, por pas pak ngec përsëri. Dhe Shpresa përsëri e shtyn. Po edhe për ta shkarkuar nuk është më e lehtë.

Balta ngjitet përbrënda dërrasave të karrocës tamam sikur të qe tutkall. Kjo nuk i jep dorë aspak. Çfarë balte qënka kjo? Edhe pas drurit edhe pas hekurit ngjitet po njëlloj! Nuk është e drejtë hiç! E kruan me lopatë. Po balta ngjitet edhe pas lopatës.

— Zenë, merr dhe Qanon dhe vrapo në kaponon! — urdhëron Shpresa.

— Pse, ç'ka ngjarë? — pyes unë i çuditur.

— Ka ngjarë ajo, që punën do ta lëmë se nuk punohet më. Ujët po na mbyt.

— Po ne dimë not, shoqja komandante.

— Leri shakatë, Zenel, dhe nisu.

— Bashkë do të nisemi.

— Unë urdhëroj të nisesh përpara!

— Më fal, shoqja komandante, por ky lloj urdhëri nuk mund të zbatohet, pasi është i padrejtë. E shikon si janë ngatërruar punët? Bie shi! Balta ngjitet. Norma në vend. Unë nuk i zbatoj urdhërat. Dhe jo vetëm unë.

— Zenel, do të të dënoj!

— Këto janë kërcënime. Dënimi do të qe i padrejtë, kurse ti kurrë s'ke bërë padrejtësira. Ti je zemërmirë!

— Hej dreq, ç'më polli me këta!

...Po, komandante! Ka mjaft të dhëna që të jetë ashtu si thua ti. Vetëm mos na ndaj nga shokët. Të tjerat rregullohen. Ti kaq gjë duhet ta kuptosh vetë, se je komandante. Një komandante e mirë! S'ke përse të na ndash nga shokët.

Vërtet jemi të vegjël, po sedër kemi. Se sedra nuk matet as me gjatësinë e shtatit dhe as me numrin e viteve...

Tani shtyj unë karrocën dhe ja nis:

Ke marrë pushkën ke dalë për liri, vatan...

Menjëherë këngën e pasuan plot të tjerë, sikur të gjithë të mos pritnin veç këtë. Puna mori vrull. Provova kështu atë ditë, se po të këndosh duke shtyrë karrocën, nuk të lag shiu. Kështu që mund të dalin të tepërta shumë ombrella.

— Alarm! — u dëgjua pa pritur Pajua.

— Ç'është? — pyeti Shpresa.

— Është ajo, që me normën jemi keq, jemi pas. Duhet të shkundemi. Ndryshe flamuri na lë pëndët, shoqja Shpresa. Si do të bëjmë?

— Si do të bëjmë? Pse pyetje është kjo? Me sulm! Ja këtë do të bëjmë.

Shokë vullnetarë, me normën jemi prapa. Urdhëri është, në sulm!

— Urraaa... buçitën përnjëherë një lumë zërash dhe sakaq u përmbys çdo gjë. Unë s'kisha pse të çuditesha që karroca ime nuk ngecte më, përndryshe, ç'loj sulmi do të qe ky? Çuditesha vetëm se si arriti ta kuptojë këtë edhe balta argjilore, që ne u hodhëm në sulm dhe që nuk po na gëlltiste më rrotën e karrocës.

Pajon nuk bën ta mburr se e kam vëlla. Dhe, të mburrë vëllai vëllanë, më duket disi e pahijshme. Por edhe që t'ja ha hakun nuk bën. Kjo do të qe padrejtësi dhe mua do të më vriste ndërgjegja. Ai punonte si ka. Jo si ka, po si buall. Se ai qe zhytur në baltë. Mund ta njihja, që ishte Pajua vetëm unë, vëllai i tij. Tjetërkush vështirë se do ja delte mbanë kësaj pune.

Komandantja përpiquej të mos mbetej prapa. po edhe asaj nuk dua t'ja ha hakun, ishte më e zgjuar dhe më e ditur nga Pajua, por jo më e fortë. Si të thuash, aty e aty vinin!

Në gjithatë vrull, në atë rrebesh, mua më tepër më pengonte jo shiu, por hunda. Hunda, se aty kullonte ujët dhe mua më duhej ta fshija orë e çast. Kjo gjë më pengonte, pasi më hante shumë kohë.

Shkencërisht dhe praktikisht nuk ka se si edhe të shtysh karrocën edhe të fshish hundën. O njërën, o tjetrën. Dhe unë vendosa pa ngurruar: njërën! Karrocën! Hundën e lashë të bëjë të sajën, pa ku të dilte le të dilte.

Prisja derisa ujët të më binte mbi buzë dhe atëhere turfulloja, ashtu siç bën kur del që poshtë ujët. Kështu shpëtova nga ky lloj telashi.

Trupi më ngjante me një sfyngjer të fryrë, plot e përplot me ujë. Më dukej se edhe barku i zbrazur më qe mbushur me ujë.

Që të dilte jashtë meje i gjithë ky ujë, duhej që patjetër, dikush të më shtrydhte mirë. Përndryshe unë kurrë nuk do të arrija të thahesha ndonjëherë.

Rruga u shndërrua në gjol. Atëherë unë i hoqa opingat, të cilat në këtë situatë nuk kishin më kuptim. Me këmbët e zbathura çaja lart tepërtej.

Kur ra çanga më erdhi disi keq, pasi më dukej se nuk isha lodhur sa ditët e tjera. Kjo më ngjante me një padrejtësi që i kisha bërë vetes dhe shokëve, gjë që më lëndonte, aq sa nuk më hahej as buka.

Vura të dy opingat në bisht të lopatës dhe në mes të të tjerëve u nisa.

— Shoqja komandante, në qoftë se nuk e kemi realizuar normën, them të ngrihemi natën.

— Pusho more — ma priti Pajua. Dashke të ngrihesh natën ti. S'ka nevojë. Punët e ditës nuk lihen për natën.

Mua nuk më pëlqeu, jo vetëm pse u përgjegj në vend të komandantes, po edhe për ato që këputi. Por s'ma mbante t'ja ktheja, pasi ai nuk ta përtonte. Kështu që detyrimisht, përtova unë.

Shiu kishte pushuar, po se kur, askush nuk e pati mendjen. Bile, kjo m'u duk disi jo e zakonshme. Ai shi i parreshtur sikur na mbulonte më së miri e nuk lageshim. Kurse tani e ndjenim veten krejt të lagur dhe të ftohtë.

Supën me makarona unë në të vërtetë e piva, se aty nuk kishte asgjë për të përtypur. Pas një lodhje-

je të tillë, mund të haje pa përtypur jo vetëm makaronat e ziera, po edhe bathët e thara. Nuk ja vlente ta humbisje kohën kot. Dhe as të përtypeshe kot. Sa për fasulet edhe ato nuk qe nevoja t'i përtypje. E dinin për bukuri rrugën dhe detyrën e tyre, pothuaj symbyllur. Këto qenë lehtësirat e të ngrënit pas asaj pune të lodhshme.

Kisha dëshirë të shtrihesha, po këtë gjë nuk e bëja dot. Së pari, ora nuk kishte vajtur akoma dhe, së dyti, se askush nuk po shtrihej. Dhe qe një punë, të cilën unë nuk doja ta bëja i pari...

KOMANDANTI

*Ne takohemi me Komandantin! Hekurudha
oshëtin nga hareja!*

Puna me sulm bëri që ne flamurin nuk e lëshuam nga dora. Këtë gëzim të madh, unë si përhera doja ta ndaja me komandanten time. Pa të, asgjë nuk më gëzonte. Asgjë nuk më shijonte. Dhe asgjë nuk ma mbushte syrin.

Nga ana tjetër më dukej se edhe atë e mundonte e njëjta dëshirë. Pra, e kishim të lehtë për t'u marrë vesh.

— Shoqja Shpresa. Sa bukur është kështu! Gjithmonë fitimtarë! Do të desha që flamurin ta mbajmë ne dhe të mos e lëshojmë asnjëherë nga dora.

— Po Zenel! Përpiqu që flamurin të mos e lëshosh asnjëherë nga dora. Kjo ka për të qënë një punë e vështirë. Kërkon shumë mund dhe sakrifica, por ne, njerëzit e rinj, do t'i marrim në sy të gjitha.

— E përse kërkoja kaq mund dhe sakrifica, shoqja komandante?

— Është ende herët për ta kuptuar mirë këtë. Po ashtu edhe unë e kam të vështirë të ta shpjegoj. Më mirë po e bëjmë kështu: me kalimin e kohës disa gjëra do të t'i mësoj vetë jeta, disa të tjera do të t'i them unë, disa të tjerët. . . Por, më tepër këtu kanë rëndësi ato që të mëson vetë jeta.

— E ku di unë? Por, meqë ti, shoqja komandante thua kështu, s'ka se si të jetë ndryshe. Pra, u morëm vesh. Nga puna me sulm dhe nga flamuri nuk do të heqim dorë asnjëherë në jetë. Kështu, apo jo?

— Po Zenel! Kështu. Asnjëherë nuk do të prapsemi.

Kjo ishte një marrëveshje e madhe dhe burrërore. Unë do ta mbaja fjalën. Aq më tepër, komandantja ime.

Atë kohë pashë se po afrohej Minella. Ai dukej i menduar, po se për ç'arësye, këtë nuk arrita ta marr me mend. Se nuk është aq lehtë, sa ç'duket, të marrësh me mend çfarë i shkrep e çfarë i ndez tjetrit në kokë. Sidomos, kur ka një kokë si të Minellës!

Minella e kishte si me mëdyshje, të kthehej apo të mos kthehej nga ne, por Shpresa i dha zemër.

— Eja Minella, eja. Çfarë ke kështu?

— Ç'të kem, shoqja komandante. Ja, po numëroj ditët që shkurtohen.

— Të ka marrë malli për shtëpinë?

— Doemos! Por puna nuk qëndron aty! Në shtëpi do të vemi dhe do të çmallemi. Aty e kemi. Po hekurudhën, ku do ta gjejmë prapë?

— Ç'flet kështu Minella? E kush të tha, se kjo ka për të qenë hekurudha e fundit?

— Këtë nuk ma ka thënë njeri, por e them unë. Se ja, ta zëmë, do të ketë edhe një hekurudhë tjetër. Ta zëmë prapë, se do të na lënë të vemi edhe atje vullnetarë. Po ku do të gjëndeshin atje, në atë hekurudhën tjetër, njerëz kaq të dashur dhe kaq të mirë si këtu?

Ama, ç'prrallis kështu edhe ky Minella! E si u

dashka të bëhemi prapë bashkë kështu siç jemi këtu?
Ku ka të ngjarë një gjë e tillë?

Shpresa, me sa duket, mendonte kështu si unë. Ajo e sqaroi duke vënë buzën në gaz... Se nuk do të ketë edhe një hekurudhë tjetër, po shumë të tjera. Se askush nuk do të ndalonte për të vajtur atje vullnetar. Se njerëz të dashur e të mirë kishte në çdo kënd të atdheut. Sidomos midis vullnetarëve.

Minella tundte kokën si një njeri që bindet me dyshim. Kjo gjë desh më nevríkosi, pasi një komandanteje si Shpresa, duhej t'i bindeshe pa një pa dy, dhe jo ashtu, mëdyshazi e dalëngadalë, si Minella i ngathët. Jo duke tundur kokën me përtesë, po duke i thënë vetëm, «Si urdhëron», e duke u hedhur në zjarr për të.

— Kam menduar edhe një gjë tjetër, shoqja komandante! — tha ai po aq i ngadaltë e i menduar.

— Pa hë Minella, na e trego.

— Po ja, atje në katund ne nuk hamë si këtu, gjithkush në enën e tij. Ne hamë në një sahan. Do të qe më mirë që gjithkush të hante në enën e tij. Se njëri ha shpejt, tjetri ngadalë. Në këto raste, ai që ha ngadalë mbetet me gisht në gojë. E kam provuar vetë atë punë. Njeri e ka gojën të madhe, tjetri të vogël. Pastaj, ka edhe njerëz me dhëmb të prishur, ose edhe pa dhëmbë fare. Njeri e do të ftohtë, tjetri të ngrohtë. Mirëpo, po t'i them babës, se gjithkush duhet të hajë në një enë më vete, ka shumë të ngjarë që të mos dal gjë. Ose, e pakta, ka të ngjarë që të hash ndonjë dackë hundëve. Se tek ne, i vogli s'bën kurrë ta mësojë të madhin.

— Po si ke menduar t'ja dalësh kësaj?

— Ja si them unë. Kur të vete ditët e para nuk do të bëj zë. Pastaj do të marr Zenelin dhe ndonjë

shok tjetër, për darkë. Kur të shtrohet buka, unë do të tregoj se si hanim në hekurudhë dhe me marifet do ta hedh fjalën që edhe ne të veprojmë po ashtu. Sado që të nxehet baba, në sy të miqve nuk do ta bëjë veten, e njoh mirë unë atë.

Pastaj, Zeneli do ta ngasë dhe më thellë këtë muhabet. Merret me mend, se Zeneli do të flasë më lirshëm dhe më hapur nga unë. Me mysafirin qëndron ndryshe puna. Kur të kenë ikur të ftuarit, babës do t'i ketë rënë inati, meqë nuk e mban shumë. Po kështu do të bëjë Zeneli më vonë në shtëpinë e tij. E kështu me radhë te çdo shok.

— Nuk e ke menduar keq, Minella!

Vërtet, nuk e kishte menduar keq! Përse diçka e tillë nuk më kishte shkuar edhe mua në mendje? Apo se s'qe e thënë që të mirrja edhe një lëvdatë më shumë nga komandantja ime? I ngathët ky Minella, i ngadaltë, po ja ç'vete i pjell koka! Të ka faj?

— Kolopuçër, a e mirrni me mend se çfarë lajmi do t'u jap? — na pyeti papritur komandantja.

E nga ta merrim ne me mend, se çfarë lajmi mund të na jipte ajo? Pak lajme mund të jepen?

— Së shpejti te ne do të vijë Komandanti!

— Si? — pyetëm krejt me një zë dhe me të njëjtën shkallë habie, duke u ngritur vetëvetiu në këmbë të dy.

— Po! Dhe kjo do të jetë ngjarja më e madhe, dita më e shënuar në hekurudhën tonë.

— Dhe Komandanti do të takohet me ne?

— Po, ai për atë punë vjen!

— Mirë, po a lejohet ta përqafosh Komandantin?

— Si duhet folur me të?

Ne pothuaj e mbytëm me pyetje Shpresën dhe

ajo nuk dinte se çfarë të shkoqiste më përpara. Pa ç'pa e la fare atë punë.

— Shoqja Shpresa, a e njeh ti Komandantin? Desha të them, a e ke takuar ndonjëherë?

— Jo! — u përgjegj ajo dhe sytë i shkëlqenin.

Do të vinte Komandanti! Nuk mbaj mend të kem ëndërruar diçka tjetër më shumë, se sa ta shikoja njëherë Komandantin. Dhe ja, ai do të vinte vetë. Ishim aq të gëzuar, aq i madh na dukej ky nder, sikur Komandanti të vinte këtu për të takuar mua, Minellën, Qanon dhe Shpresën.

Punonim përmbi forcat tona, po as që na shkonte ndër mend se qemë lodhur. Do të vinte Komandanti! E si mund të lodheshe kur mendoje këtë?

Të vinte pra, të vinte dhe të shikonte vetë se sa shumë e donim dhe sa shumë punonim këtu!

Komandantin e pritnim të gjithë me dashuri dhe me padurim.

...Dhe Komandanti erdhi... Festë e vërtetë në hekurudhë! Festë e madhe. Çfarë feste, more? Dasmë nuk thua? Brohoritje, këngë, valle, marshe, lotë gëzimi, lotë njerëzish të lumtur!

Ai u bashkua, u bë një me vullnetarët. Unë rrija me Shpresën, me Pajon, Qanon dhe Minellën. Kishim shumë dëshirë të afroheshim sa më pranë Komandantit, po në atë grumbull ne nuk bënim dot çap. Pa pritur, ai po afrohej vetë.

Ishte po ai që me aq shumë mirënjohje shikonim ne nëpër portrete të ndryshme. Ai vinte drejt nesh! Mos ishim gjë në ëndërr? Ai vinte të na takonte me buzën në gaz!

Mos vallë kështu më dukej mua? Mos po shikoja ndonjë ëndërr të bukur? Por jo! Përpara meje qëndronte Komandanti ynë i dashur. Buzëgaz! Jo, tani

isha unë që qëndroja i hutuar përpara tij. I hutuar por plot ngazëllim në zemër. . .

As që e kisha përfytyruar ndryshe! Gjaku më mbuloi krejt dhe e ndjeva të nxehtit deri në veshë.

Ai po fliste midis nesh! I gjatë, i qeshur, i afërt! Na dukej sikur mes nesh vezullonte diçka madhështore, diçka përmbi atë që pritnim. . .

Atë çast nuk do dëshëroja gjë tjetër, veç të kisha mundësinë ta merrja për qafe. Dhe një gjë të tillë ai e bëri vetë.

Unë u drodha në atë përçafim të madh. U drodha dhe u ngjita si kulpëri pas lisit madhështor. Dhe nuk ndahesha dot nga ai përçafim. . .

Nuk e kuptoja mirë, ose unë s'e lëshoja dot Komandantin ose ai nuk po më lëshonte mua!

Prapë nuk e kuptoja, ai ishte më i gëzuar që u takua me ne, apo ne ishim më të gëzuar që u takuam me të?

Ai tha se i donte shumë pionierët. Pionierët që kish takuar në male, në çeta, në luftën partizane, në brigada, e deri këtu, në punën e madhe ndërtimore.

Ai i donte shumë pionierët vullnetarë.

— Po ti atje? — dhe Komandanti kërkoi me sy Shpresën, që donte të fshihej pas Pajos. Po ku i shpëtoje dot atij syri!

— Si je moj Shpresa? Këtu, ë? Po si i ke nga shtëpia? Xha Bequa si është? Po teto Nadua?

Ai pyeste Shpresën, po në të vërtetë skuqej e djersinte Pajua me atë qafë si të demit. Kjo nuk i shpëtoi Komandantit.

— Po ti, mor shoku vullnetar, tepër i fortë qenke! — dhe i shkoi dorën mbi qafën e trashë. — Ja, kësh-tu de, të fortë dhe të shëndetshëm duhet të jini.

Dalëngadalë muhabeti u shtrua vendçe. Megjith-

atë, gjuha jonë e kishte tepër të vështirë të zgjidhej.
— Pa hë mor shokë pionierë, na tregoni, si i kini punët? Si vini me mësime dhe si ja kaloni me mësueset tuaja?

— Oho, — e mori fjalën papritur i krisuri Qano, — ne në shkollën tonë shkojmë mirë. Aq më mirë këtu.

— Ashtu? Po përse?

Komandanti fliste me të gjithë, sikur të njihej prej kohe me ne. Dukej ai që i njihte prej kohe, përdërisa u bënte të tilla pyetje.

Donte të dinte për grurin, për pambukun, për vreshtat, për tufat me dhen, për pyjet, për kullotat, për gjithshka.

— Po ti atje nga je? — ju drejtua Komandanti një vullnetari të hollë e të gjatë, që vetëm skuqej si paparuna.

— Unë... unë jam nga...

«Çfarë pyke, mendova unë, vete e harron se nga është...

— Po ti nga je? — më pyeti papritur edhe mua Komandanti.

— Unë... unë jam nga... — dhe padashur imitova atë vullnetarin, i cili kishte harruar se nga qe. Por, mua më erdhi në ndihmë Shpresa, e dashura Shpresa!

— Këta kanë ardhur dy vëllezër, — sqaroi ajo, duke treguar me kokë nga Pajua.

— Dy vëllezër, ë? Taman një familje. Familjarisht në hekurudhë. Si në luftë dje. Kështu rinia po e kupton dhe po e ndjek besnikërisht Partinë. Dhe s'ka se si të ndodhë ndryshe. Se ne kemi një Parti të popullit, Parti të fukarasë, prandaj populli e do dhe nuk i ndahet më Partisë sonë.

Atë kohë kisha edhe një dëshirë tjetër të madhe. Doja që edhe unë ta pyesja për ndonjë gjë Komandantin. Por, të them të drejtën, ca që nuk guxoja, e ca nga që nuk e kisha fort të qartë se për çfarë do ta pyesja.

Po sikur të më merrej goja? Bah, më mirë ta lija mënjanë atë punë të pasigurtë.

Rreth nesh buçiste kënga dhe dajreja. Si në një dasmë të madhe. . . Sikur të martohej e gjithë hekurudha!

Komandanti na foli gjatë për futjen e zakoneve të reja, për luftën kundër fanatizmit, kundër zakoneve prapanike. Na foli për gjithshka na donte zemra.

Ne duhej ta dinim mirë përse na akuzonte reaksioni. Për prishjen e familjes. Për gjoja shpërbërjen e saj. Këto, natyrisht, qenë shpifje nga më të ulëtat.

Ne do ta mbronim familjen tonë nga të gjitha këto shpifje. Dhe do ta forconim përherë e më shumë. Se ne nuk kemi shkak për grindje. Jeta e re që po futej në familjet tona s'kishte asgjë kundër prindërve tonë të dashur. Çdo gjë duhej të zgjidhej urtë e butë. Në mirëkuptim të plotë. . .

E dëgjonim gojëhapur! Na dukej sikur fliste kështu i madhi i shtëpisë, prindi ynë. Dhe fjalët qenë nga më të zakonat, nga më të kuptueshmet. Por ashtu siç flisnim edhe në shtëpi.

Prindëve duhej t'u shkoqitej me urtësi, se e gjithë kjo luftë nuk u bë vetëm për të shporrur njëherë e mirë armikun. As vetëm për të shtypur klasat në fuqi. Këto qenë hapat e para të revolucionit popullor. Duhej kuptuar se edhe familja jonë do të niste një jetë të re. Jo vetëm me krahë, jo vetëm me kazëm.

Padyshim që jeta e re do të binte aq shumë të mira. saqë s'kishe pse t'i kundërviheshe. Po këto të

mira do të vinin dora-dorës dhe jo ashtu përnjëherë.

Se ne do t'i ndërtonim vetë. Me duart tona. Nuk do të prisnim të na i dhuronte ndokush për sadaka. Ne nuk prisnim sadaka nga askush. Ashtu siç nuk kishim pritur asnjëherë në shekuj.

Çdo gjë, çdo gjë do ta arrinim vetë, me djersën tonë. Nga sadakaja asnjë komb nuk kish dalë në dritë, nuk kish fituar lirinë.

Unë, duke dëgjuar gjithë këto, kisha harruar të tjerët dhe veten time. Më dukej sikur rrija diku pezull në hapësirë dhe dëgjoja i mahnitur për gjëra që i kisha afër, por që ende s'mund t'i prekja me dorë.

Po ashtu kisha harruar se çfarë pyetje mund t'i bëja Komandantit. Kur papritur, ai më pyeti:

— Po ti, çfarë do të bëhesh kur të rritesh?

Unë u kapa aq në befasi, sa që as mësuesi nuk më kish gjetur ndonjëherë edhe në ato rastet kur nuk e kisha mendjen në mësim.

— Unë... unë do të bëhem ushtar!

Dikush ja plasi gazit. Mua desh më ngriu gjaku. Po për fat ajo e qeshur mbeti solo. Askush nuk e pasoi.

— Ushtar? Shumë bukur! Ushtar të bëhesh. Ushhtar i Republikës! Ushtar i revolucionit. Se revolucionit ka përherë nevojë për ushtarë.

Dhe, që të bëheshim ushtarë të mirë, duhej të mësonim sa më shumë. Të mësonim natë e ditë dhe të punonim natë e ditë!

Po prindët tanë a dinin të gjithë shkrim e këndim? Si? Njëherë të, ca turçe ca shqip. Atëhere, sapo të ktheheshim të fillonim punën me ta. Të lihej mënjanë ajo ca turçe dhe të punohej me shqipen, me gjuhën e Naimit. Të mësonim. Të zhdukej analfabetizmi, si një e keqe po aq e madhe sa edhe malarja.

Ne, që drejtonim këtu gjithë këto kurse kundër analfabetizmit, si të mos bënim të njëjtën gjë edhe në familjet tona?

Kjo që me vend. Unë mësoja në klasën time 25 vetë. Si të mos mësoja edhe dy vetë në shtëpinë time? E gjithë vështirësia këtu do të që, në se do të bindej apo jo babai për këtë punë, apo do fillonte të tallej me të birin dhaskal. . .

Harrova unë! Më përpara duhej sqaruar se jeta e re që do të ndërtonim, kërkonte sjellje të reja, punë, guxim, njerëz të ditur.

Ne e kishm qarkuar nga çdo anë Komandantin dhe ai ngjante si një vërsnik më i rritur midis moshatarëve.

*
* *
*

Kur u largua Komandanti nga ne, unë nuk e di pse u pikëllova! Bile, më erdhi edhe për të qarë. Por, bëra çmos që të mos arrija gjer atje. Dhe ja dola disi.

Ai u largua. U nda nga ne. Ndjej akoma ngroh-tësinë e dorës së tij në shuplakën time. Ndjej flokët që ranë mbi ballin tim kur më përqafoi. Shikoj ata sy të mëdhenj e plot dritë diellore, që nuk do të më ndahen për jetë.

Thonë se moshë ime ka vetinë të ëndërrojë, të fantazojë, të idealizojë. . . Mund të jetë edhe kështu. Po ja, qëllon që të gjitha këto, ëndërrimet, fantazia, ideali, papritur të dalin përpara të trupëzuara në një figurë konkrete. Këto raste ndodhin rallë në jetë, prandaj edhe mbeten të paharruara, të pashlyeshme nga kujtesa.

Në mendimet e mia tani ka një dozë pikëllimi

për largimin e Komandantit. Me sa shikoj, edhe të tjerët nuk janë më pak të dëshpëruar për këtë largim të dhimshur.

Dhe mendimet sa vinë e trazohen për ditë e më tepër!

Do të ndërtonim një jetë të re!

Kjo gjë donte mësim, punë, luftë!

Detyra të rënda na pritnin!

Po! Jeta e re nuk ishte më një ëndërr. As për moshën time dhe as për moshat e tjera! Kisha dalë në jetë tashmë, bashkë me Qanon e me Minellën.

PËRMBAJTJA

	Faqe
Një arratisje	5
Sqarim dhe vendim	13
Tjetër arratisje.	20
Përpara.	31
Nisemi dhe mbërrijmë	38
Hekurudha.	49
Vullnetarët.	58
Lufta.	66
Ndihma.	74
Një aventurë natën	82
Analfabetizmi.	92
Sqarohem dhe sqaroj	98
Mendime dhe heshtje	104
Tjetër arratisje	113
Më kërkohet ndihmë	121
Minat me sahat.	130
Në sulm	141
Komandanti.	149

